



**TEB**

BNP PARIBAS JOINT VENTURE

# Raportu Vjetor 2018



## Zgjerojmë botën tuaj

Me fokus tek ardhmëria: do të përpiqemi të rrisim më tej kënaqësinë e klientëve tanë.

Shërbimi më i mirë për klientët individual si dhe për ndërmarrjet - kjo është ajo që e udhëheqë TEB Sh.A. me praktika etike biznesore që janë thelbësore për atë shërbim dhe për misionin tonë. Kjo është arsyeja përse sot aseti ynë numër një është marrëdhënia e besimit që kemi krijuar me klientët tanë me kalimin kohës.

## Vlerat tona

- Të sigurtë dhe të besueshëm
- Udhëheqës, pararendës dhe inovativ
- Të orientuar nga klienti dhe me fokus të fuqishëm tek cilësia e lartë
- Të respektueshëm për shoqërinë, të drejtat e njeriu dhe mjedisin
- Transparentë

# Përmbajtja

## **1. Për TEB Sh. A.**

- 1.1. Profili i korporatës
- 1.2. Misioni, vizioni dhe strategjia jonë
- 1.3. Vlerat tona themelore
- 1.4. Struktura aksionare

## **2. Pasqyra e viti 2018 dhe perspektiva e viti 2019**

- 2.1. Nga Kryesuesi
- 2.2. Nga Drejtori Ekzekutiv

## **3. TEB Sh. A. në vitin 2018**

- 3.1. TEB Sh. A. në shifra
- 3.2. Indikatorët kyç financiar

## **4. Njësitë e biznesit**

- 4.1. Bankimi për klientë individual
- 4.2. Biznesi i kartelave
- 4.3. Bankimi për NVM-të
- 4.4. Bankimi komercial dhe për korporata
- 4.5. Financat tregtare
- 4.6. Sistemet e pagesave
- 4.7. Thesari dhe MPD
- 4.8. Burimet njerëzore
- 4.9. Teknologjia informative
- 4.10. Siguria e informacionit dhe mbrojtja e të dhënave personale

## **5. Menaxhmenti/Qeverisja korporative**

- 5.1. Struktura organizative e TEB Sh. A.
- 5.2. Bordi i Drejtorëve
- 5.3. Komitetet
- 5.4. Auditimi i brendshëm
- 5.5. Menaxhimi i rrezikut si dhe rreziku operacional dhe vazhdimësia e biznesit
- 5.6. Pajtueshmëria
- 5.7. Kontrolli i brendshëm

## **6. Raporti i Auditorit**

- 6.1. Raporti i pavarur i auditimit më 31 dhjetor 2018 dhe Shënimet në pasqyrat financiare

# TEB Sh.A Raporti Vjetor 2018

**Data e raportit:** 01.01.2018 — 31.12.2018

**Adresa:** "Preoc no no. Graçanica 10500, 7th km rruga kryesore  
Prishtina-Ferizaj, Republika e Kosovës"

**Telefoni:** +383 (0) 38 230 123

**Fax:** +383 (0) 38 224 699

**Email:** [info@teb-kos.com](mailto:info@teb-kos.com)

**Web:** [www.teb-kos.com](http://www.teb-kos.com)

# Rreth TEB Sh. A

## 1.1. Profili i korporatës

### Zgjerohet botën tuaj...

Me fokus tek ardhmëria: do të përpiqemi ta rrisim më tej kënaqësinë e klientëve tanë.

Pas njëmbëdhjetë (11) vitesh të suksesshme në Kosovë, TEB Sh.A. (TEB) është bërë një ndër emrat prijës në sektorin bankar, duke fituar reputacion bukur të merituar për shërbim të shkëlqyer. Prej fillimit e deri tani, në mënyrë sistematike kemi çelur shtigje të reja për t'i përmbushur nevojat e individëve dhe bizneseve për shërbime bankare dhe financim, duke lansuar shumë produkte e shërbime për 'herë të parë' në tregun e Kosovës.

Në botën që po ndryshon me shpejtësi, TEB-i është gjithmonë në gatishmëri për t'i mbështetur klientët dhe punonjësit e tij. Kjo aftësi bazohet edhe në pozitën tonë si anëtar i mirënjohur i Grupit TEB që është formuar përmes një ndërmarrjeje të përbashkët në mes të BNP Paribas, një ndër institucionet financiare më të fuqishme në botë dhe Turk Ekonomi Bankasi një prej bankave me më së shumti reputacion në Turqi.

Ne synojmë të jemi bankë e përgjegjshme. Për këtë arsye zhvillojmë një sërë aktivitete me përgjegjësi shoqërore që kontribuojnë në zhvillimin social. Për TEB-in, përgjegjësia shoqërore e korporatës është një vegël shumë e vlefshme dhe thelbësore që plotëson misionin tonë ekonomik. Prandaj, përveç ofrimit të shërbimeve të shkëlqyera, inovative dhe të përgjegjshme për klientët tanë ne ndërmarrim projekte përkatëse që janë të dizajnuara për të sjellur përparim në arsim, kulturë dhe sport - të gjitha me synim për ndikime pozitive për sa më shumë njerëz në Kosovë.

### Vlera, Shërbimi, Ekselencia...

Për TEB-in, klienti është në qendër të gjithçkaje që ne bëjmë. Klientët tanë janë të veçantë dhe të

vlerësuar. Kjo shprehet në të gjitha produktet dhe shërbimet e dizajnuara në mënyrë të posaçme që ne ofrojmë për grupe të ndryshme të klientëve, nga ndërmarrësit e deri te qytetarët më të moshuar, nga punonjësit e deri te studentët.

Ne besojmë se rritja sistematike nga viti në vit i numrit të klientëve, i rrjetit tonë të shërbimit, vëllimit të transaksioneve dhe personelit tonë është dëshmi e përpjekjeve tona që:

- Vazhdimisht të zgjerohet gamën e produkteve dhe shërbimeve tona bankare jo-në-degë dhe të shtojmë funksionalitetin në rrjetit tonë inovative të shërbimeve bankare me shumë kanale. Ne ofrojmë të gjitha llojet e produkteve dhe shërbimeve bankare të fokusuara në cilësi, të cilat u nevojiten njerëzve në faza të ndryshme të jetës së tyre - të gjitha përmes rrjetit tonë të zgjeruar dhe me shumë kanale të ofrimit.

- Ofrojmë zgjidhje financiare optimale për klientë privatë të bankës bazuar në "shërbim të personalizuar".

- Performojmë më së miri në industri sa i përket rritjes në numër të kredit kartelave, rritje që shtohet vazhdimisht me produkte dhe shërbime të reja, si dhe me fushatat specifike të kartelave të organizuara me grup tjetër të klientëve, përkatësisht anëtarët tanë tregtarë. Përmes segmentimit të biznesit me kartela, ne i identifikojmë grupet specifike, u shërbejmë atyre me produkte si, kartela për zonjat ('She Card'), kredit kartela për gratë ndërmarrëse ('Woman Entrepreneurship Credit Card') dhe kartela biznesi ('Business Card') për pronarët NVM.

- Ruajmë pozitën tonë të fortë në shërbimet e menaxhimit të parave të gatshme për klientë individual.

- Ofrojmë mbështetje bankare komerciale që është shtytësi kryesor në rrugën drejt rritjes ekonomike në të ardhmen në Kosovë. Çdo vit, përforcojmë fokusin tonë tashmë të fuqishëm në mbështetjen e qindra mijërave klientëve

komerciale dhe të NVM-ve të TEB-it pasi që ata luajnë një rol gjithnjë e më të rëndësishëm në procesin e zhvillimit ekonomik.

## Reale, e mençur, me vlerë...

Si anëtare e dy grupeve të fuqishme ndërkombëtare financiare – TEB A.Ş., institucion financiar prijës dhe me reputacion të lartë në sektorin bankar turk dhe BNP Paribas, një nga bankat e nivelit më të lartë të eurozonës me rrjet të gjerë dhe ndërkombëtar – TEB përfiton nga përvoja, qëndrueshmëria dhe gama e Grupit. Kjo na mundëson gjenerimin e rezultateve më të mira për klientët tanë.

Për shkak të kësaj baze të shëndoshë, TEB vazhdon të ketë progres duke rritur cilësinë e shërbimeve dhe zhvilluar produkte që u përshtaten pritjeve të klientëve. Në hap me zhvillimet e shpejta në teknologji, në mënyrë sistematike ne përmirësojmë rrjetin tonë inovativ dhe me shumë kanale të shërbimeve bankare (si bankimi përmes internetit dhe të tel. mobil, qendra e thirrjeve, shërbimet SMS, ATM, POS), duke u mundësuar klientëve në këtë mënyrë të përdorin kanalin më të përshtatshëm të shpërndarjes për transaksionet e tyre bankare – në mënyrë të përshtatshme, të shpejtë dhe të besueshme.

## Më shumë përkushtim për komunitetin...

Që nga themelimi i TEB në vitin 2008, qasja jonë ka qenë sjellja e risive. Si një bankë e fuqishme me shërbime të plota, ne jemi fokusuar në përgjigjen ndaj kërkesave të klientëve për shërbimet financiare. Me kalimin e viteve, kemi arritur t'i shfrytëzojmë në mënyrë efektive kompetencat dhe vizionin tonë të korporatës, duke prodhuar

vlerë të shtuar si për klientët ashtu edhe për aksionarët. Në vitin 2018, vazhduam të ndjekim zhvillimin tonë të balancuar dhe të shëndetshëm – që pritet prej nesh- duke përforcuar më tej pozitën tonë si një nga institucionet financiare më të fuqishme në vend. Ky fakt krijon një bazë edhe më të fortë për të ardhmen tonë si një fuqi e rëndësishme në Kosovë.

Përgjegjësia shoqërore korporative luan një rol të rëndësishëm; prandaj politika jonë është të kontribuojmë në zhvillimin shoqëror të Kosovës. Ne kemi krijuar një kornizë për iniciativa afatgjata bazuar në spektrin e projekteve që do të krijojnë përfitime më të mëdha shoqërore. Në lidhje me mbështetjen e biznesit, jemi duke punuar përmes Programit të Mbështetjes së Ndërmarrësisë së Grave, Akademisë së Biznesit dhe Forumit të Biznesit.

## Tejkalojmë pritjet tuaja...

TEB i detyrohet suksesit të saj punonjësve të saj, të cilët përcjellin tek klientët qasjen inovative dhe pro-aktive të bankës, të cilët punojnë shumë për të ruajtur dhe shtuar cilësinë e shërbimeve dhe aseteve të përfaqësuara nga brendi ynë bankar. Qëllimet tona janë t'u ndihmojmë individëve dhe bizneseve që të ndërtojnë të ardhmen e tyre, të realizojnë ambiciet e tyre si dhe t'u ndihmojmë t'i menaxhojnë rreziqet e tyre financiare. Ne duam të jemi një institucion financiar që i bën klientët të ndihen rehatshëm.

**Klientët tanë janë të veçantë dhe të vlerësuar. Qëllimet tona janë të ju ndihmojmë individëve dhe bizneseve për të ndërtuar ardhmërinë e tyre, për t'i realizuar ambiciet e tyre dhe ndihmuar ata të menaxhojnë rreziqet e tyre financiare.**

## 1.2. Vizioni, misioni dhe strategjia jonë

### Vizioni ynë

Vizioni ynë është që të jemi banka me përvojë më të mirë për klientët në Kosovë.

### Misioni ynë

Në vazhdimësi të krijojmë dhe të rrisim vlerat e jashtëzakonshme për klientët, aksionarët, punonjësit dhe shoqërinë tonë.

### Strategjia jonë

Në përputhje me vizionin dhe misionin tonë, strategjia jonë është të ofrojmë një përvojë të jashtëzakonshme dhe efikase bankare për të gjithë klientët tanë, të ofrojmë një përvojë të shkëlqyeshme për klientin në TEB duke e vënë klientin në qendër të fokusit. Këtë do ta arrijmë duke ofruar produkte dhe shërbime inovative dhe praktike për të siguruar rritje të vazhdueshme dhe të qëndrueshme. Ofrimet e TEB-it janë gjithmonë të bazuara në zotimin tonë për të qenë bankë e përgjegjshme. Kjo është e mishëruar në të gjitha vlerat tona dhe pasqyrohet në biznesin tonë, në mënyrën si i zhvillojmë produktet dhe shërbimet tona dhe si i paraqesim qëllimet dhe premtimet tona.

**Për të krijuar dhe rritur në vazhdimësi një vlerë të jashtëzakonshme për klientët, aksionarët, punonjësit dhe shoqërinë tonë.**



## 1.3. Vlerat tona themelore:

### Klienti në qendër

Suksesi ynë është i bazuar në përkushtimin e plotë për klientët tanë në çdo kohë, duke fituar besimin dhe besnikërinë e tyre në bazën tonë të klientëve. Ne e ruajmë këtë besim duke e vendosur klientin tonë në qendër të gjithçkaje që ne bëjmë. Nevojat dhe pritjet e klientëve janë shtysat e qasjes dhe përgjigjeve tona të shpejta dhe pro-aktive ndaj kërkesave që ndryshojnë me shpejtësi. Kjo na mundëson të krijojmë dhe ofrojmë vlera të vërteta për klientët duke u ofruar shërbime dhe produkte të reja, përtej pritjeve të tyre, të përshtatura dhe të trendit të fundit.

### Integriteti

Ne kemi përqaftuar standardet më të larta të integritetit në çdo gjë që themi dhe bëjmë dhe përveç kësaj jemi të përkushtuar për të krijuar vlerë të shtuar për klientët, aksionarët dhe punonjësit tanë duke bërë gjithmonë më shumë se thjesht atë çfarë është e duhur. Ne komunikojnë hapur dhe me sinqeritet, i ftojmë dhe i vlerësojmë pikëpamjet sfiduese që kanë për qëllim krijimin e ideve më të mira dhe marrjen e vendimeve më të përshtatshme dhe më të balancuara.

Ne gjenerojmë vlerë për aksionarët tanë përmes suksesit afatgjatë në vend të fitimit afatshkurtër. Prandaj, qëllimi ynë është që biznesi ynë kryesor të realizojë dividendë dhe rentabilitet operativ të shëndetshëm dhe të fuqishëm përmes një fryme të ndërmarrësisë që me përgjegjësi balancon rreziqet dhe fitimet.

### Inovacioni

Ne aspirojmë inovacionet që kanë rëndësi. TEB-i vlerëson entuziazmin e kombinuar me kureshtjen intelektuale të personelit tonë, gjersa ata vazhdimisht synojnë të krijojnë produkte që lehtësojnë suksesin e klientëve tanë dhe ofrojnë zgjidhje të përshtatshme për nevojat e tyre.

### Efikasiteti në punë

Ne krijojmë procese dhe produkte miqësore për përdoruesin, të lehta për qasje dhe të projektuara për të shtuar vlerë. Ne përpiqemi të sigurojmë që shërbimet e ofruara të kenë çmime të caktuara që u përgjigjen drejtë kostos aktuale të ofrimit të tyre.

### Disiplina

Mendojmë dhe veprojmë si pronarë të Bankës, si rrjedhojë ne i mbrojmë burimet e saj dhe përqendrohemi në qëllimet e përbashkëta dhe jo ato individuale. Jemi krenarë për sukseset e TEB-it dhe vlerën që krijojmë për aksionarët dhe klientët tanë. Secili nga 590 punonjësit tanë ndihet përgjegjës nëse dështojmë në përmbushjen e pritjeve të klientëve dhe të gjithë japim llogari për përmbushjen e premtimeve tona - nuk ka justifikime. Synojmë të arrijmë përsosmëri operacionale përmes performancës së suksesshme që në përpjekjen e parë.

### Burimet njerëzore kompetente

Në drejtim të objektivit tonë për të përforcuar pozitën tonë si punëdhënës i zgjedhur ne përpiqemi të krijojmë një kulturë që tërheq individë të talentuar, inkurajojmë punë ekipore të ndryshme por të përgjegjshme dhe bashkëpunuese, zhvillojmë dhe investojmë në talentët më të mirë dhe menaxhimin bazuar në merita dhe mundësi të barabarta.

### Partneriteti

Ne synojmë që me klientët dhe punonjësit të kemi marrëdhënie të qëndrueshme dhe reciprokisht të dobishme ku vlera e krijuar ndahet në mënyrë të drejtë. Përveç që jemi partnerë të përgjegjshëm me të gjitha palët me interes dhe rregullatorët ne po ashtu jemi në shërbim të shoqërisë tonë.

## Kanalet e fuqishme të shpërndarjes

Përpiqemi të ofrojmë shërbime dhe përkrahje për klientët tanë siç iu përshtatet atyre, duke ofruar kanale të ndryshme të shpërndarjes, duke përfshirë zyrat tona të degëve, qendrën e thirrjeve, shitjet e drejtpërdrejta dhe kanalet e ndryshme alternative të shpërndarjes.

### 1.4. Struktura aksionare

Kapitali aksionar i Bankës është €24.000.000 bazuar në 2.400.000 aksione të emetuara, secili me vlerë nominale €10.

Numri i aksioneve lidhet me aksionet e zakonshme pa të drejta, me preferenca ose kufizime të lidhura me to.

Aksionar më 31 Dhjetor 2018	Pronsia e aksioneve e paguar me kapital (K)	Aksione
TEB Holding A.Ş.*	24,000,000	100%

\*50%-50% BNP Paribas Fortis Yatırımlar Holding A.Ş. dhe Çolakoğlu Group Joint Venture

# **Pasqyra e viti 2018 dhe perspektiva e viti 2019**

## 2.1. Mesazhi i Kryesuesit

**Në vitin 2018, TEB Sh.A. vazhdoi të ketë performancë të mirë financiare dhe operacionale, pavarësisht nga kushtet sfiduese të tregut. Performanca jonë demonstroi potencialin e strategjisë sonë për të zhvilluar një bankë më të qëndrueshme duke kontribuar në mënyrë aktive për të ndërtuar një ekonomi reale elastike të Kosovës.**

Mjedisi i përgjithshëm makroekonomik lokal ishte i qëndrueshëm. Sektori bankar, në veçanti, përjetoi një vit tjetër të kënaqshëm dhe ne jemi të kënaqur të raportojmë se TEB shënoi një vit tjetër të shkëlqyeshëm në 2018. Ne kemi rritur bazën tonë të aseteve me 13.8% për të arritur €555.9 milion, duke zgjeruar portfolion bruto të kredisë me 5% në €395.2 milion dhe rritur depozitat me 19.5% në €455.5 milion. Norma e mjaftueshmërisë së kapitalit ka qenë rreth 19%, që është më shumë se dyfishi i standardeve globale.

Ne po ashtu përmirësuam një gamë të gjerë të treguesve kyç të performancës krahasuar me vitin e kaluar dhe standardet e tregut. Ne kemi arritur një gjenerim të qëndrueshëm të të ardhurave - madje në mjedisin me normë të ulët të interesit - si dhe nga menaxhimi i kujdesshëm i kostove operative dhe menaxhimi efektiv i rrezikut. Performanca e fuqishme financiare dhe fitimi i atribuar neto prej €15.2 milion në vitin 2018 na mundësoi të kthejmë kapitalin e tepërt tek aksionarët dhe të paguajmë dividendin tonë të parë.

Në qendër të planit strategjik të bankës, ne drejtojmë synimin e biznesit tonë në mbështetjen e suksesit të qëndrueshëm të klientëve tanë, njerëzve dhe komunitetit ku ne bëjmë biznes.

Duke shfrytëzuar modelin tonë të integruar dhe të larmishëm të biznesit, ne bëjmë çdo përpjekje për të parashikuar trendet në ndryshim të shpejtë, në mënyrë që të ndihmojmë klientët tanë për të tejkaluar pasigurinë aktuale dhe për të kapur mundësitë. Ne vazhdojmë të investojmë në infrastrukturën tonë ekzistuese, përmirësimin e sistemeve dhe kalimin në teknologjitë më të fundit për të marrë përfitimet e botës digjitale në zhvillim. Transformimi digjital fokusohet në katër fusha kryesore: thjeshtësimi i rrugëtimit të klientit, zhvillimi i veçorive të reja dhe të avancuara të vetë-kujdesit dhe kanaleve alternative të shpërndarjes, përmirësimi i efikasitetit të operimit dhe përsheptimi i transferimit të transaksioneve nga degët në shërbimet digjitale.

Siguria kibernetike vazhdon të jetë një fushë e fokusimit dhe një nga prioritetet më urgjente. Ky vendim nuk është më çështje zgjedhjesh, por më së shumti në sigurimin e mbrojtjes afatgjatë të klientëve tanë, bankës dhe shoqërisë tonë. Ne vazhdojmë të fuqizohemi dhe të investojmë shumë në kontrollin e biznesit dhe teknik, me qëllim të parandalimit, zbulimit dhe reagimit ndaj kërcënimeve.

Se si ne bëjmë biznes është po aq e rëndësishme sa qëndrueshmëria e rritjes sonë të biznesit. Ne i kushtojmë vëmendje të veçantë menaxhimit efektiv të rrezikut përmes menaxhimit të integruar të rreziqeve financiare dhe jo-financiare. Të gjitha vendimet dhe veprimet janë duke u marrë lidhur me këto rreziqe të cilat monitorohen për së afërmi nga menaxhmenti në baza të vazhdueshme. Të gjitha

rreziqet financiare dhe jo-financiare raportohen përmes komiteteve përkatëse. Banka ndërmerr masat e duhura për të arritur ekuilibrin e kujdesshëm në mes të rrezikut dhe shpërblimit në aktivitetet e vazhdueshme dhe të reja të biznesit.

Ne vazhdojmë të bëjmë investime të rëndësishme në aftësinë tonë për të zbuluar, penguar dhe parandaluar krimin financiar. Ne kemi larguar klientët, produktet dhe sektorët ku ne kemi konsideruar se rreziku i krimit financiar është shumë i lartë. Ne jemi të përkushtuar ndaj standardeve të larta të sjelljes etike dhe zbatojmë një qasje zero tolerancë ndaj çdo sjellje jo-etike dhe në kundërshtim me qeverisjen e mirë korporative. Ne synojmë të jemi transparentë, të qartë dhe përgjegjës ndaj klientëve tanë.

Rruga për të arritur të gjitha qëllimet tona shkon përmes investimit për punonjësit tanë. Ne fokusohemi në zhvillimin, kënaqësinë dhe mirëqenien e punonjësve tanë. Përpjekjet tona janë në nxitjen e mundësive të barabarta dhe në zhvillimin profesional që kontribuon në angazhimin tonë të lartë të punonjësve. Në përgjithësi, Bordi është i kënaqur me performancën e bankës në vitin 2018. Për të gjitha arritjet, ne dëshirojmë të falënderojmë të gjithë punonjësit tanë, klientët tanë të nderuar dhe palët tona me interes për mbështetjen dhe përkushtimin e tyre të vazhdueshëm gjatë këtij viti.

Jacques Roger Jean Marie Rinino

Kryesues i Bordit të Drejtorëve

## 2.2. Mesazhi nga Drejtori Ekzekutiv

**Me kënaqësi ju informoj për një vit tjetër të jashtëzakonshëm për bankën TEB. Si rezultat i përpjekjeve të mëdha të ekipit menaxhues dhe të gjithë punonjësve tanë, TEB vazhdon të zhvillohet duke u fuqizuar me rolin e saj udhëheqës të produkteve dhe shërbimeve që shtojnë vlerë të lartë në çdo fazë të aktivitetit ekonomik dhe afarist.**

Për klientët tanë, partnerët e biznesit dhe palët me interes,

Me shumë kënaqësi raportoj se kemi vazhduar përkrahjen tonë për ekonominë e Kosovës gjatë gjithë vitit 2018 dhe kemi zgjeruar më tej ekspertizën dhe udhëheqjen tonë në sektorët tanë prioritarë. Ne kemi pasur performancë të rritjes së shëndetshme në bazë të parimeve të shëndosha.

Në përputhje me prioritetet tona strategjike, ne kemi punuar në vazhdimësi edhe në vitin 2018 për të përmirësuar më tej përvojën e klientëve. Ne vazhdimisht kemi zhvilluar dhe transformuar iniciativat për të siguruar që klientët tanë mund të përfitojnë më shumë nga mundësitë që epoka digjitale ka për të ofruar. Në vitin 2018, për herë të parë në Kosovë, ne kemi lansuar aplikacionet e produktit përmes kanaleve digjitale duke u bërë një bankë nismëtare që ofron shërbime të tilla për klientët individual.

Ne kemi përfunduar me sukses vitin duke u fokusuar në përvojën e shkëlqyer të klientëve, normat e shëndetshme të solvencës dhe efikasitetin. Ne kemi arritur rekord në fitimin neto prej 15.9 milion Euro në vitin 2018 me kthimin në ekuitet prej 20.3 përqind. Totali i aseteve në fund të vitit ishte 555.9 milion euro krahasuar me 488.5 milion euro në vitin 2017. Banka është e kapitalizuar mirë, ka bazë të fortë të depozitave dhe bazë të mirë të diversifikuar të klientëve, që ne besojmë se të gjitha këto na bëjnë të pozicionuar mirë për të përfituar nga mundësitë e rritjes së afarizmit në të ardhmen.

Ne kemi vazhduar të ofrojmë risi dhe mundësi që bëjnë dallim në jetën e klientëve tanë gjatë vitit 2018:

- Me rastin e Ditës Ndërkombëtare të Gruas, 8 Mars, TEB Banka dhe Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) kanë organizuar ngjarjen Gratë në Biznes në Prishtinë. Programi i "Ndërmarrësisë për Gratë" është një produkt unik i ofruar nga TEB Sh.A. për fuqizimin ekonomik të grave.

Qëllimi i këtij organizimi ishte prezantimi i arritjeve të Programit të Grave në Biznes i zbatuar nga BERZH dhe Banka TEB gjatë periudhës 2015-2018.

- Kjo ngjarje ka shënuar promovimin e ndërmarrësisë së grave dhe në përgjithësi pjesëmarrjen e grave në biznes, duke ndihmuar Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme (NVM) të udhëhequra nga gratë në mënyrë që të kenë qasje në financa, njohuri dhe shërbime të zhvillimit jo-financiar të biznesit për të treguar se kur dështimet adresohen dhe pengesat hiqen, bizneseve të drejtuara nga gratë u jepen mundësi të barabarta, kështu ato do të kenë sukses në aspektin e performancës ekonomike dhe të rritjes, krijimit të vendeve të punës dhe një sërë përfitimesh të tjera sociale.\*

- Për më tepër, ne kemi mbështetur forumin "Gratë sipërmarrëse të rajonit - Takimet B2B (biznesi për biznesin)", organizuar nga Oda Ekonomike e Grave të Kosovës, në bashkëpunim me Ministrinë e Inovacionit dhe Ndërmarrësisë dhe Ambasadën e Holandës.
- Ne kemi hapur një degë të re digjitale në rrugën B më 4 maj. Duke pasur parasysh rëndësinë e investimit në bankimin digjital si nxitës të përvetësimit të klientëve, shitjen e tërthortë dhe kënaqësinë e klientëve, e përruam fillimin e aktiviteteve të degës së re në Rrugën B, duke vazhduar zgjerimin e njësive të reja për t'u shërbyer klientëve. Me degën e re, klientët mund të kryejnë shërbime 24 orë në ditë nëpërmjet terminaleve të bankomateve brenda objektit, që u mundëson atyre të tërheqin ose depozitojnë para, si dhe ofrojnë mjete për qasje në shërbimet 'online' përmes kanaleve alternative si E-banking dhe TebMobile. Ngjashëm me këtë, më 2 korrik TEB hapi një degë të re në qytetin e Vitisë me pjesëmarrje të kryetarit të komunës në ceremoninë e hapjes.
- Ne kemi mbështetur përsëri ekipet kosovare të basketbollit dhe futbollit edhe këtë vit. TEB Banka ka vazhduar për dy vite sponsorizimin me Federatën e Futbollit të Kosovës (FBK) dhe Federatën e Basketbollit të Kosovës (FBK).
- Ne jemi jashtëzakonisht të kënaqur që TEB Sh.A. është shpallur midis punëdhënësve më të mëdhenj të Odës Ekonomike të Kosovës dhe tutje si punëdhënës i vitit 2018 në Kosovë.
- Ne jemi një institucion financiar partner kyç për zbatimin e projekteve të gjelbra në vend, duke kredituar rreth €5 milion sipas Programit të Energjisë së Qëndrueshme të Kosovës. TEB Sh.A. dhe BERZh kanë nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi, kredi prej €5 milion për Bankën TEB në Kosovë, në kuadër të Shërbimit të Financimit të Ekonomisë së Gjelbër në Ballkanin Perëndimor më 19.04.2018, ku kredia do t'i huazohet individëve, shoqatave të strehimit, prodhuesve dhe shitësve të teknologjive të gjelbra për të mbështetur investimet në teknologjitë e eficiencës së energjisë në ndërtesat e banimit. Ky fond mbështetet nga financimet e grantit nga Fondi i Përbashkët i Ballkanit Perëndimor në kuadër të Kornizës së Investimeve të Ballkanit Perëndimor, Bashkimit Evropian (BE) dhe Austrisë. Rritja prej 10% në normat e depërtimit të tregut të teknologjive dhe materialeve të gjelbra pritet pas kësaj iniciative. Përveç kësaj, për periudhën e ardhshme mund të theksohet se ne do të vazhdojmë t'i diversifikojmë shërbimet tona që trajtojnë nevojat dhe pritjet e klientëve, ndërsa në të njëjtën kohë do të rrisim numrin e klientëve aktivë; dhe po ashtu do të vazhdojmë të përkrahim rritjen ekonomike të Kosovës me fokusin e saj kryesor në krijimin e vlerës. Resurset tona më të mëdha në këtë synim janë të trefishta: përpjekjet e dedikuara të personelit tonë, të përbërë nga profesionistët më të mirë në këtë sektor; mbështetja e vazhdueshme e aksionarëve tanë; dhe sinergjia jonë e fuqishme me të gjitha palët e interesit. Do të doja të shfrytëzoj rastin të shpreh mirënjohjen time të sinqertë për të gjithë punonjësit tanë të çmuar, aksionarët dhe palët e interesit. Po ashtu, pres me kënaqësi ndarjen e rezultateve dhe kënaqësinë e shumë arritjeve të tjera me të gjithë ju në vitin e ardhshëm, me përkrahjen e përvojës së thellë bankare dhe kulturën afariste të aksionarit tonë BNP Paribas.

Orcun Ozdemir

Drejtori Menaxhues

# **TEB Sh. A në 2018**




### 3.1. TEB-i në shifra

Treguesit e bilancit të gjendjes	2018	2017	Rritje/ (Rënie)	Përqindja
Gjithsej asetet	555,888	488,519	67,369	13.8%
Gjithsej kreditë (bruto)	395,190	376,511	18,679	5.0%
Depozitat	455,479	381,091	74,388	19.5%
Ekuiteti i aksionarëve	86,415	87,989	(1,574)	-1.8%
Kreditë joperformuese /Gjithsej kreditë	1.9%	2.5%	-0.6%	-23.8%
Kreditë/Gjithsej asetet	71.1%	77.1%	-6.0%	-7.8%
Raporti i mbulimit të kredive joperformuese	65.0%	61.8%	3.3%	5.3%
<b>Treguesit e pasqyrës së të hyrave</b>				
Të hyrat neto nga interesi	28,955	27,596	1,359	4.9%
Të hyrat neto jo nga interesi	6,552	7,258	(706)	-9.7%
Raporti kosto/të hyra	52.6%	54.2%	-1.6%	-2.9%
Neto të hyrat bankare	35,508	34,854	654	1.9%
Neto fitimi vjetor	15,186	16,639	(1,453)	-8.7%
<b>Raportet e rentabilitetit</b>				
Kthimi në ekuitet	20.3%	24.0%	-3.7%	-15.6%
Kthimi në asete	2.7%	3.4%	-0.7%	-19.8%
Të hyrat neto nga interesi / Average Interest Earning Assets	6.7%	7.4%	-0.7%	-9.0%
<b>Raportet e likuiditetit</b>				
Raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit	19.3%	21.1%	-1.8%	-8.4%
Asetet likuide/Gjithsej asetet	26.4%	22.1%	4.3%	19.5%
Asetet e ponderuara me rrezik	460,574	423,017	37,556	8.9%
<b>Treguesit tjerë</b>				
Degët	29	27	2	7.4%
Punonjësit	590	593	-3	-0.5%

## 3.2. INDIKATORËT KYÇ FINANCIAR

Rezultatet e menaxhimit të vazhdueshëm të kujdesshëm të portfolios, rreziku i balancuar mirë, strategjia e rritjes si dhe qëndrueshmëria e kënaqësisë së klientëve rezultuan me shifra të fitimit solid, rritje të qëndrueshme të portfolios së kredive dhe rritje të mëtejme të pjesës së tregut në vitin 2018.

Në fund të vitit 2018, totali i aseteve të Bankës arriti 555.9 milion €, duke u rritur me 67.3 milion € ose 13,8% në krahasim me vitin 2017, që është më e lartë se shifra e parashikuar prej më shumë se 40 milionë euro. Portfolio bruto e kredive është rritur në 395.2 milion €, një rritje prej 5.08%, ose një rritje e volumit prej 18.7 milion €, krahasuar me €376.5 milion në 2017. Bruto kreditë tani përfshijnë 71.1% të aseteve totale të Bankës në bilancin e gjendjes së bankës TEB.



Norma e kredive jo performuese (KJP) (Faza 3) në fund të vitit 2018 ishte 1.9%, krahasuar me 2.5% në vitin 2017, një rënie prej 60 pikë bazë. Depozitat e klientëve në total në fund të vitit 2018 arritën në 455.4 milion €, një rritje prej 74.4 milion € ose +19.5% në krahasim me fundin e vitit 2017.

Indikatorët e pasqyrës së të ardhurave gjithashtu tregojnë rritje të lehtë në performancë në krahasim me vitin e kaluar. Të hyrat neto nga interesi arritën në 28.9 milion €, një rritje prej 1.4 milion € ose 4.9% në krahasim me vitin 2017. Të hyrat neto jo nga interesi arritën në 6.5 milion €, një rritje prej 0,7 milion € apo -9.7%, që vijnë kryesisht nga provizionet-rivlerësimet e aseteve afatgjata të mbajtura për shitje (banka ka aplikuar metodologjinë e re të llogaritjes).

Norma kosto-të ardhura në vitin 2018 është zvogëluar tutje në 52.6% nga 54.2% në 2017. Të ardhurat

neto nga shërbimet bankare në fund të vitit ishin 35.5 milion €, në krahasim me 34.8 milion € të realizuara në vitin 2017.

Banka përfundoi vitin me 15.2 milion € fitim pas tatimit. Sa i përket indikatorëve të profitabilitetit, në fund të vitit 2018 Banka ka gjeneruar kthim në ekuitet (KNE) me rentabilitet prej 20.3% krahasuar me 24.0% në vitin 2017, ndërsa kthimi në asete (KNA) qëndroi në 2.7% në krahasim me 3.4% në 2017. Norma e interesit neto mbi asetet mesatare që krijojnë interes ishte 6.7% krahasuar me 7.43% në vitin paraprak, kryesisht si rezultat i normave më të ulëta të interesit, por edhe shumave më të larta të vendosjeve në strukturën e asetëve të fitimit të interesit. Raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit i Bankës (RMK) në fund të vitit ishte 19.3% duke tejkaluar kërkesën minimale të Bankës Qendrore të Kosovës (BQK) prej 12% dhe zvogëluar nga 21.1% në fund të vitit 2017 për shkak të pagesës së dividendit.

Norma e asetëve likuide në krahasim me asetet totale është rritur në 26.4% në fund të vitit 2018 në krahasim me 22.1% në vitin 2017. Arsyeja kryesore për likuiditet më të madh vjen si pasojë e rritjes së depozitave. Asetet e vlerësuar sipas rrezikut (AVRr) arritën 460.5 milion € në krahasim me € 423.0 milion në vitin paraprak pas rritjes në portfolion e kredive dhe asetet e përgjithshme gjatë vitit 2018.

Në vitin 2018, Banka ka hapur dy degë, duke rritur numrin e përgjithshëm të degëve në 29 (2017: 27) ndërkohë që numri i punonjësve prej 590 ka mbetur në nivele të ngjashme si në vitin 2017.

**Banka përfundoi vitin  
me profit €15.2M  
pas tatimit krahasuar me €16.6M  
në 2017 ulje prej 8.7%**

# Njësitë e biznesit

## 4.1. Bankimi për klientë individual

Divizioni i biznesit të bankimit për klientë individual të TEB Sh.A. ofron shërbime bankare për më shumë se 315,000 klientë individual. Banka ofron një varg të produkteve që janë mirë të dizajnuara për të përmbushur nevojat financiare të klientëve tanë duke sjellë procedura dhe procese efikase. Ambicia jonë është që të kemi zgjidhjet më të mira të industrisë, duke u ofruar klientëve shërbime të drejtpërdrejta bankare ditore dhe një mundësi për të përmbushur të gjitha nevojat e tyre në sferën e bankimit dhe sigurimit. Përveç përcjelljes së normave dhe kërkesave të industrisë për praktikën e mira bankare, ne duhet të vazhdojmë të kontribuojmë në thellimin e njohurive të klientëve lidhur me shërbimet bankare dhe në mënyrë të vazhdueshme të përmirësojnë cilësinë dhe rëndësinë e shërbimeve bankare të vëna në dispozicion për klientët tanë.

### Klientët dhe pozicioni i tregut

Në vitin 2018 TEB Sh.A. ka fuqizuar pozicionin e saj si aktor kryesor në tregun e bankimit për klientë individual dhe në fushën e gamës së produkteve. Më shumë se 22,000 klientë janë pranuar gjatë vitit 2018, duke e rritur bazën tonë të klientëve në një total prej 315,000 me një pjesë të tregut prej 45% në totalin e popullsisë së bankimit individual. Biznesi ynë ka një qëndrim të fuqishëm në mesin e klientëve tanë dhe tregon një trend të shkëlqyeshëm në kënaqësinë e klientit. Ndërveprimi me partnerët vendorë, bankimin e biznesit përfshirë NVM dhe korporatat e TEB Sh.A., Bankën Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim dhe partnerët e sigurimeve i mundësuan bankimit për klientë individual të ketë rritje të vazhdueshme të aktivitetit dhe bazës së klientit.

### Zhvillimi financiar

Numri i klientëve që kanë marrë pagën e tyre në TEB është rritur dukshëm në vitin 2018 me një normë të rritjes prej 26% dhe pjesë të tregut prej 14%. Përveç kësaj, për shkak të qasjes tonë të klientit në qendër ne kemi shënuar një trend të mirë në shitjet e tërthorta, furnizimin e klientëve me produkte të nevojshme bankare dhe edukimin e tyre për të qenë të pavarur në përdorimin e shërbimeve bankare përmes kanaleve tona digjitale.

Sa i përket portfolios së kredive individuale, ne kemi arritur (a) të kemi një normë të rritjes prej 11.2% krahasuar me vitin 2017. Si rezultat i prodhimit të vazhdueshëm dhe fushatave të ndryshme të kredisë (kredi të konsumit, hipotekave, veturave dhe shkollimit) ne kemi fuqizuar pozicionin tonë në treg me 21% të pjesës së tregut si një nga bankat kryesore në tregun bankar individual. Portfolio jonë e kredisë vazhdon të jetë shumë e shëndetshme pavarësisht rritjes së vazhdueshme të kredisë individuale të papaguar. Viti 2018 ka qenë vit i suksesshëm për portfolion tonë të depozitave individuale, ku depozitat nga klientët individualë kanë pasur një normë të rritjes prej 23.5%.

### Strategjia dhe qëllimet

TEB synon të ruajë praninë e fuqishme vendore dhe të vazhdojë të zbatojë strategjitë e orientuara drejt rritjes lidhur me bankimin për klientë individual. Në nivel të përgjithshëm ne jemi të përkushtuar të ofrojmë shërbime bankare të gjera dhe të avancuara me personel kompetent bankar dhe të mbështetura në teknologjitë më të reja. Fokusi ynë do të jetë në përvetësimin e mëtejshëm të klientëve që do të vazhdojnë të na sigurojnë me avantazhe edhe më të fuqishme

në drejtim të zhvillimit të mbulimit të produktit, marrëdhënieve afatgjata të klientit, marzhave pozitive, sigurimit të një baze më të mirë për ofrimin e shërbimeve dhe iniciativave relevante si dhe arritjen e kënaqësisë më të madhe të klientëve.

Përvoja e klientit dhe bankimi digjital do të vazhdojnë të mbeten në qendër të fokusit tonë, e cila përfshin të gjitha strategjitë kyçe që synojnë të rrisin përvojën bankare për klientët individual me shërbime bankare inovative digjitale dhe kanale të shumta të mbështetura nga investimet në teknologji dhe modelet e reja të biznesit. Për të modernizuar praktikën e reja bankare nga bankimi klasik i kryer në degë drejt kanaleve digjitale do të bëhen investime dhe ekspertizë e konsiderueshme për të optimizuar proceset e brendshme në përshpejtimin e standardeve tona të reja dhe me kosto efektive bankare. Në përcjellje të strategjive kryesore të bankimit për klientë individual, banka do të zhvillojë modele të reja biznesi me fokus në mundësitë digjitale, optimizimin e proceseve të brendshme, zgjerimin e ofertave të reja bankare dhe përmirësimin e aftësive analitike të të dhënave, përmirësimin e përvojës së klientit dhe segmentimin e bazës së klientëve nga perspektiva të ndryshme.

Objektivi kryesor është rritja e penetrimit të tregut duke ofruar vlerë të shtuar dhe shërbime dhe produkte unike bankare, që do të plotësojnë nevojat e klientëve individual. Potenciali i tregut na shtyn të forcojmë pozicionin tonë në sektorin bankar të Kosovës me konceptin e bankimit për klientë individual dhe të rrisim më tej pjesën tonë të tregut në kreditë individuale dhe të vazhdojmë të mbajmë një cilësi shumë të shëndetshme të kredisë. Përveç strategjive të shitjeve tona, si vlerë e shtuar në strategjinë tonë të rritjes së kredive do të jetë mundësia digjitale për rritje të

kreditimit, përdorimi i fuqisë së të dhënave dhe MMK (Menaxhimi i Marrëdhënies me Klientë) për të krijuar avantazhe të reja në shitje, si dhe partneritete me BERZh-in për financimin e kredisë së gjelbër, me kompanitë ndërtimore për financimin e hipotekave, tregtarët e autorizuar të industrisë së automobilave dhe institucionet arsimore për të zgjeruar gamën e ofertave të huadhënies për klientë individual.

TEB Sh.A kujdeset të ofrojë produkte unike të kursimit që janë të rëndësishme për thjeshtimin e kursimeve të klientëve dhe nxitjen e qarkullimit të parave përmes bankës. Strategjitë tona kryesore janë rritja e depërtimit të produkteve të menaxhimit të parave të gatshme në kompanitë dhe institucionet e biznesit, me synim të rritjes së pagave të stafit. Qasja në masë dhe individuale e marketingut do të ndërmerret për të rritur numrin e depozituesve duke ofruar programe unike kursimi.

Bankimi për klientë individual synon të ndërtojë një bazë të gjerë të klientëve individual (bankimi masiv dhe privat), për të qenë banka e tyre kryesore në një marrëdhënie afatgjatë dhe të mbulojë nevojat e tyre kryesore financiare me një gamë të përshtatur produktesh dhe shërbimesh. Modeli i shërbimit dallon në të gjithë Kosovën për tregun e bankimit individual, të ndarë në segmente përkatëse për të optimizuar kënaqësinë e klientit dhe përfitueshmërinë tonë. Ne shfrytëzojmë kanale të ndryshme të përvetësimit (prospektimi i bankës, biznesi i pagave, etj.) për të rritur profitabilitetin në bazën e klientëve tanë.

Viti 2018 ishte një vit tjetër i suksesshëm që konfirmoi se strategjia jonë është e përshtatshme për tregun e bankimit individual dhe klientët me të cilët ne punojmë. Strategjia jonë është të vazhdojmë investimin tonë në zgjedhjet digjitale

mirëpo të mirëmbajmë ndërveprimin njerëzor me bankierët personal.

### **Prioritetet për vitin 2019?**

**Klienti në qendër** – Në vitin 2019 ne synojmë të mbajmë modelin e biznesit tonë të klientit në qendër, gjë që është shumë e rëndësishme për ne, për empatinë për klientin gjatë proceseve operacionale, lehtësimin e ndërveprimit të drejtpërdrejtë me klientët, demokratizimin e perceptimeve të klientit dhe lidhjen e kulturës së punonjësve me rezultatet e klientit.

**Optimizimi i shpërndarjes** – Vlera e degëve tona do të bazohet në produktet dhe shërbimet bankare të zhvilluara plotësisht në kombinim me përvojën e konsiderueshme të klientit.

**Thjeshtimi i biznesit dhe modeli i operimit** - Për të mbështetur objektivat tona, strategjitë kryesore të bankimit me klientë individual janë modele të reja të biznesit me mundësi digjitale në fokus, optimizimi i proceseve të brendshme, zgjerimi i ofertave të reja bankare, përmirësimi i mundësive të analizës së të dhënave, përmirësimi i përvojës dhe segmentimi i bazës së klientëve nga perspektiva të ndryshme.

**Marrja e një avantazhi të informatës (Modeli MMK)** – TEB do të vazhdojë të investojë në mjete inteligjente të analizës së të dhënave për të krijuar avantazhe të ndryshme në mënyrë të drejtpërdrejtë për klientët tanë përmes kanaleve të ndryshme dhe po ashtu për stafin tonë gjatë takimit të tyre me klientët për t'iu përshtatur nevojave të tyre financiare.

**Inovacioni** - Inovacioni do të jetë faktori i vetëm më i rëndësishëm i segmentit tonë që nxit rritjen e qëndrueshme në fushën e bankimit për klientë

individual gjatë viteve të ardhshme. Produktet e reja, bërja e gjërave ndryshe, fushatat inovative që do të na ndihmojnë të krijojmë një përvojë të shtuar të klientëve.

## **4.2. Biznesi i kartelave**

Viti 2018 ishte shumë i suksesshëm për biznesin e kartelave, ku ka pasur më shumë se 17,000 kredit kartela të reja të miratuara, që është pothuajse dy herë më shumë në krahasim me vitin 2017. Edhe një herë, 'Starcard' (Star Kartela) ka dëshmuar të jetë produkti më i dëshirueshëm i kredit kartelës në tregun tonë. Duke iu përshtatur nevojave të klientëve tanë dhe tendencave të tregut, ne kemi forcuar pozitën tonë në treg si zgjedhje të parë të klientit.

Siç është premtuar, ne kemi lansuar një platformë të pagesës 'e-commerce' (e-tregtimi) për tregtarët tanë. Për herë të parë në Kosovë, klientët e Starcard-ës tani mund të blejnë mallra nga tregtarët tanë deri në 24 këste dhe të përdorin pikat e bonusit të grumbulluara përmes kanalit 'e-commerce'.

Ne kemi lansuar 'e-commerce' me Federatën e Futbollit të Kosovës, ku biletat e lojës të Ekipit Kombëtar të Futbollit të Kosovës mund të blihen vetëm përmes internetit. Ngjashëm me këtë, për herë të parë në Kosovë, energjia elektrike mund të paguhet nga uebfaqja e Kompanisë së Furnizimit me Energji të Kosovës (KESCO) ose aplikacioni i telefonisë mobile (android dhe iOS)

Për t'i dhënë klientëve tanë përvojën më të mirë gjatë blerjes me Starcard në терминаlet e POS ('Points of Sale' / Pikat e Shitjes) të TEB, më shumë se 200 fushata të ndryshme janë organizuar për mbajtësit e Starcard-ës, fushata të tilla si zhvendosja e kësteve që u lejon klientëve të

blejnë nga tetori deri në dhjetor, ndërsa pasqyra e borxhit e shtyer për tre muaj, përkatësisht nga janari në mars. Fushatat për bonuset shtesë janë organizuar në bashkëpunim me tregtarët tanë kryesorë, duke dhënë 5% bonus për çdo blerje.

Premium Starcard-a mbetet sot e kësaj dite, kredit kartela më e privilegjuar në treg. Ka më shumë se 50 tregtarë në sektorë të ndryshëm, ku klientët tanë mund të shpërblehen deri në 15% bonus për çdo transaksion.

Në përgjithësi, kemi shpërndarë më tepër se €500,000 pikë bonusi në kredit kartela. Në vitin 2018, ne kemi pasur një rritje më shumë se 14% në qarkullim të POS, duke vazhduar edhe një herë për të qenë lider në Kosovë me 42% të pjesës së tregut në qarkullimin POS. Ky zhvillim i rëndësishëm tregon angazhimin e bankës sonë në zgjerimin e rrjetit POS dhe aktivizimin e përdoruesve të kartelave me fushata të ndryshme të nxitura nga bonuset.

Që kur kemi filluar me pranimin e kartelave pa kontakt ('contactless cards') në терминаlet POS, ka pasur më shumë se 50,000 transaksione me

kartela pa kontakt me kartelën tonë dhe kartela të tjera bankare. Për të ndihmuar në rritjen e vetëdijesimit në përdorimin e pagesave me kartela pa kontakt ('contactless'), ne kemi investuar në promovim të produktit, reklama televizive, doracakët për përdorim dhe reklama të tjera. Ne kemi investuar në blerjen e 1,000 terminaleve shtesë POS pa kontakt, duke zëvendësuar terminale POS të vjetra, me qëllim që të sigurojmë përvojën më të mirë për klientët tanë.

Siguria e kartelave është një nga prioritetet tona më të mëdha, prandaj në infrastrukturën e rrjetit tonë janë duke u bërë investime të rregullta. Ky proces menaxhohet nga ekipi ynë i monitorimit jashtëzakonisht vigjilent në kohë reale. Ne besojmë se siguria e transaksioneve është padyshim një nga sukseset tona për shkak se transaksionet mashtruese në tentativë duke përdorur kartelat tona dhe rrjetin tonë mbeten mjaftueshëm nën tendencat e sektorit.

Visa 3D Secure i bën blerjet dhe pagesat përmes internetit të sigurt dhe të shpejta me kartelat tona debit ose kredit. Teksa teknologjia bëhet gjithnjë e më e sofistikuar, mashtrimi me kartela

**Duke iu përshtatur nevojave të klientëve tanë dhe trendeve të tregut, ne kemi përforcuar pozitën tonë në treg si zgjedhje të parë të klientit**

**Në vitin 2018, ne kemi rritur më tepër se 14% qarkullimin në POS, duke vazhduar edhe një herë të kemi rolin prijës në Kosovë me 42% të pjesës së tregut në qarkullimin POS**



në të gjithë botën po përhapet me ritëm dinamik. TEB-i ka investuar shumë në siguri të avancuar për rrjetin tonë të infrastrukturës.

Ne po ashtu kemi pasur një vit shumë të suksesshëm në debit kartelë duke rritur numrin tonë të kartelave nga 150.648 kartela debiti në vitin 2017 në 180.797 në dhjetor 2018.

Ne kemi rritur për 17% numrin e debit kartelave dhe 20% në transaksione POS me debit kartela. Ndërkohë që numri i debit kartelave është në rritje, nevoja për ATM është duke u rritur gjithashtu, prandaj ne kemi vendosur edhe 10 ATM shtesë me funksionin paratë brenda ('cash in') në gjithë vendin. Kjo strategji na ka ndihmuar të rrisim 16% në total transaksionet në ATM.

Me një bazë klientësh në rritje, nevoja për të garantuar shërbime më të mira është prioritet. Prandaj, kemi zgjeruar ekipin e shitjes direkte dhe aktivitetet e tij. Tani, jemi edhe më afër klientëve tanë dhe të aftë për t'iu përgjigjur më shpejtë dhe më besueshëm nevojave të tyre. Ekipi i shitjeve direkte është po ashtu në dispozicion për të ofruar informata për ofertat speciale për të cilat klienti mund të ketë të drejtë përdorimi. Po ashtu, në mënyrë përkatëse këshillon klientët mbi produktet dhe shërbimet e reja në dispozicion nga banka që ne i konsiderojmë se mund të jenë në interesin dhe përfitimin e tyre. Gjatë gjithë vitit dhe në partneritet me tregtarët, Banka ka iniciuar fushata të shumta të personalizuar, duke ofruar propozime të ndryshme që karakterizojnë plane shtesë të pagesave, zbritjeve, periudha grace dhe produkte të bonusit.

### **Çfarë ka më tutje?**

Me suksesin e pagesave pa kontakt ('contactless') të MasterCard, në vitin 2019 planifikojmë të marrim dhe lëshojmë kartela Visa pa kontakt,

në mënyrë që të gjithë klientët tanë dhe jo kartelat tjera bankare të mund të kryejnë transaksione pa kontakt në rrjetin e transaksioneve të terminaleve tona POS.

Në vitin 2018 kemi pasur disa kompani ndërkombëtare të mirë-njohura jashtëzakonisht të mëdha që gjatë hapjes së biznesit të tyre në Kosovë kanë bashkëpunuar me TEB Sh.A. Kjo na ofron mundësinë për të zhvilluar kartelat e përbashkëta ('co-branding cards') promovuese që do t'u ndihmojë klientëve tanë të përfitojnë nga rrjeti i tyre në gjithë globin.

TEB vazhdimisht përcjell dhe investon në tiparet më të reja të biznesit të kartelave që janë në trend global. Kjo na mundëson ta ruajmë pozitën udhëheqëse në tregun tonë dhe të jemi mundësia më e mirë për klientët dhe tregtarët.

## **4.3. Bankimi për NVM-të**

TEB, në kuadër të aktiviteteve të segmenteve të bankimit të NVM-ve, vazhdon të përmirësojë vazhdimisht produktet dhe shërbimet që ofron për NVM-të. Duke monitoruar nga afër zhvillimet në këtë sektor dhe në ekonominë në përgjithësi, Banka u ka ofruar NVM-ve produkte kryesore bankare dhe është prezantuar me zgjidhje alternative të ndryshme në fusha të ndryshme që paraqesin sfidat më të mëdha për NVM-të për t'i ndihmuar ata të zhvillohen dhe të përgatiten për biznesin e ardhshëm.

### **Portfolio e huadhënies në rritje të vazhdueshme**

Viti 2018 ishte një vit tjetër i suksesshëm për segmentin NVM. Portfolio e kredisë dhe paradhëniet në para të gatshme për klientët janë rritur për 5.62 milion euro apo 7.4% ndërsa depozitat nga klientët për 12.1 milion euro apo

16%. Këto rezultate tregojnë angazhimin e bankës për sektorin e NVM-ve dhe përgjigjen pozitive të klientëve / NVM për konceptin e bankës tonë dhe modelin e afarist.

Rezultatet pozitive po ashtu janë arritur në menaxhimin e KJP ku rënia në krahasim me vitin e kaluar është nga 4.07% në 2.45%.

### **Zhvillimi strategjik**

Segmenti i bankimit NVM ndjek strategjitë e biznesit të orientuara drejt përmirësimit të efikasitetit të brendshëm dhe përshtatjes së modeleve të biznesit aktiv që rrisin komunikimin me klientët e tyre gjatë partneritetit me palët e treta për të ofruar fushata të paralajmëruara dhe zgjidhje të fokusuara në nevojat financiare dhe jo-financiare të klientëve.

Kjo qasje doli të jetë e suksesshme dhe mbështetëse në arritjen e këtyre rezultateve. Ri-organizimi i brendshëm në rajone ka rezultuar me efikasitet më të lartë, ka lehtësuar komunikimin me klientë dhe perceptimet e shtuara të shitjeve. Sjellja e ngushtë e pikëpamjeve midis degës dhe zyrës qendrore ka lehtësuar procesin e shitjeve dhe blerjen e klientëve.

Proceset operacionale kanë mbështetur aktivitetin e kreditimit të kryer nga segmenti i NVM-ve. Përmirësime drejt një procesi të thjeshtë dhe efikas ku ndërveprimi i klientit kërkohet janë duke u zbatuar me shpejtësi. Kjo çon në një cilësi më të mirë shërbimi, efikasitet më të lartë brenda bankës dhe kapitalizim në mundësitë tregtare në anën e klientit.

### **Klientët NVM kërkojnë produkte dhe shërbime në shkallë të ndryshme**

Aktivitetet e departamentit Agro kanë konfirmuar orientimin e bankës në kreditimin dhe zhvillimin e Agro bizneseve. Pasi që është një nga segmentet më të rëndësishëm për balancimin e zhvillimit ekonomik duke ofruar mundësi për zonat rurale për të shfrytëzuar tokën dhe për të krijuar vlerë për njësitë e familjes dhe shoqërinë.

TEB përmes përvojës së saj në këtë segment dhe aktivitetet e shitjes arriti të gjenerojë rritje në pjesën e tregut. Në këtë drejtim, rol të rëndësishëm kanë luajtur subvencionet e qeverisë në formën e granteve. Banka ka financuar pranuesit e granteve dhe projektet e tyre në huadhënien prej 1.66 milion euro. Përveç kësaj banka ishte aktive në dizajnimin e fushatave të përshtatura si fushatat sezonale dhe fushatat me klientë që ishin atraktive për tregun dhe përkrahën aktivitetet e ndryshme investuese të klientëve. Gjatë vitit 2018 departamenti i agros arriti të realizojë një rritje prej 1.7 milion euro dhe në të njëjtën kohë arriti të zvogëlojë KJP nga 4.8% në 3.96%.

Një faktor shumë i rëndësishëm për rritjen e kredive në segmentin e NVM-ve ishte garancia që banka e kishte me Fondin e Kosovës për Garantimin e Kredive. Gjatë pjesës së parë të vitit banka ka përdorur limitin e alokuar dhe në maj të vitit 2018 ka aplikuar rritjen e limitit me fondin. Ky shërbim i garancisë u dëshmuar të jetë një mjet tejet i vlefshëm dhe mbështetës për biznesin dhe për vetë bankën. Kjo është në përputhje me strategjinë e departamenteve për rritjen e qasjes në kapital për NVM me rritje të shpejtë dhe përveç kësaj me kontributin në rritjen e punësimit dhe konkurrencën më të madhe në treg.

Për aktivitetet që lidhen me shërbimet jo-financiare, banka gjatë vitit 2018 ka vazhduar të kontribuojë në rritjen e kapaciteteve të menaxhimit

të kompanive të NVM-ve duke ndarë praktikat më të mira përmes programeve të saj. Kështu, banka ka organizuar "Akademi Biznesi" të fokusuar në sfidat dhe mundësitë që dalin nga globalizimi, rëndësinë e planifikimit strategjik dhe menaxhimin e rritjes. Njëkohësisht, banka ka qenë aktive në promovimin e programit të ndërmarrësisë së grave, pasi që në partneritet me BERZh-in ka organizuar 11 aktivitete për Gratë në Biznes, ku nëpërmjet përmbajtjes së përshtatur ka vazhduar në fuqizimin e grave për t'u angazhuar në aktivitetet afariste.

Duke synuar zgjerimin dhe avancimin e kanalit alternativ të ofrimit të shërbimeve, banka është përqendruar shumë në promovimin e tipareve dhe shërbimeve të ndryshme të Kanaleve Alternative të Shpërndarjes. Me këtë, mundësitë e ofruara klientëve janë ofrimi i një përvoje mjaft miqësore në një gamë të gjerë të funksionalitetit që kursen kohë dhe shpenzime bankare për klientin.

Në këtë drejtim, një nga shërbimet e promovuara mjaft shumë dhe pranuar pozitivisht nga tregu ka qenë procesimi i pagave nëpërmjet 'E-Banking' për biznese. Nëpërmjet këtij shërbimi, banka ka arritur të përmirësojë më tej shërbimet e saj të menaxhimit të parasë dhe të kontribuojë në cilësinë e shërbimit ndaj klientëve të saj. E-banking për biznese dhe kanalet alternative të ofrimit të shërbimeve do të mbeten në fokus të bankës edhe në vitin e ardhshëm, po ashtu do të shtohen më shumë tipare që do të përmirësojnë përvojën e përdorimit të klientëve tanë.

### **Çfarë ka më tutje?**

Arritjet dhe rezultatet pozitive të vitit 2018 si në aspektin e shifrave ashtu edhe të zhvillimit të biznesit na inkurajojnë të vazhdojmë me të njëjtat

ambicie në vitin 2019. Banka do të vazhdojë të ofrojë zgjidhje dhe qasje në financa për NVM-të me qëllim të kapitalizimit të dinamikës së tyre dhe ideve të reja për tregun.

Pritet që të lansohet 'M-Banking' për biznese dhe të rritet vlera e marrëdhënieve me bankën tonë, pasi që disa shërbime si transferi i parave, pagesat tatimore dhe doganore do të jenë në dispozicion. Bashkëpunimi me Fondin Kosovar për Garanci Kreditorë dhe BERZh-in janë pjesë për-

**Banka ishte aktive në promovimin e programit të ndërmarrësisë së grave dhe në partneritet me BERZh-in ka organizuar 11 ngjarje "Gratë në Biznes" ku përmes përmbajtjes së përshtatur ka vazhduar të fuqizojë gratë për tu angazhuar në aktivitetet e biznesit**

## 4.4. Bankimi komercial dhe për korporata

Nëpërmjet marrëdhënieve të saj të afërta me klientët dhe qasjes së orientuar drejt zgjidhjeve, TEB Sh.A. është një lojtar mjaft i dukshëm në segmentin komercial dhe të korporatave. Në TEB, e pranojmë se ky segment i caktuar i klientëve është më kompleks sa i përket nevojave dhe si i tillë ne kemi zhvilluar një strategji të zgjidhjeve të përshtatura dhe të avancuara të shërbimeve të menaxhimit të parasë së gatshme për t'iu ofruar klientëve tanë një sistem të vlerës së shtuar që është me përfitim edhe për bankën.

Si në vitet e mëparshme, strategjia jonë në vitin 2018 u përqendrua në rritjen e pjesës sonë të tregut dhe profitabilitetit. Kjo e fundit u dëshmuar të jetë sfiduese, sepse tregu diktoi një rënie të konsiderueshme në normat e interesit, ndërsa numri i kufizuar i klientëve në këtë segment kërkon një qasje proaktive nga Banka. Departamenti ka arritur një rritje prej 5.1 milion Euro në kreditë në këste, ose një rritje prej 10.25% në krahasim me vitin e kaluar.

Tregu i vlerëson ofertat cilësore të Bankës TEB në shërbime të tilla si transferet, pagesat përmes terminaleve POS dhe transaksionet e tjera. Ne kemi vazhduar të ofrojmë zgjidhje të avancuara të menaxhimit të parave të gatshme, siç është rrjeti i zgjeruar i terminaleve POS, debit dhe kredit kartelat për biznese dhe e-banking të avancuar për biznese me tipare dhe opsione të shumta. Zgjerimi i kanaleve alternative të ofrimit të shërbimeve dhe rritja e zgjidhjeve të menaxhimit të parave është një qasje e rëndësishme strategjike për vitet e ardhshme, sepse tregu i biznesit po kërkon partneritete më efikase dhe më të gjera. Një nga produktet që ne kemi lansuar gjatë vitit 2018 është shërbimi 'drop

box'(kutitë e depozitimit) / mbledhja e parave të gatshme që fillimisht është ofruar për klientët e zgjedhur të korporatave. Një nga prioritetet e veçanta të Bankës në vitin 2018 ishte rritja e efikasitetit në operacione.

Ne kemi investuar shumë kohë dhe përpjekje të konsiderueshme në promovimin e gamës së gjerë të opsioneve dhe përfitimeve të shumta që ofron 'e-banking' për biznese. Kjo iniciativë ka rezultuar mjaft e suksesshme, sepse shumë klientë kanë filluar ta përdorin përdorin 'e-banking' për nevojat e tyre të përditshme bankare. Si rezultat, 72% e transaksioneve totale (mesazhet e transfereve ndërkombëtare dalëse (IOMT) dhe transferet kombëtare të parave (NMT)) janë kryer duke përdorur 'e-banking'.

Ky ndryshim në sjelljen e klientëve përbën një arritje të rëndësishme për departamentin, sepse zvogëlon ngarkesën e punës në degë dhe i mundëson ekipeve të degës të kalojnë më shumë kohë për këshillim dhe përkrahje për klientët.

Në forcimin e marrëdhënieve me klientët, Banka ka vazhduar ofrimin e shërbimeve jo-financiare në formë të këshillave biznesore për klientët korporata. Kjo tregon se fusha e bashkëpunimit me klientët e korporatave është e kufizuar vetëm nga kreativiteti dhe imagjinata, pasi që mundësitë janë të pafundme.

Sa i përket bashkëpunimit sinergjik, të qenit pjesë e BNP Paribas e ka bërë më të lehtë procesin e pranimit të një numri të konsiderueshëm të kompanive të huaja multi-nacionale gjatë vitit 2018.

### **Çfarë ka më tutje?**

Ne jemi të përkushtuar në rritjen e bashkëpunimit tonë me segmentin e korporatave dhe kemi një

ide të qartë se si të arrihet ky objektiv. Ne do të vazhdojmë të fusim në përdorim produkte të reja të menaxhimit të parasë në vitin 2019, për të lehtësuar punën e klientëve tanë të korporatave dhe arritur përmirësimin e efikasitetit përmes operacioneve tona. Si bankë, do të vazhdojmë të mbështetemi në inovacion dhe zgjidhje të përshtatura për ta arritur një pjesë më të madhe të biznesit të klientëve të korporatave dhe për të rritur pjesën tonë të tregut dhe profitabilitetin. Në të njëjtën kohë, në mënyrë aktive do të synojmë projektet në sektorin e prodhimit dhe eksportit pasi që ato shihen si pika strategjike për rritjen e mëtejme të korporatave dhe rritjen e përgjithshme të ekonomisë. Ne do të vazhdojmë të jemi në dijeni për përgjegjësitë tona në një ekonomi në rritje.

## 4.5. Financat tregtare

TEB SH. A. e kupton se biznesi ndërkombëtar në një botë të globalizuar është sfida – një sukses që kërkon njohuri të gjera profesionale dhe rrjet të efektshëm dhe TEB-i i ka të dyja.

Gjatë vitit 2018, ne kemi vazhduar t'i përkrahim klientët tanë duke krijuar dhe përshtatur zgjidhje të financave tregtare për nevojat e tyre të biznesit. Për më tepër, kemi punuar vazhdimisht në zgjerimin e rrjeteve tona, forcimin e marrëdhënieve me bankat e tjera dhe ngritjen e mëtejme të standardeve tona të larta të profesionalizmit dhe kompetencës.

Të mbështetur nga prania globale dhe ekspertiza në tregtinë ndërkombëtare e BNP Paribas dhe TEB A.Ş., ne vazhdimisht zgjerojmë përfshirjen tonë gjeografike dhe gamën e produkteve tona.

Produktet e financave tregtare për operacionet e biznesit dokumentar përfshijnë letër kreditë e importit dhe eksportit, skontimin në letër

kredi, garancitë vendore dhe ndërkombëtare, letër kreditë në pritje ('stand-by') dhe arkëtimet. Marrëveshja e nënshkruar në vitin 2011 me programin e tregtisë së Korporatës Ndërkombëtare Financiare (IFC-së) na ka dhënë një mundësi të shkëlqyer dhe më shumë fleksibilitet për t'iu përgjigjur kërkesës në lidhje me letër kreditë e konfirmuara dhe kundër garancitë. Gjatë vitit raportues, ne po ashtu kemi zgjeruar më tej marrëdhëniet tona me banka të reja korrespondente.

TEB Sh.A. ka mbështetur vazhdimisht klientët e saj dhe synon të jetë gjithmonë partneri më i besueshëm dhe i preferuar i biznesit në Kosovë, duke vazhduar ta ndajë profesionalizmin dhe ekspertizën në produktet e financave tregtare me klientët tanë duke ofruar edhe zgjidhje inovative.

### Çfarë ka më tutje?

Në vitin e ardhshëm, do të vazhdojmë t'i mbështesim klientët tanë, duke ofruar një urë të sigurt për mundësi të reja. Profesionalizmi dhe ekspertiza do të jenë udhëzuesit tanë, sepse i shohim këto si elemente që të bëjnë të dallueshëm në një botë që lëviz me shpejtësi. Ngjashëm me këtë, ne synojmë të shtojmë produkte të reja të tregtisë ndërkombëtare në gamën tonë të produkteve të vitit 2019.

## 4.6. Sistemet e pagesave

TEB-i ka qenë e para që ka futur në funksion sistemin e debitimit direkt (SDD), produkt unik në tregun e Kosovës që është e dizajnuar për të përkrahur bashkëpunimin komercial B2B ('business to business' / biznes me biznes). Funkcioni i saj kryesor është përmirësimi i likuiditetit financiar të klientëve tanë të biznesit duke ofruar menaxhimin e plotë të llogarive të

arkëtueshme dhe të pagueshme. Ai konsiderohet si sistemi më efektiv i menaxhimit të rrjedhës së parasë pasi përkrahet nga teknologjia dhe ndërfaqet më të fundit që lehtësojnë procedimin e plotë dhe automatik të pagesës së faturave. Kjo i mundëson klientëve që të na autorizojnë për të debituar (tërhequr) automatikisht mjete direkt nga llogaria e tyre bankare për të bërë pagesa të ndryshme mujore për kompani të ndryshme publike dhe private. Kjo kërkon vetëm një formular të autorizimit (të nënshkruar nga klienti) dhe transaksioni përkatës do të kryhet në mënyrë automatike. Klientët me SDD marrin linjë kreditore të dedikuara që mundëson pagesat për furnizuesit dhe garanton se kushtet e pagesës së faturës respektohen plotësisht. Hapi tjetër logjik ishte futja e skontimit të SDD-së që garanton të arkëtueshmet. Duke zbatuar skontimin e SDD-së, klienti konsolidon financat dhe përfiton nga arkëtimi i hershëm i të arkëtueshmeve. Shërbimi ynë ultra-modern online shfrytëzon sistemet më të avancuara të sigurisë dhe jep qasje 24/7 në shërbime bankare të sigurta, të përshtatshme dhe të shpejta. Klientët tanë mund t'i transferojnë fondet në mënyrë elektronike te përfituesit në mbarë botën dhe të procedojnë pagesa vendore, duke përfshirë pagesën e shërbimeve komunale dhe debi të tjera të rregullta (si rryma, uji dhe telefoni). Për më tepër, klientët mund t'i kryejnë pagesat për Administratën Tatimore të Kosovës (ATK) në mënyrë automatike duke përdorur e-banking. Projekti i PBKR - Sistemit të Pagesës Bruto në Kohë Reale ka përfunduar me sukses në korrik të vitit 2016 dhe të gjitha pagesat vendore duke përfshirë pagesat në vlera të larta tani procedohen në kohë reale.

Në ditët e sotme, transferet e shpejta dhe të sigurta ndërkombëtare të parave janë me rëndësi të madhe për klientët me ambicie ndër-kufitare. Kjo është arsyeja pse ofrojmë një shërbim që është mënyra më e lehtë, më e shpejtë dhe më e besueshme për të bërë pagesa ndërkombëtare.

Nëpërmjet rrjetit tonë të gjerë me mbi 50 RMA ('Relationship Management Application' / Shërbimi i Menaxhimit të Marrëdhënieve me Klientë) me bankat e huaja dhe 10 banka për plasim, pagesat ndërkombëtare dalëse mund të kryhen për përfituesit e huaj në të gjithë botën. Si anëtar i SWIFT-it, rrjetit më të madh në botë të pagesave, klientët tanë gëzojnë një përparësi të qartë, sidomos në pagesat ndërkombëtare dalëse. Pagesat ndërkombëtare hyrëse mund të menaxhohen duke përdorur të njëjtin sistem. Kjo do të thotë që jemi në gjendje të ofrojmë shërbime të pagesave që janë udhëheqëse në treg, gjithashtu nëpërmjet aktiviteteve të brendshme shumë efektive dhe përmes zgjerimit të vazhdueshëm të rrjetit tonë global.

## 4.7. Thesari dhe MPD (menaxhimi i pasurive dhe detyrimeve)

Departamenti i Thesarit dhe MPD i TEB Sh. A. është përgjegjës për menaxhimin efektiv të rrjedhës së parasë së gatshme, rrezikut të likuiditetit dhe bilancit të bankës sipas limiteve të përcaktuara nga rregullatorët ndërkombëtarë dhe vendorë. Roli i Departamentit është thelbësor për ta siguruar vazhdimësinë e operacioneve ditore të Bankës dhe për t'u siguruar se ato janë në linjë me nivelet e identifikuar të rrezikut që kërkon përshtatje të vazhdueshme me zhvillimet dhe pritjet në treg dhe ekonomi.

Viti 2018 ishte një vit i suksesshëm sa i përket performancës së përgjithshme të bankës. Asetet arritën në 500 milion euro në korrik 2018 dhe bilanci i përgjithshëm është rritur përafërsisht për 14.9% në fund të vitit 2018. Portfolio e kredive bruto ka pasur rritje prej 4.9% ndërsa depozitat kanë pasur rritje për 19.4% në krahasim me vitin 2017. Klientët individual mbetën si burimi kryesor i financimit në vitin 2018, duke përfaqësuar 74% të totalit të depozitave bankare në përputhje me tregun.

Aktivitetet nga Departamenti i Thesarit-MPD (Menaxhimi i Pasurive dhe Detyrimeve) luajtën një rol të madh në sigurimin e kësaj besueshmërie dhe mundësuar që TEB Sh.A. të qëndrojë në mënyrë solide dhe të fuqishme gjatë kësaj periudhe sfiduese.

Përvoja, njohuritë teorike dhe teknike, gama e gjerë të produkteve dhe zgjidhjet inovative të përshtatura janë përparësitë kryesore që e çojnë Departamentin e MPD -Thesarit TEB Sh.A. drejt suksesit. Infrastruktura e avancuar teknologjike dhe baza e të dhënave janë faktorë të tjerë të rëndësishëm që rezultojnë në performancën e suksesshme të Thesarit.

Është shumë e rëndësishme që Banka të ketë nivelin e kërkuar të likuiditetit në të gjitha valutat aktive për të qenë në shërbim të klientëve të saj dhe që t'i përmbushë të gjitha detyrimet e saj me koston më të vogël të mundshme. Kjo është duke u realizuar përmes rrjedhjes ditore efektive të parave dhe menaxhimit afat-mesëm dhe afat-gjatë të likuiditetit duke përdorur qasjen ekskluzive të departamentit në kapitalin dhe tregjet e parasë vendore dhe ndërkombëtare.

Rreziqet e hendeqeve të normës së interesit dhe të këmbimit valutor ('foreign exchange' - FX) për bilancin e gjendjes që janë të natyrshme për shkak të natyrës së biznesit gjithashtu janë duke u menaxhuar nga departamenti duke përdorur instrumente të ndryshme në dhe jashtë bilancit të gjendjes për mbrojtje nga humbjet e mundshme.

MPD - Thesari kanë njohuri shumë të mirë për rrezikun në kryerjen e biznesit të tyre që është në përputhje me qasjen e kujdesshme të TEB Sh.A. Për ta bërë këtë, ky departament përpiket të mbajë kombinimin optimal të financimit me menaxhimin e vazhdueshëm të likuiditetit dhe të hendekut të normave të interesit në përputhje me objektivat e bilancit, strategjitë e biznesit dhe pritjet ekonomike. Për më tepër, në

aspektin e menaxhimit të rrezikut, MPD-Thesari menaxhojnë asetet dhe detyrimet duke analizuar vazhdimisht rreziqet e mundshme dhe mundësitë e tregut në kuadër të rregullave të përcaktuara nga Banka Qendrore e Kosovës, Bordi i Drejtorëve dhe Komisioni i aseteve dhe detyrimeve (KAD). Zyra e MPD-së në kuadër të departamentit udhëzon njësitë e biznesit për të arritur targetet e tyre përderisa mbrojnë profitabilitetin përmes centralizimit të rrezikut të normës së interesit përmes politikës së efektshme së çmimore për transfer të fondeve. Departamenti ka mbështetje të fuqishme nga të dy kompanitë e saj amë franceze dhe turke në kontrollin e rrezikut dhe kryerjen e detyrave të saj.

### **Çfarë ka më tutje?**

Rreziqet politike mbeten të larta në mbarë botën dhe ekonomitë e mëdha po tregojnë shenja të ngadalësimit. Zgjerimi global është dobësuar, në veçanti në Evropë dhe Azi. Ekonomia globale është parashikuar të rritet me 3.5% në 2019 dhe 3.6% në vitin 2020. Kushtet e reja të likuiditetit në fund do të bëjnë më shumë presion mbi kostot. Rregullat e reja rregullative në përputhje me standardet ndërkombëtare po e ri-formësojnë mënyrën se si funksionon tregu në mënyrë më të rreptë.

Megjithëse këto shifra tregojnë për një vit të butë 2019, ekonomia e Kosovës vazhdon të tejkalojë shumë vende të tjera në rajon, rritja e BPV-së në 2019 pritet të jetë rreth 4.2% (më e larta në mes të vendeve të Ballkanit) të mbështetura nga një konsum. Bankat po ashtu janë kapitalizuar mirë dhe normat KJP janë më të ulëtat në rajon, këto janë duke shkaktuar një rritje të konkurrencës midis institucionit financiar. Remitancat janë duke u forcuar; të gjithë treguesit ekonomikë janë arritur në përputhje me kërkesat e FMN-së. Qeveria po planifikon të investojë më shumë për ta zvogëluar hendekun e infrastrukturës.

Termocentrali i ri i propozuar (me kosto ndërtimi prej rreth 20% të BPV-së) do të mbyllte hendekun e furnizimit të brendshëm të energjisë dhe do të japë një impuls të zhvillimit (10,000 vende pune), por nga ana tjetër mund të zgjerohet deficitin e llogarisë rrjedhëse gjatë ngushtimit të saj.

Pas përmirësimeve të fundit politike, liberalizimi i vizave me BE-në pritet të finalizohet në vitin 2020. FMN, Banka Botërore, BERZh-i përkrahin fuqishëm zhvillimin dhe interesimet e reja për arritjen në vend të emrave ndërkombëtarë.

Përkundër kushteve më të vështira të tregut, Kosova do të mbetet si një ekonomi në rritje dhe do të vazhdojë të gëzojë fluksin e likuiditetit, ndërkohë që ne do të vazhdojmë ta përkrahim ekonominë duke siguruar fuqinë e likuiditetit tonë dhe aftësinë paguese me parimet tona të menaxhimit të rreptë të rrezikut dhe të pajtueshmërisë së bashku me respektin maksimal të ligjeve vendore dhe ndërkombëtare.

## 4.8. Burimet njerëzore

### Politika e burimeve njerëzore

Punonjësit janë asetet më të rëndësishme të TEB Sh. A., meqë përpjekjet e tyre i ndihmojnë bankës për t'i arritur objektivat e saj strategjike. Departamenti i Burimeve Njerëzore përpiket të:

- Ketë ambient miqësor të punës, politikë të dyerve të hapura, duke siguruar një sinergji ndërmjet ekipeve me qëllim të krijimit të mjedisit më të mirë të punës për punonjësit tanë.
- Punësojë dhe mbajë punonjës dinamikë që janë të gatshëm të përshtaten me kulturën tonë dinamike të punës, të cilët janë anëtarë të mirë

të ekipit dhe kanë potencial për rritje.

- Trajnojë dhe zhvillojë punonjësit me programet tona të brendshme dhe të jashtme, si dhe programet e vazhdueshme të trajnimit të BNP Paribas, në mënyrë që punonjësit të jenë të informuar për politikën, procedurat, proceset, produktet dhe shërbimet e reja bankare dhe të informohen vazhdimisht për kërkesat e grupit.

- Kontribuojë në zhvillimin e punonjësve tanë më të mirë gjatë organizimit të programeve të zhvillimit, me qëllim të krijimit të bazës menaxhuese për nevojat e ardhshme të bankës, dhe t'i bëjë punonjësit të vetëdijshëm për rëndësinë e tyre për bankën.

- Ofrojë mundësi të barabarta për çdo person gjatë rekrutimit, transferit, avancimit ose planeve të zhvillimit, në bazë të meritës.

Banka ka pasur rritje të suksesshme në vitin 2018 në rajon falë kontributit të punonjësve të saj të rinj, të devotshëm dhe energjik.

Prandaj, fokusi kryesor i politikës së burimeve njerëzore është mobiliteti i brendshëm, zhvillimi i vazhdueshëm i aftësive dhe njohurive të punonjësve si dhe promovimi i vazhdueshëm i të gjitha formave të diversitetit.

## Progresi dhe zhvillimi i karrierës

Në fund të vitit 2018, ekipi i plotë i TEB-it kishte 604 punonjës. Gjatë këtij viti u rekrutuan gjithsej 106 profesionistë të shërbimeve bankare dhe financiare. Në aspektin e lëvizjes gjeografike dhe funksionale, 173 punonjës të TEB-it janë avancuar ose iu janë dhënë sfida të reja gjatë vitit 2018. Me rastin e hapjes së pozitave të reja



ne gjithmonë u japim punonjësve tanë shansin për ndryshim. 61 punonjës më shumë ishin në gjendje të marrin sfida të reja në lokacione të ndryshme.

TEB Sh.A. jep mundësi për punësim dhe gjatë punësimit ofron mundësi të barabarta për zhvillimin dhe planet e ardhshme të karrierës së tyre.

Informatat për pozitat e lira publikohen përveç jashtë, gjithmonë edhe brenda organizatës, me qëllim që punonjësit tanë të informohen së pari për mundësitë që i kanë për të aplikuar për pozita të reja ose lokacione të reja ku është pozita e lirë dhe si mundësi për ta që të mësojnë rreth mundësive të karrierës dhe të tregojnë interes.

Gjatë vitit 2018 u lansuan programe të ndryshme të praktikës, ku ne u përpoqëm të gjejmë studentët më të mirë në treg dhe t'u japim atyre një mundësi për të bërë praktikë në bankën tonë. Janë organizuar programe trajnimi për praktikë me qëllim të ofrimit të njohurive studentëve lidhur me bankën në praktikë dhe gjatë trajnimit në vendin e punës pasurimin e njohurive të tyre lidhur me produktet, shërbimet dhe proceset bankare. Pas periudhës së trajnimit, praktikantëve u janë dhënë detyra dhe janë angazhuar në detyrat e përditshme, duke u informuar se nëse ata tregojnë performancë të mirë ata kanë mundësi të konsiderohen për pozitat e lira të ardhshme. Këto programe ishin shumë të dobishme edhe për bankën, pasi vazhdimisht kemi pasur kandidatë potencialë në grupin tonë të rekrutimit si dhe informata për angazhimin e tyre në praktikë si informata shumë të vlefshme që duhet të merren parasysh.

Synimi i bankës është t'u japë mundësi punonjësve më të mirë për t'u konsideruar për pozita menaxheriale. Për shkak të kësaj,

gjatë katër viteve të fundit në vazhdimësi kemi organizuar Programin e Qendrës së Vlerësimit përmes së cilës kemi krijuar grupin e menaxherëve potencialë që duhet të merren parasysh për nevojat e ardhshme të bankës. Gjithsej 79 punonjës kanë marrë pjesë në këtë program gjatë katër viteve të fundit, ndër të cilët 23 janë avancuar në pozita menaxheriale; 15 janë caktuar Menaxherë të Degëve ndërsa 9 Menaxherë në Zyrën Qendrore. Programi ka vazhduar me dy Module të Programeve të Zhvillimit për të gjithë pjesëmarrësit e Programit të Qendrës së Vlerësimit. Programet e Qendrës së Vlerësimit/ Zhvillimit ishin programe shumë të vlerësuara nga punonjësit që morën pjesë në to, madje edhe e ndryshuan për të mirë mënyrën e tyre të menduarit dhe të kuptuarit të çështjeve të menaxhimit, rritën motivimin dhe vetëbesimin e tyre duke ditur se do të jenë potencial për pozita të ardhshme menaxheriale që do të hapen. Po ashtu, ata janë vënë në dijeni se banka e vlerëson performancën e tyre duke besuar se ata kanë potencial të ofrojnë edhe më shumë për bankën.

Gjatë vitit 2018, janë organizuar programe të vazhdueshme të trajnimit, të brendshme dhe të jashtme; të mbajtura nga menaxhmenti dhe nga kompani të mirënjohura të trajnimit. Kanë qenë 107 trajnime me 9,100 ditë pjesëmarrjeje në trajnim gjatë vitit 2018. 41% e këtyre trajnimeve u zhvilluan brenda organizatës me trajnerë të brendshëm ndërsa 59% u zhvilluan me trajnerë të jashtëm. 12 punonjës kanë qenë jashtë vendit për t'u trajnuar në trajnime të jashtme dhe 38 kandidatë janë trajnuar në trajnime vendore jashtë bankës. Për më tepër, personeli ynë vazhdimisht ka vizituar TEB A.Ş. në Turqi për shkëmbimin e përvojave.

Vëmendje e veçantë i është dhënë trajnimit të

detyrueshëm të Pajtueshmërisë dhe të gjithë punonjësit aktivë janë trajnuar të paktën një herë mbi këtë temë në klasë. Sipas kërkesave të grupit, të gjitha trajnimet dhe kuizet e mësimit përmes internetit (e-learning) në platformën My Development (Zhvillimi Im) të BNP PARIBAS janë caktuar dhe përcjellur nga Burimet Njerëzore për të siguruar se janë kryer në afatin e caktuar. Programet e praktikës janë lansuar gjatë gjithë vitit për praktikantë të ndryshëm të TI dhe bankimit.

Ngjashëm me këtë, gjatë vitit 2018 është përdorur platforma e brendshme 'e-campus' për trajnime të nevojshme të planifikuara për punonjësit për ngritje të vetëdijes lidhur me standardet, ndryshimet dhe kërkesat e institucionit në tema të ndryshme për: trajnime të Vetëdijesimit për Sigurinë e Informacionit dhe Procesin e Trajtimit të Ankesave të Klientëve.

## Përfitimet e punonjësve

Përveç pagave konkurruese për tregun, punonjësve tanë u ofrohen mundësi të ndryshme për përfitime shtesë bazuar në arritjet e tyre. Janë të zbatueshme skemat e shitjeve premium, si skemë stimuluese për më të mirët që të shpërblehen. Prej vitit 2018, shitjet premium filluan të aplikohen edhe për stafin e operacioneve të degës. Ngjashëm me këtë, gjatë gjithë vitit janë nisur fushata të veçanta dhe punonjësit kanë pasur mundësi për shpërblim monetar ose material për arritjen e objektivave të fushatës. Me zbatimin e këtyre skemave, ne e rrisim frymën konkurruese dhe i dallojmë përfitimet e punonjësve në bazë të meritës.

## Aktivitetet shoqërore

Ne kujdesemi për lumturinë dhe motivimin e punonjësve tanë. Përveç sinergjisë së punës, ne

kujdesemi që ata të kenë aktivitete sociale për t'i përmirësuar marrëdhëniet e tyre dhe për të menduar se si ta organizojnë mjedisin e punës për të qenë më miqësor. Gjatë vitit 2018 burimet njerëzore kanë organizuar këto aktivitete/ngjarje të reja:

- **Coffee time** (koha e kafesë) me ekzekutivët - çdo muaj një anëtar i ekzekutivit ka pirë kafën e mëngjesit me punonjës të përzgjedhur. Qëllimi i kësaj ishte që punonjësit të ndihen më pranë menaxhmentit dhe që menaxhmenti t'i dëgjojë shqetësimet e tyre. Anëtarët e ekzekutivit në ato takime treguan rrugën e karrierës së tyre dhe sfidat me të cilat janë përballur. Këto takime u konsideruan shumë të vlefshme për punonjësit, pasi ata e ndjenë rregullin e "dyerve të hapura" me menaxhmentin dhe mund të flisnin për ndonjë shqetësim të tyre duke e informuar menaxhmentin për ndonjë vështirësi të mundshme që ka rezultuar në gjetjen e një zgjidhjeje për shqetësimin e tyre.

- **Rotacioni i menaxherëve** - gjatë vitit 2018 burimet njerëzore organizuan që çdo muaj një numër i menaxherëve t'i vizitojë degët e ndryshme. Qëllimi i këtyre vizitave ishte që menaxherët që zakonisht kanë punë në zyrë t'i vizitojnë degët dhe ta kalojnë një ditë me personelin e degës, për të kuptuar punën e tyre të përditshme, shqetësimet dhe sfidat e tyre, duke iu ofruar edhe mbështetje nga fusha e tyre e ekspertizës.

- **Festa e Halloween-it (nata e shtrigave)** - e organizuar për fëmijët e punonjësve tanë. Kjo ngjarje ishte një nga ngjarjet më të gëzueshme të organizuara dhe më së shumti e vlerësuar nga stafi ynë për shkak se i ka bërë fëmijët e tyre të lumtur. Kjo ngjarje u mbajt në një vend me shesh lojërash, dhurata dhe maskota, ku fëmijët u argëtuan përdërisa luanin me njëri tjetrin dhe

punonjësit ishin të kënaqur përderisa i shihnin fëmijët e tyre të lumtur.

• **Happy Fridays** (të premtet e gëzuara) – me synimin e shoqërimit të punonjësve, 'Happy Hour' (ora e gëzuar) është mbajtur në restorantin e bankës me muzikë. Ngjarje të tilla do të mbahen kohë pas kohe.

• **TEB Talks; (bisedat TEB)** ishin ngjarje të reja të mbajtura gjatë vitit 2018. Disa persona të rëndësishëm u ftuan të ndajnë përvojat e tyre me punonjësit tanë: diskutimi për kafenë, menaxhimi i stresit dhe një lojtar i njohur i futbollit ishin (ishite) ftuar.

• Banka në vitin 2018 shpalli programin **"Punonjësi i Muajit"**. Qëllimi i Programit të Punonjësit të Muajit ishte të vlerësohen punonjësit që i kanë shërbyer TEB Sh.A. në mënyrë të shkëlqyeshme për të dhënë shembull të shërbimit të shkëlqyeshëm nëpërmjet punës së tij/ saj dhe për të treguar qëndrim pozitiv dhe përkrahës. Propozimet për kandidatët diskutohen dhe analizohen në Komitetin e Mirëqenies së Punonjësve, ku merret vendimi për fituesin. Punonjësit e zgjedhur si punonjës të muajit janë njoftuar në 'TEB All Users' (Të gjithë Përdoruesit TEB, ku për nder të këtij rasti, punonjësit i është dhënë një certifikatë dhe dhuratë simbolike.

Gjatë gjithë vitit 2018 janë organizuar aktivitete të tjera si:

- Festa të ndryshme:
- Festë në natyrë
- Festë me skarë ('Barbeque')
- Udhëtim/organizim në vende të ndryshme
- Ecje - shëtitje rekreative
- Turneu i futbollit i mbajtur në Prishtinë, ku ekipi

i parë dhe fitues ishte dërguar në Turqi për të marrë pjesë në turneun e organizuar nga TEB A.Ş. dhe ata zënë vendin e parë dhe fituan një udhëtim në Itali. Ekipi ynë fitues na bëri krenarë me një çmim fitues të turneut të futbollit 2018.

### Çfarë ka më tutje?

Ekipi i Burimeve Njerëzore do të vazhdojë gjatë vitit 2019 të:

- Japë mbështetjen e plotë punonjësve dhe menaxhmentit për rekrutimin dhe mbajtjen e punonjësve më të mirë. Do të fokusohet në zhvillimin e aftësive dhe njohurive të punonjësve si dhe t'u ofrojë atyre rrugë të reja të karrierës dhe mundësi për lëvizje të brendshme.
- Organizojë dhe ndjekë vazhdimisht trajnime të brendshme dhe 'online', për t'u siguruar se zhvillimi i punonjësve tanë është në përputhje me kërkesat dhe standardet e grupit.
- Organizojë programe të ndryshme praktike për ta krijuar një grup potencial kandidatësh për rekrutim nëpërmjet bashkëpunimit të ngushtë me Universitetet përkatëse, për të synuar dhe angazhuar studentët më të mirë të cilët janë në përfundim të studimeve dhe kandidatë të mundshëm për program, me mundësi që të punësohen në TEB.
- Vazhdojë organizimin e aktiviteteve/ngjarjeve për punonjësit për të kontribuar në motivimin e tyre.

## 4.9. Teknologjia e Informacionit

Formësimi i vizioneve tona në teknologji ka qenë gjithmonë sfidë, sidomos për t'u përshtatur me sjelljen unike njerëzore për ta formësuar cilësinë e rrugës së klientit dhe efektivitetin e zgjidhjeve

teknologjike. Si departament i TI-së linja jonë ishte të fillohet ndryshimi përmes thjeshtësisë, që është gjithmonë mënyrë e mirë për t'i udhëzuar klientët.

TI është një sektor në rritje të shpejtë, i ndryshueshëm në biznesin bankar që punojnë shumë për t'u përballur me klientët, për të parë përmes syve të tyre; dhe fuqia jonë është t'iu japim përparësi perspektivës së klientit, duke ndryshuar gjërat ashtu siç ata duan t'i interpretojnë ato.

Gjatë ofrimit të shërbimeve dhe produkteve për klientin tonë, siguria e klientit tonë ka qenë një nga temat më të rëndësishme për ne. Vëllimi dhe llojet e sulmeve kibernetike po rriten në sektor dita ditës, TEB Sh.A. po punon shumë për të zbatuar teknologjitë më të fundit të sigurisë për t'i mbajtur sistemet e saj të informacionit të sigurta dhe nën kontroll. Për këtë qëllim, ne rregullisht kemi adaptuar sistemet dhe infrastrukturën tonë të TI-së ndaj kërcënimeve më të fundit të sigurisë në 2018 duke zbatuar teknologji dhe funksione të reja për të ulur rreziqet e sigurisë.

## Arritjet

Në vitin 2018, ne kemi pasur shumë sfida në fusha të ndryshme biznesi. Ne vazhduam me digjitalizimin në shumë shërbime si në shërbimet e brendshme ashtu edhe në ato me klientët. Si një nga avancimet në MMK (Menaxhimin e Marrëdhënieve me Klientë), është përdorimi i aplikacionit për produktet e kredisë përmes kanalit ATM, ku klientët përmes së ofertës së përshtatur nga Banka, mund të fillojnë aplikimin për kredi duke mos vizituar fizikisht degët tona. Një nga rezultatet më produktive në vitin 2018 është integrimi me klientët tanë të biznesit. Me shumë kompani ne kemi zbatuar zgjidhje për të ndarë të dhënat e transaksioneve të kompanive

në mënyrë elektronike. Kjo i ndihmon klientëve tanë të rrisin digjitalizimin në proceset e tyre dhe fokusin në aktivitetet e tyre kryesore. Përveç kësaj, për të përmbushur kërkesat e klientëve tanë korporativ ne kemi zbatuar llojet e reja të mesazhit (MT940 ... etj.) në sistemin ndërkombëtar të transferit të parave. Sa i përket e-banking për biznese; ne kemi eliminuar disa pengesa në disa funksione dhe e bëmë më të lehtë për klientët tanë të biznesit menaxhimin e dosjeve të pagave, transferet masive të parave dhe disa shërbime të tjera.

Viti 2018 ishte një vit i rëndësishëm edhe për segmentin për klientë individual dhe biznesin e kartelave. Zbatimi i mjetit për vlerësimin automatik të kredisë dhe vendimmarrja shkurtuan dukshëm kohën e përpunimit. Herën e parë në këtë vit, ne filluam të ofrojmë platformën e 'e-commerce' (tregtisë përmes internetit) për klientët tanë. Tashmë disa tregtarë janë integruar me produktin tonë të 'e-commerce' dhe numri i tregtarëve me siguri do të rritet më shumë në vitet e ardhshme.

Për TEB Sh.A., bankimi mobil dhe përmes internetit janë kanale mjaft kritike. Ne e dimë që klientët tanë gëzojnë shërbimet bankare me shumë avantazhe që ofron TebMobile. Për këtë arsye, ne vazhdojmë të përmirësojmë dhe zgjerojmë shërbimet në TebMobile. Në vitin 2018, ne shtuam pagesat e kolektorit ('collector payments') në shërbimet tona në tel. mobil dhe zgjodhëm katalogun e shërbimeve të 'e-banking' duke shtuar opsionin e transferit ndërkombëtar të parave.

## Shërbimet bankare të sigurta dhe infrastruktura e fuqishme

Ne vazhdimisht dhe për së afërmi monitorojnë të gjitha dobësitë e sigurisë si brenda ashtu edhe jashtë vendit, duke marrë masa për ta mbrojtur bankën dhe klientët tanë në përputhje me rrethanat. Kemi përfunduar një numër të përmirësimeve në sistemet tona të prodhimit për të siguruar një infrastrukturë më stabile dhe më përgjegjëse. Në vitin 2018, ne me sukses kemi zhvendosur Qendrën tonë të Dhënave në lokacionin tonë të ri dhe koha jo-produktive në shërbimet tona është mbajtur në nivelin minimal. Me këtë zhvendosje, ne po ashtu kemi ripërtërirë pajisjet kryesore në qendrën tonë të të dhënave me teknologjitë më të reja. Në të njëjtën kohë, ne kemi siguruar që qendra mbështetëse e të dhënave tona të ketë kapacitet dhe aftësi të mjaftueshme për të kryer shërbimet kritike të Bankës.

### Çfarë ka më tutje?

TEB Sh.A. gjithmonë i mban nevojat e klientit në fokus përderisa i vlerëson investimet në teknologji. Qëllimi ynë është të ofrojmë shërbimet më të mira dhe kanalet alternative më të mira për klientët tanë. Prandaj ne do të fokusohemi në sjelljen e shërbimeve të reja inovative të cilat do ta rrisin vlerën për klientët tanë.

Si departament i TI-së në bankë, ne i vëzhgojmë tendencat e reja në botë dhe zgjedhim zgjidhjet më të mira të mundshme që t'ua prezantojmë klientëve dhe tregut tonë. Me digjitalizim, ne i transformojmë shërbimet tona dhe prezantojmë kanale të reja, si dhe përmirësojmë proceset e brendshme në Bankë. Digjitalizimi është më tepër për eliminimin e hapave të procesit dhe funksioneve që nuk japin vlerë as për klientët, as për punonjësit e Bankës. Prandaj, në vitin 2019 ne do të vazhdojmë të rrisim efikasitetin dhe cilësinë në shërbimet tona bankare për klientët tanë dhe në proceset tona të brendshme.

Në përputhje me këtë strategji të filluar në vitin 2018, në vitin 2019 ne do të prezantojmë zgjidhje të bankimit mobil për klientët tanë të biznesit. Me këtë zhvillim, klientët e biznesit do të jenë në gjendje të realizojnë transaksionet e tyre në tel. mobil, të monitorojnë llogaritë dhe produktet me një qasje shumë të shpejtë në çdo kohë dhe të përdorin shumë tipare të tjera. Ne do të vazhdojmë të zgjerojmë integrimin me institucionet lokale dhe klientët tanë të korporatave. Në vitin 2019, ne do të rrisim automatizimin në aktivitetet e MMK (Menaxhimi i Marrëdhënieve me Klientë) duke vendosur më shumë tipare dhe funksione në mjetet tona.

## 4.10. Siguria e informacionit dhe mbrojtja e të dhënave

### - Siguria e informacionit

Banka mori pjesë në programin e sigurisë kibernetike të grupit që është i bazuar në NIST ('National Institute of Standards and Technology'/ Instituti Kombëtar për Standarde dhe Teknologji) në fund të vitit 2018 me ambicien për të përfunduar aftësitë BNPP-së ndaj rreziqeve kundër krimeve kibernetike deri më 2020. Me këtë master program, Banka synon të arrijë nivelin e sigurisë minimale para vitit 2020 në 28 tema të sigurisë. Një model është krijuar bazuar në referimin NIST që mbulon të gjitha temat e sigurisë kibernetike dhe është adaptuar në politikat dhe strategjitë e sigurisë kibernetike të grupit dhe të TEB. Për të rritur vetëdijesimin lidhur me sigurinë e informacionit dhe kulturën kibernetike, të gjithë punonjësit kanë përfunduar trajnimet 'e-learning' (mësimi përmes internetit) dhe trajnimet 'on-site' (në bankë). Këto trajnime janë mbështetur me teste, njoftime mujore me e-mail si dhe fushata 'phishing' (praktika mashtruese për marrjen e informatave të ndjeshme).

## - Mbrojtja e të dhënave


Këtë vit, Banka ka publikuar njoftimin për privatësinë e të dhënave personale në faqen e saj kryesore të internetit. Me këtë njoftim, Banka u ofron klientëve të saj ekzistues, të kaluar dhe të ardhshëm informata të detajuara lidhur me mbrojtjen e të dhënave personale të mbledhura duke siguruar informata për përdorimin e tyre, kohëzgjatjen e mbajtjes së tyre, të drejtat e klientit, ushtrimin e këtyre të drejtave etj. Banka vepron gjithmonë në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme në procesimin e të dhënave personale dhe respektimin e privatësisë dhe të drejtave të tyre. Banka merr masat e duhura teknike dhe organizative kundër procesimit të paautorizuar ose të paligjshëm të të dhënave personale dhe kundër humbjes, shkatërrimit ose dëmtimit aksidental të të dhënave personale. Po ashtu tregon të njëjtin kujdes të duhur gjatë bartjes së të dhënave personale në një vend apo territor jashtë Zonës Ekonomike Evropiane.

Njësia e Mbrojtjes së të Dhënave vepron në pajtim me ligjin dhe rregulloren vendore si dhe RrMDhP (Rregullorja për Mbrojtjen e të Dhënave të Përgjithshme) për t'iu përgjigjur çdo ankese dhe/ose kërkesë të pronarit të të dhënave në mënyrë të saktë dhe me kohë.

Prandaj, ajo është vazhdimisht në kontakt dhe në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare për Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Njësia e Mbrojtjes së të Dhënave synon ta rrisë rëndësinë dhe vetëdijen për të dhënat personale. Me këtë perspektivë të përcaktuar, ajo kryen vizita ad-hoc të kontrollit në degët e Bankës dhe çdo vit organizon programin e trajnimit të detyrueshëm për të gjithë punonjësit si dhe punonjësit e ri.

# **Menaxhimi dhe Struktura organizative**

# TEB Sh.A. Struktura Organizative



\*Raporton në Komitetin e Auditimit të Bordit të Drejtorëve

\*\*Raporton në Komitetin e Menaxhimit të Rrezikut të Bordit të Drejtorëve



## 5.2. Bordi i Drejtorëve

Esra Peri Aydoğan  
Anëtar

### **Bordi i Drejtorëve i TEB Sh. A.**

Osman Durmuş  
Anëtar

Jacques Roger Jean Marie Rinino  
Kryesuesi

Sabri Davaz  
Anëtar

Dr. Ismail Yanık  
Zëvendës Kryesuesi

Dr. Nilsen Altintas (\*)  
Anëtar

Alp Yılmaz  
Zëvendës Kryesuesi

Orçun Özdemir  
Drejtor Menaxhues dhe Anëtar

Ayşe Aşardağ  
Anëtar

(\*)Tuğbay Kumoğlu dha dorëheqje me datë efektive 26 prill 2018 dhe Dr. Nilsen Altıntaş është emëruar për të plotësuar vendin e lirë të anëtarit më datë efektive 27 prill 2018.

Birol Deper  
Anëtar

## Qeverisja

TEB Sh.A. (Banka /TEB) ka një Bord të Drejtorëve që aktualisht përbëhet nga dhjetë anëtarë me përvojë të gjerë bankare. Bordi kryen detyrat dhe përgjegjësitë e tij sipas kërkesave të përcaktuara në statutin e Bankës, aktet nën-ligjore të Bordit të Drejtorëve dhe në pajtim me gjithë legjislacionin dhe kërkesat përkatëse të vendosura nga Banka Qendrore e Kosovës (BQK) dhe rregullatorët. Bordi takohet të paktën çdo tre muaj.

### **Roli i Bordit të Drejtorëve**

Edhe pse detajet janë përcaktuar në Nenet 26, 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 04 / L-093 për Bankat, Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jo-Bankare, detyra kryesore e Bordit është të mbikëqyrë aktivitetet financiare dhe të biznesit të Bankës. Ai është përgjegjës për përcaktimin e strukturës organizative dhe administrative të Bankës, politikën e saj të biznesit duke përfshirë njësitë operative dhe administrative, nën-njësitë dhe funksionet e tyre, pozicionet mbikëqyrëse dhe marrëdhëniet raportuese. Për më tepër, Bordi është i ngarkuar me mbikëqyrjen e aktiviteteve të menaxhmentit të lartë. Bordi i Drejtorëve përcakton dhe vendos strukturën bankare dhe nivelet e ekspozimit të Bankës, shqyrton dhe miraton korigjimet dhe masat e nevojshme. Për më tepër, Bordi është përgjegjës për

miratimin e raportit të menaxhmentit të lartë mbi veprimtaritë e biznesit bazuar në bilancin gjysmë-vjetor, pasqyrën e fitimit dhe humbjes, bilancin vjetor dhe raportet e auditimit të brendshëm dhe të jashtëm. Vendimet e marra nga Bordi kërkojnë një shumicë votash nga anëtarët që janë të pranishëm apo që votojnë me prokurë.

## 5.3. Komitetet

### Komitetet e Bordit të TEB Sh.A.

Në përputhje me Statutin e TEB Sh.A., rregulloret dhe kërkesat e Bankës, Bordi ynë ka caktuar Komitetin e auditimit, Komitetin e menaxhimit të rrezikut, Komitetin e pasurive dhe detyrimeve, Komitetin e lartë të kredive, ku të gjitha këto përbëhen nga anëtarët e Bordit me përvojë përkatëse dhe ekspertë të jashtëm. Bordi gjithashtu mund të krijojë komitete të menjëhershme (ad hoc) dhe të përcaktojë përbërjen dhe detyrat e tyre, nëse është relevante dhe e përshtatshme. Sipas nenit 22 të Statutit të TEB Sh.A. të datës 24 qershor 2013, komitetet mund të zgjidhen nga radhët e aksionarëve, drejtorëve dhe punonjësve të Bankës, si dhe nga radhët e personave të tjerë jashtë bankës, duke iu nënshtruar kufizimeve në Statut. Komitetet nuk duhet të marrin vendime në vend të Bordit të Drejtorëve ose aksionarëve, por do të veprojnë si këshilltarë të tyre.

### **Komiteti i auditimit**

Sabri Davaz

Kryesues

Ayşe Aşardağ

Anëtar

Birol Deper

Anëtar

Esra Peri Aydoğan

Anëtar

## Detyrat dhe përgjegjësitë:

Komiteti i auditimit ka detyrat dhe përgjegjësitë e qarta që janë të përcaktuara në aktet nën-ligjore të komiteteve të auditimit dhe janë në përputhje me legjislacionin dhe rregulloret relevante. Detyrat dhe përgjegjësitë e tij janë:

- Rekomandimi i kontrolleve adekuate të brendshme të kontabilitetit, operacionale dhe administrative;
- Mbikëqyrja e pajtueshmërisë së Bankës me politikat dhe procedurat;
- Kërkimi dhe rishikimi i raporteve nga udhëheqësi i departamentit të auditimit të brendshëm të Bankës;
- Rekomandimi i kompensimit për udhëheqësin e departamentit të auditimit të brendshëm;
- Monitorimi i pajtueshmërisë me legjislacionin bankar përkatës dhe rregulloret ose kërkesat e aplikueshme;
- Rekomandimi për emërimin e një auditori të jashtëm;
- Monitorimi i performancës së auditorit të jashtëm, rishikimi i raportit të auditorit të jashtëm për pasqyrat financiare të Bankës dhe raportimi i të gjitha gjetjeve tek Bordi i Drejtorëve;
- Dhënia e mendimeve tek Bordi i Drejtorëve lidhur me çdo çështje që kërkohet nga Bordi i Drejtorëve, ose që komiteti dëshiron ta adresojë; dhe
- Miratimi i planit të auditimit të jashtëm dhe të brendshëm të TEB Sh.A.

Komiteti i auditimit takohet të paktën çdo tre muaj.

## Komiteti i lartë për kredi (CRECOM)

Osman Durmuş  
Kryesues

Haluk Kircalı  
Zëvendës Kryesues

Alp Yılmaz  
Anëtar

Alp Özateşler  
Anëtar

## Detyrat dhe përgjegjësitë:

Ky komitet është i autorizuar të marrë vendime për kredi për shumat në mes €500,000 dhe €3.5 milion.

### Komiteti i menaxhimit të aseteve dhe detyrimeve (KAD)

Dr Ismail Yanik

Kryesues

Orçun Özdemir

Zëvendës Kryesues

Alp Yilmaz

Anëtar

Serhan Ozarslan

Anëtar

Tolga Gürdem

Anëtar

## Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Monitorimi i tregjeve financiare, kontrollimi i situatës, lëvizjet dhe ndryshimet në bilancin e gjendjes së bankës dhe marrja e vendimeve, të gjitha këto në përputhje me Politikën dhe Procedurat e Bankës;
- Udhëzimi dhe monitorimi i veprimeve të Departamentit të Thesarit dhe MPD-së në mënyrë të vazhdueshme dhe duke vepruar si organ vendim-marrës, siç përcaktohet në aktet nën-ligjore të komitetit për MPD;
- Mbikëqyrja e menaxhimit të aseteve dhe detyrimeve nga ana e Departamentit të Thesarit dhe MPD-\ së lidhur me kriteret në vijim:
- Sigurimi i respektimit të normave të jashtme (rregullative) të përcaktuara nga Banka Qendrore e Kosovës (BQK) dhe rregullave të brendshme të përcaktuara nga Bordi ose KAD-i;
- Monitorimi i rezervave të domosdoshme minimale të përcaktuara nga BQK-ja.

Komiteti për asete dhe detyrime takohet së paku çdo tre muaj.

## Komiteti i menaxhimit të rrezikut (KMR)

Osman Durmus

Kryesues

Alp Yilmaz

Zëvendës Kryesues

Jacques Roger Jean Marie Rinino

Anëtar

## Detyrat dhe përgjegjësitë:

Objektivi i Komitetit për Menaxhimin e Rrezikut (KMR) është të mbikëqyrë profilin e rrezikut, të miratojë dhe monitorojë kornizën e menaxhimit të rrezikut të Bankës në kontekst të strategjisë së shpërblimit të rrezikut të përcaktuar nga Bordi i Drejtorëve. Si i tillë, KMR është përgjegjës për monitorimin e të gjithë komponentëve lidhur me rrezikun dhe funksionet që kanë të bëjnë me kreditë, tregun, likuiditetin, çështjet operationale, të reputacionit, mjaftueshmërinë e kapitalit të Bankës si dhe rreziqet tjera.

Komiteti për menaxhimin e rrezikut takohet së paku në baza mujore.

## 5.4. Auditimi i brendshëm

### Auditimi i brendshëm

Bordi i Drejtorëve të TEB Sh.A. ka themeluar Departamentin e auditimit të brendshëm në shkurt të vitit 2013 si një nga komponentët kryesorë në strukturën drejtuese të Bankës. Para kësaj date, Banka kishte kontraktuar funksionin e saj të auditimit të brendshëm te Turk Ekonomi Bankasi (TEB) A.Ş., në bazë të Marrëveshjes së Nivelit të Shërbimit ('Service Level Agreement' -SLA) të nënshkruar në vitin 2008. Banka vazhdon të marrë përkrahje për auditim nga TEB A.Ş. përmes këshillave të auditimit për Departamentin e auditimit të brendshëm. Për më tepër, TEB A.Ş. kryen auditime specifike për aktivitetet e caktuara, bazuar në planet e para-përgatitura të auditimit. Departamenti i auditimit të brendshëm të Bankës është i pavarur dhe si i tillë i raporton direkt Bordit të Drejtorëve përmes Komitetit të auditimit dhe me iniciativën e vet, nëse e sheh të nevojshme ose të përshtatshme.

Departamenti i auditimit të brendshëm ka funksion të sigurisë, duke i ndihmuar Bankës për t'i përmbushur objektivat e saj, duke sjellë një qasje sistematike dhe të disiplinuar ndaj vlerësimit dhe përmirësimit të efektivitetit të mjedisit të kontrollit, përfshirë proceset e menaxhimit të rrezikut, kontrollit dhe qeverisjes. Është përgjegjësi e Auditimit të brendshëm që të vlerësojë nëse mjedisi i kontrollit siguron se rreziqet që mund të rrjedhin nga aktivitetet e Bankës menaxhohen në mënyrën e

cila mundëson një nivel të pranueshëm të uljes së rrezikut. Aktivitetet e auditimit kryhen nga departamenti i auditimit të brendshëm sipas planit të auditimit, i cili përgatitet të paktën një herë në vit duke përdorur një qasje të bazuar në rrezik në përputhje me qëllimet dhe objektivat e Bankës. Secili plan i auditimit miratohet nga Komiteti i auditimit i Bankës. Plani përditësohet rregullisht për të pasqyruar ndryshimet në sistemin e kontrollit të brendshëm dhe për të integruar linja të reja të biznesit. Në të njëjtën mënyrë, auditori i brendshëm përgjegjës zhvillon dhe regjistron një plan të fokusuar në rrezik për çdo detyrë të auditimit që analizon pikat e brendshme të rrezikut dhe përfshin objektivat, fushëveprimin, kohën dhe ndarjen e burimeve.

Puna e Departamentit të auditimit të brendshëm kryhet në përputhje me Standardet Ndërkombëtare për Praktikën Profesionale të Auditimit të Brendshëm të hartuar nga Instituti i Auditorëve të Brendshëm, i cili është organ drejtues i profesionit të auditimit të brendshëm në gjithë botën, si dhe praktikën e auditimit të TEB A.Ş.

## 5.5. Menaxhimi i rrezikut

TEB Sh.A. ka një qasje gjithëpërfshirëse dhe të kujdesshme për sa i përket rrezikut, si dhe identifikimit dhe monitorimit të vazhdueshëm të tij. TEB Sh. A. e monitoron dhe vlerëson rrezikun e kredive, tregut, likuiditetit, dhe atë operacional si dhe rreziqet tjera të ndërlidhura të bankës duke përdorur metodat që janë në përputhje me standardet e grupit dhe ato ndërkombëtare. Roli i Departamentit të Menaxhimit të Rrezikut është kontrolli i nivelit të dytë dhe është i organizuar në kuadër të metodologjive të menaxhimit të rrezikut të Grupit. Procesi është i përbërë nga identifikimi i rrezikut, analiza, pranimi ose zbutja e rrezikut dhe monitorimi i rrezikut përmes krijimit të politikave dhe procedurave të arsyeshme që janë praktike dhe të kuptueshme në të gjitha nivelet e bankës. Menaxhmenti i Rrezikut i Grupit (MRG) mbikëqyr procesin e përgjithshëm të menaxhimit

të rrezikut në kuadër të grupit. Departamenti i menaxhimit të rrezikut i TEB Sh. A. punon në bashkëpunim me menaxhmentin ekzekutiv për të siguruar që niveli i rrezikut i ndërmarrë nga TEB Sh. A. është në përputhje me politikat e grupit dhe gatishmërinë e bankës për ta pranuar rrezikun.

Me këtë strukturë, Departamenti i Menaxhimit të Rrezikut ruan pavarësinë e vet në funksionet e tij të përditshme pasi ai i raporton drejtpërdrejt Bordit të Drejtorëve nëpërmjet Komitetit të Menaxhimit të Rrezikut (KMR) për të cilin jepen direktivat për uljen e rreziqeve.

### Rreziku i kredive

Rreziku i kredive është rreziku më i zakonshëm që i ekspozohet banka duke marrë parysh strukturën vendore të tregut dhe kushtet e përgjithshme. Si përkufizim i përgjithshëm, rreziku i kredive është humbja që mund të ndodhë nëse pala tjetër në marrëdhënie të kredisë dështon, pjesërisht ose tërësisht, për t'i përmbushur detyrimet e saj siç është përcaktuar në marrëveshjen e kredisë. TEB banka është e ekspozuar ndaj rrezikut të kredisë nëpërmjet kreditimit të saj, financave tregtare dhe aktiviteteve të thesarit, megjithatë rreziku i kredive mund të lindë edhe në rrethana të tjera. Menaxhimi i rrezikut të kredisë kryhet nëpërmjet analizës së rregullt të aftësisë së pagesës së kredisë së debitorëve ndërsa të gjitha ekspozimet e kredive shqyrtohen të paktën në baza vjetore, ndërsa ekspozimet e mëdha monitorohen në baza të rregullta nga departamenti i monitorimit. Procesi i monitorimit e konsideron, por nuk kufizohet në performancën e rrjedhjes së parave të gatshme dhe të shitjeve, marrëveshjet e kredisë, sjelljet e pagesave, rentabilitetin, likuiditetin, aftësinë paguese dhe normën e borxhit.

Bordi i Drejtorëve përmes autoritetit të vet të delegimit të fuqive për kredi ka autoritetin përfundimtar në ndarjen e kredive dhe miratimin e politikave kreditore. Kjo fuqi i delegohet Komitetit të lartë të kredive dhe drejtorit ekzekutiv në kushte dhe me kufizime të caktuara. Ushtrimi i këtyre

fuqive të deleguara monitorohet dhe raportohet rregullisht nga kontrolli i brendshëm, menaxhimi i rrezikut dhe auditimi i brendshëm, si pjesë e vijës së dytë dhe të tretë të mbrojtjes. Në anën tjetër, Departamenti i Menaxhimit të Rrezikut në baza mujore raporton tek Komiteti i Menaxhimit të Rrezikut - niveli i Bordit të Drejtorëve, zhvillimi i kredisë në nivelin e portfolios, duke përfshirë përmbledhjen e IKR-ve, limiteve rregullative dhe të Bordit të Drejtorëve, delikuencën e kredive, ekspozimin sipas segmenteve dhe industrisë, trendin e KJP-ve, aktivitetet e arkëtimit etj.

Ekspozimi primari TEBSH.A. ndaj rrezikut të kredive lind nëpërmjet kredive të saj dhe paradhënieve për klientë. Nga ana tjetër, koncentrimet e rrezikut të kredisë mund të lindin kur palët me interes kanë tipare të ngjashme ekonomike dhe të rrezikut që do të ndikojnë në përmbushjen e detyrimeve kontraktuale të tyre që preken nga ndryshimet ekonomike ose të tjera. Si rezultat i politikës së matur të kredive të miratuar nga Banka, limiti maksimal i kredisë që mund t'i jepet një klienti ose një grupi të klientëve të ndërlidhur mbahet nën limitin ligjor, duke zvogëluar kështu rrezikun e koncentrimin të kredive dhe limitet e tilla që paraprakisht miratohen nga Bordi i Drejtorëve dhe monitorohen dhe raportohen çdo muaj në Komitetin e Menaxhimit të Rrezikut.

Si një qasje e përgjithshme, vlerësimi i propozimit për kredi fillon në nivelin e degës, ku zyrtari i portfolios së degës i viziton klientët në terren dhe merr pasqyrat financiare dhe informacionet që lidhen me aktivitetet e klientit dhe planet e investimeve të tij. Përgatitet propozimi për kredi që përmban komentin për pozitën financiare të kompanisë dhe informacione tjera cilësore si: analiza e industrisë, informacioni për partnerët dhe menaxherët, palët e tjera me interes si dhe referencat nga burimet tjera në dispozicion. Vlerësimi i nivelit të parë diskutohet në nivelin e degës ndërmjet portfolios dhe mbikëqyrësit të tij/saj dhe vetëm atëherë i dorëzohet Divizionit të Alokimit të Kredive në ZQ, i cili bën një vlerësim të pavarur të aftësisë kreditore të aplikuesit në bazë individuale dhe vendos për dosjen ose ia përcjell

dosjen e kredisë Komitetit të Lartë të Kredive për vendim varësisht nga kërkesa e limitit të kredisë e deleguar nga Bordi i Drejtorëve.

Pas miratimit dhe alokimit të një kredie, Departamenti i Monitorimit të Kredive në baza tre-mujore ose gjysmë-vjetore monitoron planin e investimeve të klientit, aftësinë e ripagimit, rrjedhën e parasë në llogari bankare, borxhe të tjera bankare, trendët e përgjithshme të shitjeve etj. Në anën tjetër, Njësia e Cilësisë së Kredive në kuadër të Alokimit të Kredive është përgjegjëse për të përcjellë nëse janë përmbushur kushtet e komitetit të kredive nga klienti dhe bën përcjelljen e afërt të këtyre kushteve. Me këtë qasje, kreditë problematike identifikohen në fazë të hershme dhe masat e nevojshme merren para se të jetë vonë.

Brenda bankës, banka zbaton po ashtu vlerësimin kreditor për personat e saj juridik që përmban informata kuantitative dhe kualitative. Nëse vlerësimi kreditor dhe/ose cilësia e kolateralit paraqesin ndonjë dyshim, atëherë klienti rishikohet dhe monitorohet për së afërmi.

Stres testet tremujore të kredive janë një komponent tjetër i rëndësishëm për të kuptuar ngjarjet ose ndryshimet e mundshme në treg që mund të ndikojnë në bilancin e gjendjes së Bankës duke simuluar variante të ndryshme të moskthimit të kredive në portfolion ekzistuese të bankës.

Sa i përket procesit të kontrollit të kredive, banka zbaton rregullisht PKM (Pikat Kryesore të Monitorimit) që është kërkesë e BNPP-së për kontrollin e kredive dhe në bazë të shqyrtimit të mostrave mujore dhe/ose tremujore krijohet rezultati global i vlerësimit dhe planet e veprimt përcautohen në rast se vlerësimi është i barabartë me ose mbi > 3.

Për më tepër, me zbatimin e SNRF 9, banka përveç 12 muajve të Humbjes së Pritshme nga Kreditë duhet gjithashtu ta llogarisë zhvlerësimin për asetet e saj financiare për Humbjen e Pritshme

nga Kreditë gjatë gjithë Jetës, si një metodë e re për t'i parashikuar humbjet e ardhshme.

## Rreziku i tregut

Rreziku i tregut përfshin humbjet e mundshme që një bankë mund t'i pësojë si pasojë e ekspozimit të llogarive të saj në bilanc të gjendjes dhe jashtë-bilancit të gjendjes ndaj rrezikut të normës së interesit, rrezikut të pozicionit të ekuitetit ose rrezikut të kursit të këmbimit që rezultojnë nga luhatjet në tregjet financiare. Menaxhimi i rrezikut të tregut në TEB Sh.A. është dizajnuar që t'i menaxhojë dhe kontrollojë ekspozimet ndaj rrezikut të tregut, në mënyrë që të optimizohen kthimet duke e ruajtur profilin konservativ të Bankës sa i përket rrezikut.

## Rreziku i normës së interesit

Si pjesë e rrezikut të tregut, rreziku i normës së interesit rrjedhë ngarreziku që asetidotë humbiste në vlerë për shkak të ndryshimit të normës së interesit. Mbrojtja ndaj paqëndrueshmërisë së normës së interesit është prioritet i lartë për TEB Sh.A.

Rreziku i normës së interesit përcaktohet duke matur shkallën e ndjeshmërisë së aseteve, detyrimeve dhe zërave jashtë bilancit, duke dhënë 100 pikë bazë +/- simulime të goditjeve në të Ardhurat Bankare Neto të cilat bëhen në baza mujore. Si masë parandaluese, banka përpqet ta përputh çdo maturitet të depozitës me një aset që ka maturitet të njëjtë. Për më tepër, NBK (Norma e Brendshme e kthimit) monitorohet nga afër përmes analizave të hendekut dhe të kohëzgjatjes. Efektet e mundshme negative të luhatjes së normës së interesit në pozicionin financiar dhe rrjedhën e parave minimizohen me anë të vendimeve të shpejta. Në përcaktimin e strategjive afat-shkurtra, afat-mesme dhe afat-gjata të çmimeve, Komiteti i aseteve dhe detyrimeve të TEB Sh.A. menaxhon maturimin e pozicioneve në bilancin e gjendjes dhe përdor parimin e punës me marzhë pozitive të bilancit të gjendjes si politikë të saj të çmimeve.

## Rreziku i këmbimit valutor

Rreziku i këmbimit valutor përcaktohet si një humbje e mundshme që një bankë mund të pësojë me të gjitha mjetet dhe detyrimet e saj në valuta të tjera në rast të ndryshimeve në kurset e këmbimit.

Kufijtë e pozitive të përcaktuara nga Bordi i Drejtorëve monitorohen në baza ditore dhe po ashtu ngjashëm ekzaminohen ndryshimet e mundshme në pozitat monetare të Bankës që mund të ndodhin si rezultat i transaksioneve rutinore në valuta të huaja.

## Rreziku i likuiditetit

Rreziku i likuiditetit ndodh kur nuk ka para të mjaftueshme ose rrjedhë të mjaftueshme të parasë për t'i përmbushur kërkesat neto të financimit në kohën e duhur. Rreziku i likuiditetit mund të ndodhë edhe kur pozicionet e hapura nuk mund të mbyllen shpejt me çmime të përshtatshme.

Politika e Bankës është ta ketë një strukturë të aseteve që është mjaft likuide për t'i përmbushur të gjitha llojet e detyrimeve kur ato duhen paguar. Bordi i Drejtorëve rregullisht monitoron dhe përcakton normat e likuiditetit dhe standardet përkatëse për ruajtjen e likuiditetit të lartë gjatë gjithë kohës. TEB Sh.A. ka një sistem efikas sa i përket raportimit me kohë të pozicionit të likuiditetit të Bordi i Drejtorëve, të menaxhmenti i lartë dhe të gjitha njësitë përkatëse. Për më tepër, stres testet e likuiditetit janë një vegël tjetër e rëndësishme për ta matur likuiditetin e bankës për supozime të ndryshme biznesore. Për më tepër, si pjesë e direktivës së Basel III, banka në baza mujore llogarit koeficientin e mbulueshmërisë së likuiditetit ('Liquidity Coverage Ratio' - LCR), duke siguruar që banka ka likuiditet të mjaftueshëm afat-shkurtër dhe është duke e mbajtur koeficientin LCR > 100%.



## Mjaftueshmëria e kapitalit

Qëllimi i bankës është që të sigurohet se ka kapital të mjaftueshëm për t'i mbuluar rreziqet e përfshira në aktivitetet e saj biznesore të kredihënies. Departamenti për menaxhimin e rrezikut i monitoron dhe raporton normat e mjaftueshmërisë së kapitalit të Menaxhmenti Ekzekutiv dhe Bordi i Drejtorëve përmes Komitetit të menaxhimit të rrezikut. Sipas Ligjit për veprimtarinë bankare dhe rregulloret e Bankës Qendrore të Kosovës, ekzistojnë tri raporte të mjaftueshmërisë së kapitalit që duhet të përmbushen gjatë gjithë kohës: Kapitali i klasit të parë në raport me APRr (Asetet e Peshuara ndaj Rrezikut) 8%, kapitali total në raport me APRr 12% dhe ekuiteti total në raport me asetet totale 7%.

## Rreziku operacional dhe vazhdimësia e biznesit

Rreziku operacional përkufizohet si rrezik i humbjes që mund të rezultojë nga proceset e brendshme jo adekuate ose të dështuara, njerëz ose sisteme, ose nga ngjarje të jashtme të caktuara.

Departamenti i menaxhimit të rrezikut në TEB dhe njësia e tij e dedikuar për rrezikun operacional janë përgjegjës për monitorimin e ngjarjeve të rrezikut operacional sipas përkufizimit të Komitetit të Bazelit. Banka ka një sistem të përshtatshëm për natyrën, shkallën dhe kompleksitetin e biznesit të Bankës sa i përket identifikimit efektiv të Indikatorëve Kyç të Rrezikut (IKR) dhe vlerësimit, monitorimit dhe kontrollit të rrezikut përkatës operacional. Njësia e rrezikut operacional zbaton metodat për t'i ndihmuar departamentet tjera në identifikimin, monitorimin, kontrollimin dhe zbutjen e incidenteve potenciale operationale. Rreziku operacional ofron trajnime të rrezikut operacional për gjithë punonjësit, sidomos ata që janë përgjegjës për raportimin e incidenteve ndaj rrezikut operacional tek Njësia e vazhdimësisë së biznesit, dhe vlerësimin e të gjitha proceseve për

sa i përket rrezikut operacional dhe identifikimin e proceseve me rrezik të lartë.

Vazhdimësia e biznesit, pavarësisht nga lloji dhe arsyeja, përbëhet tërësisht nga planet që sigurojnë vazhdimësinë e funksioneve kritike biznesore të bankës në rast të ndërprerjes së çdo biznesi që rrjedh nga faktorët e brendshëm dhe të jashtëm. Njësia e Rrezikut Operacional dhe e Vazhdimësisë së Biznesit angazhohet vazhdimisht në përkufizimin, matjen dhe raportimin e rrezikut në Departamentin e Menaxhimit të Rrezikut. Rezultatet e aktiviteteve të rrezikut operacional dhe vazhdimësisë së biznesit shqyrtohen dhe vlerësohen në baza mujore në nivel të Bordit përmes Komitetit për menaxhimin e rrezikut dhe në baza tre-mujore në Bordin e Drejtorëve.

## 5.6. Pajtueshmëria

Banka jonë i zbaton standardet më të larta dhe metodat e praktikave më të mira ndërkombëtare në luftimin shpëlarjes së parave, të financimit të terrorizmit dhe të akteve të tjera të dënueshme me ligj. Të gjithë punonjësit e bankës përkushtohen për t'i arritur këto standarde për të shmangur keqpërdorimin e produkteve dhe shërbimeve të bankës për qëllime të pastrimit të parave, financimit të terrorizmit dhe akteve të tjera të dënueshme me ligj. Politikat dhe procedurat e pajtueshmërisë së Bankës janë të dizajnuara për të siguruar që banka jonë të veprojë në përputhje me kërkesat e përcaktuara në legjislacionin e Kosovës dhe praktikat më të mira të industrisë për sektorin e shërbimeve financiare nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës dhe standardet e Grupit BNPP.

Banka jonë është zotuar për të vepruar me integritet dhe përgjegjësi në shërbimet bankare. Ne besojmë se në krijimin e vlerës për klientët tanë, aksionarët, punonjësit dhe shoqërinë, mënyra se si ne bëjmë biznes është po aq e rëndësishme sa qëndrueshmëria e modelit tonë të biznesit dhe rritjes. Nënkuptohe se respektimi i ligjeve dhe rregulloret dhe standardeve dhe udhëzimeve më të larta ndërkombëtare është

pjesë e identitetit tonë dhe formon themelin se si ne e ushtrojmë biznesin. Ne vendosim standarde të larta të integritetit të biznesit dhe sjelljes etike me qëllim të rritjes së efektivitetit të kornizës së pajtueshmërisë. Viti 2018 ishte vendimtar për zgjerimin e kornizës së kontrollit KPP/LFT (Kundër Pastrimi i Parave /Luftimi i Financimit të Terrorizmit). Për realizimin e këtij qëllimi janë ndërmarrë disa veprime; përmirësimi i cilësisë së analizës së alarmit KPP, kontrollet e skenarëve KPP dhe kontrollet e validimit të parave së gatshme.

Fryma jonë ekipore, përkushtimi dhe përmirësimi i qëndrueshëm i efikasitetit tonë të gjitha kanë për qëllim ruajtjen e integritetit të institucionit tonë. Kodi i sjelljes i bankës përfshin dispozita etike të biznesit që synojnë menaxhimin e parandalimit të pastrimit të parave, financimit të terrorizmit dhe sanksioneve të tjera financiare ndërkombëtare, ryshfetit dhe korrupsionit. Jemi të përkushtuar për të respektuar ligjet, rregulloret dhe udhëzimet e rrepta për ta luftuar pastrimin e parave, financimin e terrorizmit dhe për ta parandaluar shkeljen e sanksioneve financiare ndërkombëtare.

Banka jonë zbaton mekanizma të përpiktë të mbështetur nga sisteme të automatizuara të monitorimit, procesin e rishikimit të klientit "Njih Klientin Tuaj" (NjKT), parimet e kujdesit të duhur ndaj klientit si dhe parimet e qasjes bazuar në rrezik që janë në krye të prioriteteve tona. Procesi i rishikimit të NjKT-së shërben për t'i përditësuar informatat e klientëve me qëllim të uljes së rasteve të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.

Me qëllim të promovimit të programit tonë të pajtueshmërisë KPP dhe për të siguruar vetëdijesimin dhe respektimin nga punonjësve tanë, në vitin 2018 ne kemi ofruar trajnime (duke përfshirë mësimin përmes internetit "e-learning" dhe modulet e veçanta për temat kyçe të pajtueshmërisë) për të gjithë punonjësit e Bankës. Duke marrë parasysh rëndësinë e luftës kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, si dhe pajtueshmërinë me sanksionet ndërkombëtare, të gjithë punonjësit marrin pjesë në trajnime të rregullta. Modulet e mësimit elektronik janë në dispozicion për të gjithë punonjësit dhe mund të përshtaten me nevojat e linjave tona të biznesit në përputhje me kërkesat specifike të punës. Shumica e disiplinave të mbuluara nga modulet profesionale janë të bazuara në konceptet e përbashkëta të transparencës.

Në vitin 2019, objektivi kryesor është të përqendrohemi në parimet e fuqizimit të qasjes në bazë të rrezikut, duke përfshirë, por pa u kufizuar në: luftimin e ryshfetit dhe korrupsionit, luftimin kundër pastrimit të parave dhe luftimin e financimit të terrorizmit duke zbatuar projektet vendimtare për forcimin e infrastrukturës sonë të TI dhe qasjet ndër-funksionale për të parandaluar pastrimin e parave, financimin e terrorizmit, parandalimin e sanksioneve financiare ndërkombëtare.

Divizioni ynë i Pajtueshmërisë udhëhiqet nga Menaxheri i Lartë dhe është i pavarur nga të gjitha funksionet e tjera të bankës. Udhëheqësi i Divizionit të Pajtueshmërisë i raporton drejtpërdrejt Bordit të Drejtorëve përmes Komitetit të Auditimit që e siguron pavarësinë e Divizionit.

## 5.7. Kontrolli i brendshëm

Departamenti i kontrollit të brendshëm ka për qëllim që të sigurojë që punonjësit të kryejnë punën sipas politikave dhe procedurave të kompanisë në TEB Sh.A. Ky merret me koordinimin e domosdoshëm dhe siguron se aktivitetet përkatëse kryhen rregullisht, në mënyrë efikase, efektive dhe në përputhje

me strategjitë dhe politikat e menaxhmentit të Bankës, si dhe me rregullat dhe rregulloret në fuqi. Në TEB, funksionet e Kontrollit të Brendshëm dhe Rrezikut Operacional janë të strukturuar ndarazi. Departamenti i Kontrollit të Brendshëm është i pozicionuar si një pjesë përbërëse e kontrollit të nivelit të dytë, që i strukturon dhe i ekzekuton detyrat e tij siç duhet.

Kontrollet e aktiviteteve në degë dhe departamentet e Zyrës Qendrore kryhen nga Njësia e Kontrollit të Degës, Njësia e Kontrollit Qendror dhe Njësia e Kontrollit të Kredive. Rishikimet e procesit janë të përfshira edhe në kontrollet e rregullta të Departamentit. Për më tepër, Departamenti i Kontrollit të Brendshëm po ashtu kryen pjesën më të madhe të kontrolleve të grupit në Bankë përkatësisht: Pikat Kryesore të Monitorimit (PKM) që mbulojnë fusha të ndryshme p.sh. kontabilitetin, kreditë, TI, etj.

Kontrolluesi kryen kontrollet e tij/saj në pajtim me fushën e përgatitur paraprakisht dhe në pajtim me rregullat dhe rregulloret e brendshme dhe të jashtme. Fushat e kontrollit revidohen në rast të ndryshimeve në rregullat dhe rregulloret e brendshme dhe/ose të jashtme.

Kontrollet përcaktohen me synim të:

- Verifikimit të respektimit të duhur të rregullave dhe procedurave të brendshme dhe konsistencën e rregullave të brendshme me rregulloret ligjore si dhe pajtueshmërinë me to;
- Kontributit lidhur me ruajtjen e aseteve;
- Vlerësimit të mjaftueshmërisë, efektivitetit dhe efikasitetit të aktiviteteve të përditshme; dhe
- Kontributit në identifikimin dhe vlerësimin e rreziqeve lidhur me aktivitetet afariste aktuale dhe të ardhshme të propozuara të biznesit duke përfshirë produktet e reja.

Departamenti i Kontrollit të Brendshëm është një organ i pavarur që i raporton drejtpërdrejt Bordit të Drejtorëve nëpërmjet Komitetit të Auditimit në baza tre-mujore.

**Raport i Auditimit të Pavarur më  
31 Dhjetor 2018  
dhe Shënimet e Pasqyrave Financiare**

**TEB SH.A.**

**Pasqyrat financiare të përgatitura në përputhje me  
Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar  
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018**

## PËRMBAJTJA

Raporti i audituesit të pavarur .....	i
Pasqyra e pozicionit financiar .....	1
Pasqyra e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse.....	2
Pasqyra e ndryshimeve në kapital .....	3
Pasqyra e rrjedhjes së parasë.....	4
Shënime për pasqyrat financiare:	
1. Hyrje .....	5
2. Politikat e rëndësishme kontabël.....	5
3. Vlerësimet dhe gjykimet kritike të kontabilitetit në zbatimin e politikave kontabël.....	14
4. Zbatimi i standardeve dhe interpretimeve të reja ose rishikuara.....	17
5. Standardet e reja kontabël.....	19
6. Paraja dhe gjendja me bankën qendrore.....	21
7. Kreditë dhe paradhëniet për bankat.....	22
8. Investimet në letra me vlerë të matura në vlerën e drejtë përmes të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse dhe aktive financiare të gatshme për shitje (për informacionin krahasues) .....	24
9. Kreditë dhe paradhëniet për klientët .....	25
10. Aktive të tjera financiare.....	32
11. Aktive të tjera.....	32
12. Pasuri dhe pajisje .....	33
13. Aktivitet e patrupëzuara .....	34
14. Detyrimet ndaj klientëve.....	34
15. Huamarrjet dhe borxhi i varur.....	35
16. Detyrime të tjera financiare .....	35
17. Detyrime të tjera .....	36
18. Kapitali aksionar .....	36
19. Të ardhurat nga interesi .....	37
20. Shpenzimet për interes .....	37
21. Të ardhurat nga tarifat dhe komisionet .....	37
22. Shpenzimet për tarifat dhe komisione .....	37
23. Shpenzimet e personelit .....	37
24. Shpenzime administrative dhe të tjera operative.....	38
25. Shpenzimet e tatimit në të ardhurat e korporatave .....	38
26. Shpalosjet për palët e ndërlidhura .....	39
27. Angazhimet dhe kontigjencat.....	40
28. Menaxhimi i kapitalit.....	42
29. Menaxhimi i rrezikut financiar .....	43
30. Vlera e drejtë e instrumenteve financiare.....	55
31. Paraqitja e instrumenteve financiare sipas kategorisë së matjes .....	57
32. Ngjarjet pas perfundimit të periudhës raportuese .....	57
33. Politikat e kontabilitetit të zbatuara deri me 1 janar 2018.....	58

## *Raporti i Audituesit të Pavarur*

Drejtuar aksionarit të TEB SH.A.

### *Opinionin tonë*

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të TEB SH.A. ("Shoqëria") më 31 dhjetor 2018, si dhe performancën e saj financiare dhe rrjedhën e parasë për vitin e mbyllur në këtë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar.

### **Ne kemi audituar:**

Pasqyrat financiare të Shoqërisë përfshijnë:

- pasqyrën e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2018;
- pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin e mbyllur në atë datë;
- pasqyrën e ndryshimeve në kapital për vitin e mbyllur në atë datë;
- pasqyrën e rrjedhës së parasë për vitin e mbyllur në atë datë; dhe
- shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare, të cilat përfshijnë një përmbledhje të politikave të rëndësishme kontabël dhe çështje të tjera.

### *Baza për opinionin*

Ne kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve përshkruhen më tej në seksionin *Përgjegjësitë e audituesit për auditimin e pasqyrave financiare* në raportin tonë.

Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi marrë është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë.

### **Pavarësia**

Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në përputhje me Kodin e Etikës për Profesionin e Kontabilistit të Bordit të Standardeve Ndërkombëtare të Etikës për Kontabilistët ("kodi i BSNEK"). Ne kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me kodin e BSNEK-së.

### *Përgjegjësitë e drejtimit dhe të personave të ngarkuar me qeverisjen në lidhje me pasqyrat financiare*

Drejtimi i Shoqërisë, është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar, dhe për kontrollet e brendshme, të cilat drejtimi i gjykon të nevojshme për përgatitjen e pasqyrave financiare pa gabime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo pasaktësive.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi i Shoqërisë është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Shoqërisë për të kryer veprimtarinë në vijimësi, duke vënë në dispozicion informacione për çështjet që kanë të bëjnë me vijueshmërinë e aktivitetit, nëse është e zbatueshme, përveç rasteve kur drejtimi synon ta likuadojë Shoqërinë apo të ndërpresë aktivitetin, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përveç sa më sipër.

Personat e ngarkuar me qeverisjen e Shoqërisë janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shoqërisë.

## Raporti i Audituesit të Pavarur (vazhdim)

### *Përgjegjësitë e audituesit për auditimin e pasqyrave financiare*

Objektivat tona janë të arrijmë siguri të arsyeshme që pasqyrat financiare në tërësi, nuk përmbajnë gabime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo të pasaktësive, dhe të lëshojmë një raport auditimi, duke përfshirë opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk jep garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë, në rast se ekziston, një gabim material. Gabimet mund të vijnë si rezultat i mashtrimit apo pasaktësive dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht apo të marra së bashku, ekziston një pritshmëri e arsyeshme që të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Si pjesë e një auditimi në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykim profesional dhe ruajmë skepticizëm profesional gjatë gjithë procesit të auditimit. Për më tepër, ne:

- identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e gabimit material në pasqyrat financiare, si rezultat i mashtrimit apo pasaktësisë, hartojmë dhe kryejmë procedura auditimi që i përgjigjen këtyre rreziqeve, si dhe sigurojmë të dhëna të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit, në mënyrë që të shërbejnë si bazë për opinionin tonë. Rreziku për të mos identifikuar një gabim material si rezultat i mashtrimit është më i lartë sesa një gabim si rezultat i pasaktësisë, për shkak se mashtrimi mund të përfshijë një marrëveshje të fshehtë, falsifikim, mosveprim të qëllimshëm, shtrembërim, ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- sigurojmë kuptueshmëri të kontrollit të brendshëm të auditimit, me qëllim hartimin e procedurave të auditimit që u përshtaten rrethanave, por jo për qëllime të shprehjes së një opinionimi mbi efikasitetin e kontrollit të brendshëm të Shoqërisë.
- vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël, si edhe shënimeve shpjeguese të përgatitura nga drejtimi.
- arrijmë në përfundime mbi përshtatshmërinë e parimit kontabël të vijimësisë së veprimtarisë të përdorur nga drejtimi dhe bazuar në evidencën e siguruar të auditimit, nëse ka një pasiguri të materiale në lidhje me ngjarje apo kushte që mund të ngjallin dyshime të rëndësishme në lidhje me aftësinë e Shoqërisë për të vijuar veprimtarinë. Në rast se arrijmë në përfundimin që ekziston një pasiguri materiale, jemi të detyruar që të tërheqim vëmendjen në raportin tonë të audituesit në lidhje me shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare ose, në rast se shënimet shpjeguese nuk janë të përshtatshme, të modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona janë të bazuara në evidencën e auditimit të siguruar deri në datën e raportit tonë të audituesit. Pavarësisht kësaj, ngjarje apo kushte në të ardhmen, mund të shkaktojnë ndërprerjen e vijimësisë së veprimtarisë së Shoqërisë.
- vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, duke përfshirë shënimet shpjeguese dhe nëse pasqyrat financiare paraqesin veprimet dhe ngjarjet në mënyrë të atillë që sigurohet paraqitja e drejtë.

Ne komunikojmë me personat e ngarkuar me qeverisjen e Shoqërisë, ndërmjet të tjerash, në lidhje me qëllimin dhe afatet e planifikuara të auditimit si dhe gjetjet e rëndësishme të konstatuara nga audituesi, përfshirë mangësitë e rëndësishme në sistemin e kontroleve të brendshme që identifikojmë gjatë auditimit tonë.

*PricewaterhouseCoopers Kosovo sh. p. k.*

PricewaterhouseCoopers Kosovo sh.p.k.  
15 mars 2019  
Prishtinë, Kosovë

Jonid Lamllari  
Auditues Ligjor





**TEB SH.A.**  
**Pasqyra e pozicionit financiar**

*(Të gjitha shumat janë shprehur në mijë euro, përvec kur specifikohet ndryshe)*

	Shënime	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
<b>AKTIVET</b>			
Paraja e gatshme dhe gjendjet me bankat	6	88,478	87,653
Kreditë dhe paradhëniet për bankat	7	54,239	5,975
Investime në letra me vlerë	8	16,254	-
Aktive financiare të gatshme për shitje	8	-	15,407
Kreditë dhe paradhëniet për klientët	9	383,307	367,990
Aktive të tjera financiare	10	3,663	3,016
Aktive të tjera	11	1,799	1,649
Pasuri dhe pajisje	12	5,415	4,756
Aktivitet e patrupëzuara	13	2,091	2,073
Aktivitet tatimore të shtyra	25	468	-
Parapagimi i tatimit në të ardhurat e korporatave	11	174	-
<b>GJITHSEJ AKTIVE</b>		<b>555,888</b>	<b>488,519</b>
<b>DETYRIMET</b>			
Detyrime ndaj klientëve	14	455,479	381,091
Detyrime të tjera	17	1,238	841
Detyrime të tjera financiare	16	3,514	5,385
Detyrimet e tatimit në të ardhurat e korporatave		-	735
Detyrimet tatimore të shtyra	25	-	205
Huamarrjet	15	9,242	7,818
Borxhi i varur	15	-	4,455
<b>GJITHSEJ DETYRIME</b>		<b>469,473</b>	<b>400,530</b>
<b>KAPITALI</b>			
Kapitali aksionar	18	24,000	24,000
Fitimi i akumuluar		62,409	63,963
Rezerva të tjera		6	26
<b>GJITHSEJ KAPITALI</b>		<b>86,415</b>	<b>87,989</b>
<b>GJITHSEJ DETYRIMET DHE KAPITALI</b>		<b>555,888</b>	<b>488,519</b>

Këto pasqyra financiare janë miratuar nga Menaxhmenti Ekzekutiv më 15 Mars 2019 dhe nënshkruar në emër të tyre nga:

Orçun Ozdemir  
 Kryeshef ekzekutiv

Rezak Fetai  
 Zyrtar Kryesor Financiar

Shënimet nga faqja 5 deri në faqen 61, janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare

**TEB SH.A.****Pasqyra e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse***(Te gjitha vlerat janë të shprehura në mijë EUR, përveç të shprehura ndryshe)*

	<b>Shënimi</b>	<b>2018</b>	<b>2017</b>
Të ardhurat nga interesi	19	30,692	29,331
Shpenzimet për interes	20	(1,737)	(1,735)
<b>Të ardhurat neto nga interesi</b>		<b>28,955</b>	<b>27,596</b>
Rikuperimi nga zhvlerësimi i kredive	9	768	4,168
<b>Të ardhurat neto nga interesi pas kthimit të provizionit për zhvlerësim të kredive</b>		<b>29,723</b>	<b>31,764</b>
Të ardhurat nga tarifatat dhe komisionet	2121	9,717	9,074
Shpenzimet për tarifatat dhe komisionet	22	(2,814)	(2,258)
Fitimet minus humbjet nga instrumentet financiare derivative		198	(480)
Fitimet minus humbjet nga rivlerësimi i kurseve të këmbimit		125	783
Të ardhurat të tjera operative		489	549
Provizionë të tjera	17	(1,162)	(421)
Shpenzimet e personelit	23	(7,777)	(7,632)
Shpenzimet e zhvlerësimit dhe amortizimit	12,13	(3,359)	(3,126)
Shpenzime administrative dhe të tjera shpenzime të veprimtarisë	24	(8,077)	(8,750)
<b>Fitimi para tatimit</b>		<b>17,063</b>	<b>19,503</b>
Shpenzimet e tatimit në të ardhurat e korporatave	25	(1,877)	(2,864)
<b>Fitimi për vitin</b>		<b>15,186</b>	<b>16,639</b>
<b>Të ardhurat të tjera gjithëpërfshirëse:</b>			
<i>Zërat që mund të riklasifikohen më pas në fitim ose në humbje:</i>			
Instrumentet financiare të gatshme për shitje:			
Fitimet minus humbjet gjatë vitit, neto nga tatimi	25	-	26
Instrumentet e borxhit me vlerë të drejtë nëpërmjet të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse:			
Fitimet minus humbjet gjatë vitit, neto nga tatimi	25	(20)	-
<b>Gjithsej të ardhurat gjithëpërfshirëse për vitin</b>		<b>15,166</b>	<b>16,665</b>

Shënimet nga faqja 5 deri në faqen 61, janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

**TEB SH.A.**  
**Pasqyra e ndryshimeve në kapital**

*(Të gjitha shumat janë shprehur në mijë euro, përveç kur specifikohet ndryshe)*

	<b>Kapitali Aksionar</b>	<b>Fitimi i akumuluar</b>	<b>Rezerva e vlerës së drejtë</b>	<b>Gjithsej</b>
<b>Gjendja, më 1 janar 2017</b>	<b>24,000</b>	<b>47,324</b>	-	<b>71,324</b>
Fitimi i vitit	-	16,639	-	<b>16,639</b>
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse	-	-	26	<b>26</b>
<b>Gjithsej të ardhurat gjithëpërfshirëse</b>	-	<b>16,639</b>	<b>26</b>	<b>16,665</b>
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2017 e raportuar më parë</b>	<b>24,000</b>	<b>63,963</b>	<b>26</b>	<b>87,989</b>
Ndikimi i standardeve të reja dhe të rishikuara	-	(5,240)	-	<b>(5,240)</b>
<b>Gjendja e riparaqitur më 1 janar 2018</b>	<b>24,000</b>	<b>58,723</b>	<b>26</b>	<b>82,749</b>
Fitimi i vitit	-	15,186	-	<b>15,186</b>
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse	-	-	(20)	<b>(20)</b>
<b>Gjithsej të ardhurat gjithëpërfshirëse</b>	-	<b>15,186</b>	<b>(20)</b>	<b>15,166</b>
Pagesa e dividendit	-	(11,500)	-	<b>(11,500)</b>
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2018</b>	<b>24,000</b>	<b>62,409</b>	<b>6</b>	<b>86,415</b>

Shënimet nga faqja 5 deri në faqen 61, janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

**TEB SH.A.**
**Pasqyra e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse**
*(Te gjitha vlerat janë të shprehura në mijë EUR, përveç të shprehura ndryshe)*

	Shënime	2018	2017
<b>Rrjedha e parasë nga aktivitetet operative</b>			
<b>Fitimi para tatimit</b>		<b>17,063</b>	<b>19,503</b>
<i>Rregullime për:</i>			
Zhvlrësim	12	1,394	1,388
Amortizim	13	1,965	1,739
Fitimet nga shitja e pasurive dhe të pajisjeve		(29)	(207)
Fitimet nga investimet në letra me vlerë		(9)	-
Fitimet nga instrumentet financiare derivative		(323)	-
Rikuperimi nga humbjet e pritshme kreditore	9	881	(3,373)
Humbjet e pritshme kreditore të aktiveve të tjera financiare		72	-
Provizionë të tjera të ndryshme	17	1,162	-
Të ardhura nga interesi		(30,692)	(29,331)
Shpenzime për interes		1,737	1,735
		<b>(6,779)</b>	<b>(8,546)</b>
<i>Rritja neto në:</i>			
Gjendjet me Bankën Qëndrore		(5,145)	(1,744)
Kredi dhe paradhënie për klientët		(21,623)	(36,120)
Aktive të tjera financiare		(620)	(372)
Aktive të tjera		(829)	267
<i>Rritja/(ulja) neto në</i>			
Detyrime ndaj klientëve		74,626	46,334
Detyrime të tjera financiare		(1,871)	1,101
Detyrime të tjera		(182)	166
		<b>44,356</b>	<b>9,632</b>
Interesi i arkëtuar		30,675	29,327
Interesi i paguar		(1,957)	(1,414)
Pagesa e tatimit në të ardhurat e korporatave		(2,874)	(2,809)
<b>Paraja neto nga aktivitetet operative</b>		<b>63,421</b>	<b>26,190</b>
<b>Rrjedha e parasë nga aktivitetet investuese</b>			
Blerja e investimeve në vlerë te drejtë përmes të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse.		(13,731)	-
Blerja e instrumenteve financiare të gatshme për shitje		-	(18,882)
Të ardhurat nga shitja e instrumenteve financiare të gatshme për shitje		12,922	18,202
Të ardhurat nga shitja e objekteve dhe e pajisjeve		26	207
Blerja e pronave dhe e pajisjeve	12	(2,055)	(1,991)
Blerja e aktiveve të patrupëzuara	13	(1,983)	(2,155)
<b>Paraja neto e përdorur në aktivitetet investuese</b>		<b>(4,821)</b>	<b>(4,619)</b>
<b>Rrjedha e parasë nga aktivitetet financiare</b>			
Pagesa e dividendës		(11,500)	-
Të ardhurat nga huamarrjet afatgjata		3,033	-
Ripagimi i huamarrjeve		(6,071)	(5,248)
<b>Paraja neto e përdorur në aktivitetet financiare</b>		<b>(14,538)</b>	<b>(5,248)</b>
<b>Rritja neto në paranë e gatshme dhe ekuivalentët e saj</b>			
Paraja dhe ekuivalentët e parasë në fillim të vitit		44,062	16,323
Paraja dhe ekuivalentët e parasë në fund të vitit	6	61,430	45,107
<b>Paraja dhe ekuivalentët e parasë në fund të vitit</b>		<b>105,492</b>	<b>61,430</b>

Shënimet nga faqja 5 deri në faqen 61, janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

*(Të gjitha shumat janë shprehur në mijë euro, përveç kur specifikohet ndryshe)*

## 1. Hyrje

Këto janë pasqyrat financiare të TEB sh.a ("Banka") për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2018 të përgatitura në përputhje me Standardet Ndërkombëtare për Raportim Financiar.

Banka është themeluar në Republikën e Kosovës më 19 dhjetor 2007, kur edhe iu miratua licenca për veprimtari bankare bazuar në rregulloret e Bankës Qendrore të Kosovës ("BQK"). Banka filloi veprimtarinë gjatë janarit 2008.

Banka kontrollohet nga TEB Holding AS, Shoqëri e themeluar në Turqi ("Kompania mëmë"), e cila zotëron 100% të aksioneve të zakonshme të bankës. Aksionarët e TEB Holding AS janë "BNP Paribas" dhe "Çolakoğlu Group", të cilët zotërojnë nga 50% të aksioneve. BNP Paribas është pala e fundit kontrolluese e kompanisë mëmë dhe Bankës.

**Selia dhe vendi i biznesit:** Adresa e regjistruar e Bankës është në Preoc p.n. KM7, magjistratja Prishtinë-Ferizaj, Graçanicë 10500, Republika e Kosovës

**Aktiviteti kryesor:** Banka vepron si bankë me të drejta të plota, në përputhje me Ligjin Nr. 04/L-093 për bankat institucionet mikrofinanciare dhe institucionet financiare jobankare dhe ofron shërbime për të gjitha kategoritë e konsumatorëve në Republikën e Kosovë, përmes rrjetit të saj prej 29 degësh (2017: 27) në Prishtinë, Gjakovë, Pejë, Prizren, Ferizaj, Mitrovicë dhe Gjilan.

Më 31 dhjetor 2018, Bordi i Drejtorëve të Bankës përbëhet nga

- Jacques Roger Jean Marie Rinino – Kryetar;
- Dr. İsmail Yanık – Zëvendës kryetar;
- Alp Yılmaz – Zëvendës kryetar;
- Ayşe Aşardağ - Anëtar;
- Birol Deper- Anëtar;
- Esra Peri Aydoğan - Anëtar;
- Orçun Özdemir - Anëtar dhe Kryeshef ekzekutiv;
- Osman Durmuş - Anëtar;
- Sabri Davaz - Anëtar; dhe
- Nilsen Altıntaş– Anëtar

**Monedha funksionale dhe e paraqitjes.** Këto pasqyra financiare janë paraqitur në Euro, e cila është monedha funksionale e Bankës. Monedha funksionale është monedha e mjedisit ekonomik kryesor në të cilin Banka ushtron veprimtarinë e saj, që është Republika e Kosovës.

Të gjitha shumat janë rrumbullkuar në mijëshen më të afërt, përveç rasteve kur specifikohet ndryshe.

## 2. Politikat e rëndësishme kontabël

### Bazat e përgatitjes

Këto pasqyra financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar ("SNRF") sipas parimit të kostos historike, të modifikuar nga njohja fillestare e instrumenteve financiare në bazë të vlerës së drejtë dhe nga rivlerësimi i instrumenteve financiare të kategorizuara me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes ("FVTPL") dhe me vlerën e drejtë nëpërmjet të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse ("FVOCI"). Politikat kryesore kontabël të zbatuara në përgatitjen e këtyre pasqyrave financiare janë paraqitur më poshtë. Përveç ndryshimeve të politikave kontabël që rezultojnë nga miratimi i SNRF 9 dhe SNRF 15, që kanë hyr në fuqi nga 1 janari 2018, këto politika janë zbatuar në mënyrë të vazhdueshme në të gjitha periudhat e paraqitura, përveç nëse është shprehur ndryshe.

(Të gjitha shumat janë shprehur në mijë euro, përveç kur specifikohet ndryshe)

## **2. Politikat e rëndësishme kontabël (vazhdim)**

### **Të ardhurat nga interesi dhe shpenzimet për interes**

Të ardhurat nga interesi dhe shpenzimet për interes njihen në fitim ose humbje duke përdorur metodën e interesit efektiv. Norma efektive e interesit është norma që saktësisht skanton pagesat dhe arkëtimet e ardhshme monetare përgjatë jetës së pritshme të aktivitetit financiar ose detyrimit financiar në vlerën e bartur të aktivitetit financiar ose detyrimit financiar. Gjatë llogaritjes së normës efektive të interesit, Banka vlerëson flukset monetare të ardhshme duke marrë parasysh të gjitha kushtet kontraktuale të instrumentit financiar, por jo humbjet e ardhshme nga kreditë. Llogaritja e normës efektive të interesit përfshin kostot dhe tarifën e transaksionit që janë pjesë përbërëse e normës efektive të interesit. Kostot e transaksionit përfshijnë kostot rritëse që i atribuohen drejtpërdrejt blerjes apo emetimit të një aktivi financiar ose detyrimi financiar. Të ardhurat nga interesi llogariten duke zbatuar normën efektive të interesit në vlerën kontabël bruto të aktiveve financiare, me përjashtim të aktiveve financiare që janë zhvlerësuar (Faza 3), për të cilat të ardhurat nga interesi llogariten duke zbatuar normën efektive të interesit në koston e amortizuar, neto nga provizionit për humbjet e ardhshme kreditore.

Të ardhurat nga interesi dhe shpenzimet për interes të paraqitura në pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse përfshijnë:

- Interesin mbi aktivet financiare dhe detyrimet financiare të matura me koston e amortizuar të llogaritur mbi bazën e interesit efektiv; dhe
- Interesin nga instrumentet financiare të gatshme për shitje (2017) dhe nga investimet në letra me vlerë të matura me vlerë të drejtë nëpërmjet të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse (2018) të llogaritura në bazë të interesit efektiv.

### **Tarifat dhe komisionet**

Tarifat të cilat janë pjesë përbërëse e normës efektive të interesit përfshijnë tarifën e disbursimit të arkëtuar ose të paguar nga subjekti, lidhur me krijimin ose blerjen e aktiveve financiare ose lëshimin e detyrimeve financiare, për shembull, tarifën për vlerësimin e aftësisë për kthimin e kredisë, vlerësimin dhe regjistrimin e garancive ose kolateralit, negociimin e kushteve të instrumenteve dhe tarifën për përpunimin e dokumentacionit të transaksionit. Tarifën e zotimit, të arkëtuar nga banka për të nisur kredi me normat e interesit të tregut, janë pjesë përbërëse e normës efektive të interesit nëse ka gjasa që banka të hyjë në një marrëveshje specifike për kredidhënie dhe nuk pret ta shesë kredinë rezultuese menjëherë pas nisjes së saj. Të gjitha tarifat e tjera, komisionet dhe zërat e të ardhurave dhe shpenzimeve të tjera përgjithësisht regjistrohen në bazë të parimit të të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara duke iu referuar përfundimit të transaksionit specifik mbi bazën e shërbimeve reale të kryera si përqindje e shërbimeve të përgjithshme, të cilat do të ofrohen. Të ardhurat dhe shpenzimet e tjera nga tarifat dhe komisionet përfshijnë tarifën dhe komisionet nga (për): kredit kartela, tarifën e shërbimit të llogarisë, pagesat ndërkombëtare, pagesat e brendshme, tarifën e Bankës Qendrore, tarifën për shërbimet online, garancitë dhe letër kreditë si dhe tarifën dhe komisionet e tjera. Tarifat dhe komisionet e tjera njihen në momentin e ofrimit të shërbimeve të ndërlidhura. Shpenzimet e tjera të tarifave dhe komisioneve kanë të bëjnë kryesisht me tarifën e transaksioneve dhe shërbimeve, të cilat janë shpenzuar kur shërbimet janë pranuar.

### **Instrumentet financiare - termat kyçe të matjes**

Në varësi të klasifikimit, instrumentet financiare mbahen në vlerën e drejtë ose në koston e amortizuar siç përshkruhet më poshtë.

**Matja e vlerës së drejtë** Vlera e drejtë është çmimi me të cilin aktivi mund të shitet ose të paguhet për të transferuar një detyrim në një transaksion të zakonshëm mes pjesëmarrësve në treg në datën e matjes në një treg primar, ose në mungesë të tij, në tregun më të favorshëm në të cilin Banka ka qasje në atë datë. Dëshmia më e mirë e vlerës së drejtë është çmimi në një treg aktiv. Treg aktiv është ai ku transaksionet për aktivin ose detyrimin ndodhin me frekuencë dhe volum të mjaftueshëm për të siguruar informata të çmimeve në mënyrë të vazhdueshme.

Kur është e mundur, Banka mat vlerën e drejtë të një instrumenti duke përdorur çmimin e kuotuar në një treg aktiv për atë instrument. Nëse nuk ka çmim të kuotuar në një treg aktiv, atëherë Banka përdor teknikat e vlerësimit që maksimizojnë përdorimin e inputeve përkatëse të vëzhgueshme dhe minimizojnë përdorimin e inputeve që nuk vëzhgohen. Teknika e zgjedhur e vlerësimit përfshin të gjithë faktorët që pjesëmarrësit e tregut do të merrnin parasysh në vendosjen e çmimit të një transaksioni.

*(Të gjitha shumat janë shprehur në mijë euro, përveç kur specifikohet ndryshe)*

## **2. Politikat e rëndësishme kontabël (vazhdim)**

### **Instrumentet financiare - Termat kyçe të matjes (vazhdim)**

Dëshmia më e mirë e vlerës së drejtë të një instrumenti financiar në njohjen fillestare është zakonisht çmimi i transaksionit, përkatësisht vlera e drejtë e shumës së dhënë ose të marrë. Nëse Banka përcakton që vlera e drejtë në njohjen fillestare ndryshon nga çmimi i transaksionit dhe vlera e drejtë nuk evidentohet as nga një çmim i kuotuar në një treg aktiv për një aktiv apo detyrim identik, ose të bazuar në një teknikë vlerësimi që përdor vetëm të dhënat nga tregjet e vrojtueshme, atëherë instrumenti financiar fillimisht matet me vlerën e drejtë, të rregulluar për të shtyrë diferencën midis vlerës së drejtë në njohjen fillestare dhe çmimin e transaksionit.

Më pas, ky ndryshim njihet në fitim ose humbje në një bazë të përshtatshme gjatë jetës së instrumentit, por jo më vonë se kur vlerësimi mbështetet tërësisht nga të dhënat e vëzhgueshme të tregut ose kur transaksioni mbyllet. Banka nuk ka instrumente ku vlera e drejtë në njohjen fillestare ndryshon nga çmimi i transaksionit.

Nëse një aktiv apo detyrim i matur me vlerën e drejtë ka një çmim të ofertës dhe një çmim të kërkesës, atëherë Banka mat aktivet dhe pozicionet e gjata me çmimin e ofertes, dhe detyrimet dhe pozicionet e shkurtra në një çmim të kërkesës.

Vlera e drejtë e depozitave nuk është më e vogël se shumata e pagueshme sipas kërkesës, e skontuar nga data e parë në të cilën shumata mund të kërkohej të paguhet. Banka njih transferet midis niveleve të hierarkisë së vlerës së drejtë deri në fund të periudhës raportuese gjatë së cilës ka ndodhur ndryshimi.

*Kostoja e amortizuar* është vlera me të cilën instrumenti financiar matet në njohjen fillestare, minus pagesat e principalit, plus interesi i përlllogaritur, dhe për aktivet financiare, minus zhvlerësimi për humbjet nga rënia e vlerës. Interesi i përlllogaritur përfshin amortizimin e kostos së shtyrë të transaksionit në njohjen fillestare dhe çdo premi ose zbritje për shumën e maturimit, duke përdorur metodën e interesit efektiv. Të ardhurat e interesit të përlllogaritur dhe shpenzimet e interesit të përlllogaritur, duke përfshirë edhe kuponët e përlllogaritur dhe zbritjen e amortizuar ose primet (duke përfshirë tarifën e shtyra fillestare, nëse ka) nuk paraqiten të ndara dhe përfshihen në vlerat e bartura të zërave përkatës në pasqyrën e pozicionit financiar.

*Metoda e interesit efektiv* është një metodë e alokimit të të ardhurave nga interesi ose shpenzimeve të interesit gjatë periudhës përkatëse, në mënyrë që të arrihet një normë periodike konstante e interesit (norma efektive e interesit) në vlerën kontabël. Norma efektive e interesit është norma që saktësisht skonton pagesat e ardhshme ose arkëtimet (duke përjashtuar humbjet e ardhshme të kredisë) përhgjatë jetës së pritshme të instrumentit financiar ose një periudhe më të shkurtër, nëse është e përshtatshme, në vlerën kontabël neto të instrumentit financiar. Portfolio e instrumenteve financiare derivative ose aktiveve dhe detyrimeve tjera financiare që nuk janë tregtuar në një treg aktiv maten me vlerën e drejtë të një grupi të aktiveve financiare dhe detyrimeve financiare mbi bazën e çmimit që do të pranohej për të shitur një pozicion të gjatë neto (p.sh. një aktiv) për një ekspozim të veçantë të rrezikut ose paguhej për të transferuar një pozicion të shkurtër neto (p.sh. një detyrim) për një ekspozim të veçantë të rrezikut në një transaksion të zakonshëm midis pjesëmarrësve në treg në datën e matjes. Kjo është e zbatueshme për aktivet e bartura me vlerën e drejtë mbi bazën e përsëritjes nëse banka: (a) menaxhon grupin e aktiveve financiare dhe detyrimeve financiare mbi bazën e ekspozimit neto të Bankës ndaj një rreziku të caktuar (ose rreziqeve) të tregut ose ndaj rrezikut kreditor të një pale tjetër të veçantë në përputhje me strategjinë e dokumentuar për menaxhimin e rrezikut ose me strategjinë e investimeve; (b) jep informata mbi atë bazë për grupin e aktiveve dhe detyrimeve tek personeli menaxhues kryesor i Bankës; dhe (c) rreziqet e tregut, duke përfshirë edhe kohëzgjatjen e ekspozimit të Bankës ndaj një rreziku (rreziqeve) të veçantë të tregut që dalin nga aktivet dhe detyrimet financiare janë në thelb të njëjta.

*Kostot e transaksionit* janë kosto shtesë që i atribuohen drejtpërsëdrejti blerjes, lëshimit ose nxjerrjes jashtë përdorimit të një instrumenti financiar. Një kosto shtesë është ajo kosto e cila nuk do të kishte ndodhur nëse as transaksioni nuk do të kishte ndodhur. Kostot e transaksionit përfshijnë tarifën dhe komisionet që u paguhet agjentëve (duke përfshirë punonjësit që veprojnë si agjentë shitës), këshilltarët, agjentët dhe tregtarët, taksat nga agjencitë rregullatore dhe shkëmbimet e letrave me vlerë si dhe transferimin e taksave dhe detyrimeve. Kostot e transaksionit nuk përfshijnë primet e detyrimeve/zbritjeve, kostot e financimit ose shpenzimet e brendshme administrative ose të mbajtjes.

*Aktivët financiarë - klasifikimi dhe matjet pasuese - kategoritë e matjes.* Banka klasifikon aktivet financiare në kategoritë e mëposhtme të matjes: Vlera e drejtë nëpërmjet pasqyrës së fitimit ose humbjes (FVTPL), Vlera e drejtë nëpërmjet të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse (FVOCI) dhe kosto të amortizuar (AC). Klasifikimi dhe matja pasuese e aktiveve financiare të borxhit varet nga: (i) modeli i biznesit i Bankës për menaxhimin e portofolit të aktiveve të lidhura dhe (ii) karakteristikat e fluksit të mjeteve monetare të aktivitetit.

(Të gjitha shumat janë shprehur në mijë euro, përveç kur specifikohet ndryshe)

## **2. Politikat e rëndësishme kontabël (vazhdim)**

### **Instrumentet financiare - Termat kyçe të matjes (vazhdim)**

**Aktivët financiarë - klasifikimi dhe matja pasuese - modeli i biznesit.** Modeli i biznesit pasqyron mënyrën se si Banka menaxhon aktivet në mënyrë që të gjenerojë flukse monetare - nëse objektivi i Bankës është: (i) vetëm për të mbledhur flukse kontraktuale të mjeteve monetare nga aktivet ("të mbajtura për të mbledhur flukse kontraktuale të mjeteve monetare") ose (ii) për të mbledhur të dyja flukset e mjeteve monetare kontraktuale dhe flukset e mjeteve monetare që rrjedhin nga shitja e aktiveve ("të mbajtura për të mbledhur flukse monetare kontraktuale dhe për shitje") ose, nëse asnjë nga (i) dhe (ii) nuk aplikohet, aktivet financiarë klasifikohen si pjesë e modelit "tjetër" të biznesit dhe maten në FVTPL. Modeli i biznesit përcaktohet për një grup aktivesh (në nivel portofoli) bazuar në të gjitha dëshmitë përkatëse për aktivitetet që Banka ndërmerr për të arritur objektivin e përcaktuar për portofolin në dispozicion në datën e vlerësimit. Faktorët e konsideruar nga Banka në përcaktimin e modelit të biznesit përfshijnë qëllimin dhe përbërjen e një portofoli, përvojën e kaluar në mënyrën se si janë arkëtuar flukset e mjeteve monetare për aktivet përkatëse, si vlerësohen dhe menaxhohen rreziqet, si vlerësohet performanca e aktiveve dhe si menaxherët janë kompensuar. Referojuni Shënimit 3 për gjykimet kritike të aplikuara nga Banka në përcaktimin e modeleve të biznesit për aktivet e saj financiare.

**Aktivët financiarë - klasifikimi dhe matja pasuese - karakteristikat e rrjedhës së parasë.** Kur modeli i biznesit është që të mbajë aktivet për të mbledhur flukse monetare kontraktuale ose për të mbledhur flukse monetare kontraktuale dhe për shitje, Banka vlerëson nëse flukset e mjeteve monetare përfaqësojnë vetëm pagesat e principalit dhe interesit ("SPPI"). Aktivet financiarë me derivativët e përfshirë konsiderohen në tërësinë e tyre kur përcaktohet nëse flukset e tyre të parasë janë në përputhje me tiparin e SPPI. Gjatë kryerjes së këtij vlerësimi, Banka shqyrton nëse flukset monetare kontraktuale janë në përputhje me një marrëveshje bazë të kredidhënies, përkatësisht nëse interesi përfshin vetëm konsideratën për rrezikun e kredisë, vlerën në kohë të parasë, rreziqet e tjera bazë të kredidhënies dhe marzhin e fitimit.

Kur kushtet kontraktuale paraqesin ekspozim ndaj rrezikut ose paqëndrueshmëri që nuk është në përputhje me një marrëveshje bazë të kredidhënies, aktiviteti financiar klasifikohet dhe matet në FVTPL. Vlerësimi i SPPI kryhet në njohjen fillestare të një aktivi dhe nuk rivlerësohet më pas. Referojuni Shënimit 3 për gjykimet kritike të zbatuara nga Banka në kryerjen e testit SPPI për aktivet e saj financiare.

**Aktivët financiarë - riklasifikimi.** Instrumentet financiare riklasifikohen vetëm kur modeli i biznesit për menaxhimin e portofolit në tërësi ndryshon. Riklasifikimi ka një efekt të ardhshëm dhe zhvillohet që nga fillimi i periudhës së parë të raportimit që vijon pas ndryshimit të modelit të biznesit. Banka nuk ka ndryshuar modelin e saj të biznesit gjatë periudhës aktuale dhe krahasuese dhe nuk ka bërë ndonjë riklasifikim.

**Zhvlrësimi i mjeteve financiare – lejimi për humbjet e pritshme kreditore.** Banka vlerëson Humbjet e Pritshme Kreditore (ECL) për instrumentet e borxhit të matura në Kosto të Amortizuar (AC) dhe FVOCI dhe për ekspozimet që rrjedhin nga angazhimet kreditore dhe kontratat e garancisë financiare. Banka mat ECL-në dhe njeh lejimet për humbjet kreditore në çdo datë raportimi. Matja e ECL pasqyron: (i) një shumë të paanshme dhe të ponderuar në bazë të probabilitetit që përcaktohet duke vlerësuar një sërë rezultatesh të mundshme, (ii) vlerën në kohë të parasë dhe (iii) të gjithë informacionin e arsyeshëm dhe të mbështetshëm që është në dispozicion pa kosto dhe përpjekje te panevojshme në fund të secilës periudhë raportuese për ngjarjet e kaluara, kushtet aktuale dhe parashikimet e kushteve të ardhshme. Instrumentet e borxhit të matur në AC janë paraqitur në pasqyrën e pozicionit financiar, neto nga lejimi për ECL. Për angazhimet e kredisë dhe garancionet financiare, një provizion i veçantë për ECL njihet si detyrim në pasqyrën e pozicionit financiar. Për instrumentet e borxhit në FVOCI, ndryshimet në koston e amortizuar, neto nga lejimi për ECL, njihen në fitim ose humbje dhe ndryshimet e tjera në vlerën kontabël njihen në OCI si fitime minus humbjet në instrumentet e borxhit në FVOCI. Banka aplikon një model në tre faza për zhvlrësim, bazuar në ndryshimet në cilësinë e kredisë që nga njohja fillestare. Një instrument financiar që nuk është i zhvlrësuar në njohjen fillestare klasifikohet në Fazën 1.



(Të gjitha shumat janë shprehur në mijë euro, përveç kur specifikohet ndryshe)

## **2. Politikat e rëndësishme kontabël (vazhdim)**

### **Instrumentet financiare - Termat kyçe të matjes (vazhdim)**

Aktivitetet financiare në Fazën 1 kanë ECL-në e tyre të matur në një shumë të barabartë me pjesën e ECL të jetëgjatësisë së tyre që rezultojnë nga ngjarjet e mundshme të falimentimit brenda 12 muajve të ardhshëm ose deri në maturimin kontraktual, nëse është më i shkurtër se 12 muaj ("12 Muaj ECL"). Nëse Banka identifikon një rritje të konsiderueshme të rrezikut të kredisë ("SICR") që nga njohja fillestare, aktivi transferohet në Fazën 2 dhe ECL matet bazuar në ECL përgjatë jetëgjatësisë së aktivitetit, përkatësisht deri në maturimin kontraktual, por duke marrë parasysh parapagimet e pritura, nëse ka ("Lifetime ECL").

Referojuni paragrafit të *rritjes së konsiderueshme në rrezikun kreditor "SICR"* për shpjegimin se si Banka përcakton kur ka ndodhur një SICR. Nëse Banka përcakton që një aktiv financiar është zhvlerësuar, aktivi transferohet në Fazën 3 dhe ECL e saj maten si ECL përgjatë jetëgjatësisë së aktivitetit. Përkufizimi i Bankës për aktivitetet e zhvlerësuara dhe përkufizimi i dështimit shpjegohen në paragrafin e zhvlerësimit të aktiveve financiare. Për aktivitetet financiare që janë të zhvlerësuara në blerje ose në krijim ("POCI"), ECL matet gjithmonë si ECL përgjatë jetëgjatësisë së aktivitetit.

Përfundimisht, për instrumente të caktuara financiare, të tilla si kredit kartelat, që mund të përfshijnë edhe kredi edhe një përbërës të angazhimit të pasfrytëzuar, Banka mat humbjet e pritura kreditorë gjatë periudhës që Banka është e ekspozuar ndaj rrezikut të kredisë, përkatësisht deri kur humbjet kreditorë do të zbuten nga veprimet e administrimit të rrezikut të kredisë, edhe nëse kjo periudhë zgjat përtej periudhës maksimale kontraktuale. Kjo për shkak se aftësia kontraktuale për të kërkuar ripagimin dhe anulimin e angazhimit të pasfrytëzuar nuk kufizon ekspozimin ndaj humbjeve kreditorë në një periudhë njoftimi të tillë kontraktuale.

**Aktivitetet financiare - shlyerja.** Aktivitetet financiare shlyhen tërësisht ose pjesërisht sipas falimentimit dhe mbulimit të kolateralit siç rregullohet me rregulloren lokale. Nga ana tjetër, kur Banka ka konsumuar të gjitha përpjekjet e rimëkëmbjes dhe ka arritur në përfundimin se nuk ka shpresa të arsyeshme për rimëkëmbjen, ajo mund të vendosë të shlyejë një aktiv para datës së caktuar sipas kërkesave lokale.

**Çregjistrimi i aktiveve financiare.** Banka çregjistron aktivitetet financiare kur (a) aktivitetet janë paguar ose të drejtat për flukset e mjeteve monetare nga aktivitetet kanë skaduar ose (b) Banka ka transferuar të drejtat në flukset e mjeteve monetare nga aktivitetet financiare ose ka hyrë në një marrëveshje kalimtare përderisa (i) gjithashtu transferon në thelb të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë së aktiveve ose (ii) as nuk transferon as nuk mbanë në thelb të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë, por nuk mbanë kontrollin. Kontrolli ruhet në qoftë se pala tjetër nuk ka aftësinë praktike për të shitur aktivin në tërësinë e tij për një palë të tretë të palidhur pa pasur nevojë të vendosë kufizime për shitjen.

### **Aktivitetet financiare - modifikimi.**

Banka ndonjëherë rinegocon ose modifikon kushtet kontraktuale të aktiveve financiare. Banka vlerëson nëse modifikimi i flukseve monetare kontraktuale është i konsiderueshëm duke marrë parasysh, ndër të tjera, faktorët e mëposhtëm: çdo term të ri kontraktual që ndikon në mënyrë të konsiderueshme profilin e rrezikut të normës së interesit të aktivitetit, kolateralin e ri ose përmirësimin kreditor që ndikon ndjeshëm në rrezikun kreditor që lidhet me aktivin ose zgjatjen e konsiderueshme të një kredie kur kredimarrësi nuk është në vështirësi financiare. Nëse kushtet e modifikuara janë në thelb të ndryshme, të drejtat për flukset e mjeteve monetare nga aktivi origjinal skadojnë dhe Banka çregjistron aktivin financiar fillestar dhe njeh një aktiv të ri me vlerën e tij të drejtë. Data e rinegocimit konsiderohet si data e njohjes fillestare për qëllimet e llogaritjes së zhvlerësimit pasues, duke përfshirë përcaktimin nëse ka ndodhur një SICR. Banka gjithashtu vlerëson nëse kredia e re ose instrumenti i borxhit plotëson kriterin e SPPI.

Çdo diferencë midis vlerës kontabël neto të aktivitetit origjinal të çregjistruar dhe vlerës së drejtë të aktivitetit të ri të modifikuar thelbësisht, njihet në fitim ose humbje, përveç nëse përmbajtja e diferencës i atribuohet një transaksioni kapital me pronarët. Në një situatë ku rinegocimi ishte nxitur nga vështirësitë financiare të palës tjetër dhe pamundësia për të bërë pagesat e rena dakord fillimisht, Banka krahason flukset monetare të pritshme origjinale dhe të rishikuara për të vlerësuar nëse rreziqet dhe përfitimet e aktivitetit janë në thelb të ndryshme si rezultat i modifikimit kontraktual. Nëse rreziqet dhe përfitimet nuk ndryshojnë, aktivi i modifikuar nuk është në thelb i ndryshëm nga aktivi origjinal dhe modifikimi nuk rezulton në mosnjohje.

(Të gjitha shumat janë shprehur në mijë euro, përveç kur specifikohet ndryshe)

## **2. Politikat e rëndësishme kontabël (vazhdim)**

### **Instrumentet financiare - Termat kyçe të matjes (vazhdim)**

Banka rilogarit vlerën kontabël bruto duke skontuar flukset monetare kontraktuale të modifikuara me normën fillestare të interesit efektiv (ose normën efektive të interesit të rregulluar për kredinë për aktivet financiare 'POCI') dhe njeh një fitim ose humbje modifikimi në pasqyrën e fitimit ose humbjes.

**Detyrimet financiare - kategoritë e matjes.** Detyrimet financiare klasifikohen si të matura më pas në kosto te amortizuar (AC), përveç (i) detyrimeve financiare në FVTPL: ky klasifikim zbatohet për instrumentet derivative, detyrimet financiare të mbajtura për tregtim (p.sh. pozicionet e shkurtra në letra me vlerë), vlerat kontingjente të njohura nga një blerës në një kombinim biznesi dhe detyrime të tjera financiare të përcaktuara si të tilla në njohjen fillestare dhe (ii) kontratat e garancioneve financiare dhe angazhimet kreditore.

**Detyrimet financiare – shlyerja.** Detyrimet financiare shlyhen kur ato shuhen (kur detyrimi i specifikuar në kontratë përfundon, anulohet ose skadon).

Një shkëmbim ndërmjet Bankës dhe huadhënësve të saj të instrumenteve të borxhit me terma shumë të ndryshëm, si dhe modifikime thelbësore të afateve dhe kushteve të detyrimeve financiare ekzistuese, trajtohet si shlyerje e detyrimit financiar fillestar dhe njohja e një detyrimi të ri financiar. Kushtet janë thelbësisht të ndryshme në qoftë se vlera aktuale e flukseve të mjeteve monetare sipas kushteve të reja, duke përfshirë çdo pagesë të paguar neto nga çdo tarifë e marrë dhe zbritur duke përdorur normën fillestare të interesit efektiv, është të paktën 10% ndryshe nga vlera aktuale e skontuar e flukseve monetare të mbetura të detyrimit financiar fillestar. Nëse një shkëmbim i instrumenteve të borxhit ose modifikimi i afateve llogaritet si shlyerje, çdo shpenzim ose tarifë e shkaktuar njihet si pjesë e fitimit ose humbjes në shlyerje. Nëse shkëmbimi ose modifikimi nuk llogaritet si shlyerje, çdo shpenzim ose tarifë e shkaktuar rregullon vlerën kontabël të detyrimit dhe amortizohet gjatë afatit të mbetur të detyrimit të modifikuar.

Ndryshimet e detyrimeve që nuk rezultojnë në shlyerje llogariten si një ndryshim në vlerësim duke përdorur një metodë kumulative kapëse, me çfarëdo fitimi ose humbjeje të njohur në pasqyrën e fitimit ose humbjes, përveç nëse përmbajtja ekonomike e diferencës në vlerat bartëse i atribuohet një transaksioni kapital me pronarët.

**Paraja dhe ekuivalentët e saj.** Paraja dhe ekuivalentët e saj janë aktivet monetare që janë lehtësisht të konvertueshëm në shuma të njohura të parasë dhe të cilat janë subjekt i një rreziku të papërfillshëm të ndryshimeve në vlerë. Paraja dhe ekuivalentët e saj përfshijnë të gjitha paratë e gatshme, plasmanet ndërbankare dhe depozitat e detyrueshme të rezervave me BQK-në, me maturime origjinale më pak se tre muaj. Fondet e kufizuara për një periudhë më të gjatë se tre muaj janë të përjashtuara nga paraja dhe ekuivalentët e saj. Paraja dhe ekuivalentët e saj mbarten në kosto të amortizuar sepse: (i) mbahen për grumbullimin e flukseve monetare kontraktuale dhe ato flukse monetare përfaqësojnë SPPI dhe (ii) nuk maten në FVTPL. Karakteristikat e mandatuara vetëm nga legjislacioni, siç është legjislacioni "bail-in në vende të caktuara, nuk kanë ndikim në testin e SPPI, përveç nëse ato janë të përfshira në terma kontraktuale në mënyrë që elementi të zbatohet edhe nëse legjislacioni më vonë ndryshohet.

Pagesat ose arkëtimet e paraqitura në pasqyrën e flukseve të mjeteve monetare përfaqësojnë transferet e parave dhe ekuivalentëve të saj nga Banka, duke përfshirë shumat e ngarkuara ose të kredituara në llogaritë rrjedhëse të palëve të Bankës që mbahen në Bankë, siç janë të ardhurat nga interesi i kreditë ose principali i mbledhur duke e ngarkuar llogarinë rrjedhëse të klientit ose pagesat e interesit ose disbursimi i kreditë të kredituara në llogarinë rrjedhëse të klientit, që paraqet para dhe ekuivalent të saj nga perspektiva e klientit.

**Gjendja e detyrueshme e parasë së gatshme me BQK-në.** Gjendjet e detyrueshme të parasë së gatshme me BQK-në mbahen në kosto të amortizuar dhe përfaqësojnë depozita rezervë të detyrueshme të cilat nuk gjenerojnë interes dhe të cilat nuk janë në dispozicion për të financuar operacionet e përditshme të Bankës dhe kështu nuk konsiderohen si pjesë e parave dhe ekuivalentëve të saj për qëllimet e përgatitjes së pasqyrës së rrjedhës së parasë.

**Kreditë dhe paradhëniet për bankat** Shumat e arkëtueshme nga bankat e tjera regjistrohen kur Banka i jep para bankave të tjera, pa qëllim të tregtimit të të arkëtueshmeve jo derivative të pakuotuara, të cilat janë të arkëtueshme në data të caktuara ose të përcaktueshme. Kreditë dhe paradhëniet për bankat mbahen në AC kur: (i) ato mbahen për qëllime të grumbullimit të flukseve monetare kontraktuale dhe ato flukse monetare përfaqësojnë SPPI dhe (ii) ato nuk maten në FVTPL.

## **2. Politikat e rëndësishme kontabël (vazhdim)**

### **Instrumentet financiare - Termat kyçe të matjes (vazhdim)**

**Investimet në letrat me vlerë.** Bazuar në modelin e biznesit dhe karakteristikat e rrjedhës së parasë, Banka klasifikon investimet në letrat me vlerë si të mbajtura në AC, FVOCI ose FVTPL. Letrat me vlerë mbahen në kosto te amortizuar (AC) nëse ato mbahen për grumbullimin e flukseve të mjeteve monetare kontraktuale dhe kur këto flukse të mjeteve monetare përfaqësojnë SPPI dhe nëse ato nuk janë të maten vullnetarisht në FVTPL, në mënyrë që të reduktohet ndjeshëm mospërputhja kontabël. Letrat me vlerë mbahen në FVOCI nëse ato mbahen për grumbullimin e flukseve monetare kontraktuale dhe për shitje, ku ato flukse monetare përfaqësojnë SPPI dhe nëse ato nuk janë të përcaktuara në

(Të gjitha shumat janë shprehur në mijë euro, përveç kur specifikohet ndryshe)

## **2. Politikat e rëndësishme kontabël (vazhdim)**

FVTPL. Të ardhurat nga këto aktive janë llogaritur duke përdorur metodën e interesit efektiv dhe të njohur në fitim ose humbje.

Një provizion për zhvlerësim të kredive i matur duke përdorur modelin e humbjeve të pritshme kreditore njihet në pasqyrën e fitimit ose humbjes për vitin. Të gjitha ndryshimet e tjera në vlerën bartëse njihen në të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse (OCI). Kur investimet në letra me vlerë çregjistrohen, fitimi ose humbja kumulative e njohur më parë në OCI është riklasifikuar nga OCI në fitim ose humbje.

Investimet në letrat me vlerë mbahen në FVTPL nëse ato nuk i plotësojnë kriteret për tu mbajtur në AC ose FVOCI. Banka gjithashtu mund të përcaktojë në mënyrë të pakthyeshme investimet në letrat me vlerë në FVTPL në njohjen fillestare nëse zbatimi i këtij opsioni zvogëlon ndjeshëm një mospërputhje kontabël mes aktiveve dhe detyrimeve financiare që njihen ose maten në baza të ndryshme të kontabilitetit

**Kreditë dhe paradhënie për klientët.** Kreditë dhe paradhëniet për klientët regjistrohen kur Banka jep para për të blerë ose origjinuar një kredi që i takon një klienti. Bazuar në modelin e biznesit dhe karakteristikat e flukseve të mjeteve monetare, Banka klasifikon kreditë dhe paradhëniet për klientët në njërën nga kategoritë e mëposhtme të matjes: (i) Kreditë që mbahen për grumbullimin e flukseve monetare kontraktuale dhe ato flukse monetare përfaqësojnë SPPI dhe kreditë që nuk janë të përcaktuar vullnetarisht në FVTPL dhe (ii) FVTPL: kreditë që nuk përmbushin testin SPPI ose kriteret të tjera për AC ose FVOCI maten në FVTPL.

**Angazhimet e lidhura me kredinë.** Banka lëshon garancionë financiare dhe angazhime për të dhënë kredi. Këto angazhime fillimisht njihen me vlerën e tyre të drejtë, gjë që normalisht evidentohet nga shuma e tarifave të pranuar. Kjo shumë amortizohet në mënyrë lineare gjatë jetës së angazhimit, me përjashtim të angazhimeve për të leshu kredi të reja, nëse është e mundur që Banka do të hyjë në një marrëveshje specifike të kredisë dhe nuk pret të shesë kredinë që rezulton menjëherë pas origjinimit; tarifat e angazhimeve të kredisë janë shtyrë dhe përfshihen në vlerën kontabël të kredisë në njohjen fillestare. Në fund të çdo periudhe raportuese, angazhimet maten në (i) bilancin e mbetur të paamortizuar të shumës në njohjen fillestare, plus (ii) shumën e provizionit për zhvlerësim kreditor të përcaktuar në bazë të modelit të humbjeve të pritshme kreditore, përveç nëse angazhimi është për të siguruar një kredi me një normë interesi më të ulët se norma e tregut, me ç'rast matja bëhet në shumën më të lartë mes këtyre dy shumave. Vlera kontabël e angazhimeve të kredisë përfaqëson një detyrim. Për kontratat që përfshijnë edhe kredi edhe angazhim të pashfrytezuar dhe kur Banka nuk mund të dallojë ndaras ECL në komponentin e pjesës së pashfrytezuar nga komponenti i kredisë, ECL për angazhimin e pashfrytëzuar njihet së bashku me provizionin për humbje kreditore. Për atë që ECL-te e kombinuara tejkalojnë vlerën kontabël bruto të kredisë, ato njihen si detyrim.

**Garancionet financiare.** Garancionet financiare kërkojnë që Banka të bëjë pagesa të caktuara për të rimbursuar mbajtësin e garancisë për një humbje që lind sepse një debitor specifik nuk arrin të bëjë pagesën në kohën e duhur në përputhje me kushtet origjinale ose të modifikuara të një instrumenti borxhi. Garancionet financiare fillimisht njihen me vlerën e tyre të drejtë, e cila normalisht evidentohet nga shuma e tarifave të pranuar. Kjo shumë amortizohet në mënyrë lineare gjatë jetës së garancisë. Në fund të secilës periudhë raportuese, garancionet maten në shumën më të lartë midis (i) shumës së provizionit për humbje kreditore për ekspozimin e garantuar të përcaktuar bazuar në modelin e humbjeve të pritshme dhe (ii) bilanci i mbetur i paamortizuar i shumës në njohjen fillestare. Përveç kësaj, humbjet e pritshme kreditore njihen për tarifat e arkëtueshme që njihen në pasqyrën e pozicionit financiar si një aktiv.

**Garancitë e performancës.** Garancitë e performancës janë kontrata që ofrojnë kompensim nëse një palë tjetër nuk arrin të kryejë një detyrim kontraktual. Kontrata të tilla transferojnë rrezikun jo-financiar të performancës përveç rrezikut të kredisë. Garancitë e performancës fillimisht njihen me vlerën e tyre të drejtë, e cila normalisht evidentohet nga shuma e tarifave të marra.

Kjo shumë amortizohet në mënyrë lineare gjatë jetës së kontratës. Në fund të secilës periudhë raportuese, kontratat e garancisë së ekzekutimit maten në nivelin më të lartë të (i) bilancit të paamortizuar të shumës në njohjen fillestare dhe (ii) vlerësimin më të mirë të shpenzimeve të nevojshme për të zgjidhur kontratën në fund të çdo periudhe raportuese, skontuar në vlerën aktuale. Kur Banka ka të drejtën kontraktuale për t'u kthyer tek klienti i saj për mbulimin e shumave të paguara për të shlyer kontratat e garancisë së ekzekutimit, shuma të tilla do të njihen si kredi dhe të arkëtueshme pas transferimit të kompensimit të humbjes tek përfituesi i garancisë. Këto tarifa njihen brenda të ardhurave nga komisionet dhe tarifat në fitim ose humbje.

**Kolaterali i riposeduar** Kolaterali i riposeduar përfaqëson aktivet jofinanciare të marrura nga Banka në shlyerjen e kredive me ditëvonesa të mëdha. Aktivet fillimisht njihen me vlerën e drejtë në momentin e marrjes dhe përfshihen në pasuri dhe paisje, aktive të tjera financiare, ose inventare brenda aktiveve tjera në varësi të natyrës dhe qëllimeve të Bankës në raport me rimarrjen e këtyre kolateralave, dhe më pas rimaten dhe regjistrohen siapas politikave kontabël për këto kategori aktive. Aktualisht, të gjitha kolaterale të riposeduara përfshihen në inventarët brenda aktiveve të tjera. Më pas, Banka mat kolateralin e riposeduar në

### **Instrumentet financiare - Termat kyçe të matjes (vazhdim)**

*(Të gjitha shumat janë shprehur në mijë euro, përvec kur specifikohet ndryshe)***2. Politikat e rëndësishme kontabël (vazhdim)**

nivelin më të ulët midis kostos (shuma e njohur fillimisht) dhe vlerës së drejtë minus kostot për shitje. Kolaterali i riposeduar shlyhet në rast se nuk rishitet nga Banka brenda 5 viteve nga riposedimi. Pasuri e luajtshme nuk njihet si një aktiv kur riposedohet. Çdo humbje që vjen si rezultat i rivlerësimit të mësipërm regjistrohet në fitim ose humbje dhe mund të kthehet në të ardhmen. Fitimet ose humbjet nga shitja e këtyre aktiveve njihen në fitimin ose humbje.

**Kompensimi** Aktivet dhe detyrimet financiare kompensohen dhe shuma neto paraqitet në pasqyrën e pozicionit financiar atëherë dhe vetëm atëherë kur banka ka të drejtën ligjore për t'i kompensuar shumat dhe ajo synon ose t'i shlyejë ato në një bazë neto, ose ta realizojë aktivin dhe ta shlyejë detyrimin njëkohësisht. E drejta e kompensimit (a) nuk duhet të jetë e kushtëzuar nga një ngjarje e ardhshme dhe (b) duhet të jetë ligjërisht e zbatueshme në të gjitha rrethanat e mëposhtme: (i) në rrjedhën normale të biznesit, (ii) rastet e mospagimit dhe (iii) rastet e mungesës së aftësisë paguese ose falimentimit.

**Pasuri dhe pajisje**

Pasuri dhe pajisjet shprehen me kosto minus zhvlerësimin e akumuluar dhe humbjen e akumuluar të renies në vlerë, kur kërkohet. Kostoja historike përfshin shpenzimet që i atribuohen drejtpërdrejt blerjes së artikujve të pronës dhe pajisjeve.

Shpenzimet pasuese përfshihen në vlerën kontabël të aktivit ose njihen si një aktiv i veçantë, sipas rastit, vetëm kur është e mundur që përfitimet e ardhshme ekonomike të lidhura me artikullin do të rrjedhin në Bankë dhe kostoja e artikullit mund të matet në mënyrë të besueshme. Të gjitha riparimet dhe mirëmbajtjet e tjera i ngarkohen shpenzimeve të tjera operative gjatë periudhës financiare në të cilën ato janë kryer.

Çdo vit, Banka vlerëson nëse ka indikacione se aktivet mund të kenë rënie në vlerë. Nëse ekzistojnë indikacione të tilla, vlerësohen shumat e rikuperueshme. Shuma e rikuperueshme e vlerësuar është vlera më e lartë e vlerës së drejtë të një aktivi, minus kostot e shitjes dhe vlera e tij në përdorim. Kur vlera kontabël e një aktivi është më e madhe se shumta e rikuperueshme e vlerës së saj, vlera do të zvogëlohet deri në shumën e rikuperueshme dhe diferenca ngarkohet në fitim ose humbje.

Fitimet dhe humbjet nga shitja e pronës dhe pajisjeve përcaktohen duke iu referuar vlerës së tyre kontabël dhe merren parasysh gjatë përcaktimit të rezultatit operativ të periudhës. Kostot e riparimit dhe të mirëmbajtjes janë të ngarkuara në fitimin ose humbjen e vitit kur shpenzimet janë kryer.

Toka dhe ndërtimet në vazhdim nuk zhvlerësohen. Zhvlerësimi për zërat e tjerë të pronës dhe pajisjeve është njohur në fitim ose humbje duke përdorur metodën lineare për të alokuar koston e tyre gjatë jetës së tyre të dobishme të vlerësuar. Normat vjetore të amortizimit përcaktohen nga jetëgjatësia e vlerësuar e aktiveve të caktuara siç paraqitet më poshtë:

<b>Kategoria e aktivit</b>	<b>Jetëgjatësia</b>
Përmirësimet në objektet me qira	5 vite apo kohëgjatësia e qirasë, cilado që është më e shkurtër
Mobilje, instalime dhe pajisje	3-5 vite
Kompjuterë dhe pajisje të ngjashme	3-5 vite
Automjetet motorike	5 vite

**Aktivët e patrupëzuara**

Aktivët e patrupëzuara njihen nëse është e mundur që përfitimet ekonomike të ardhshme që i atribuohen aktivitetit do të rrjedhin në Bankë dhe kostoja e aktivitetit mund të matet në mënyrë të besueshme. Aktivët e patrupëzuara maten fillimisht me kosto. Vlera bartëse e aktiveve të patrupëzuara shqyrtohet për rënie në vlerë kur ngjarjet ose ndryshimet në rrethanat tregojnë se vlera bartëse mund të mos jetë e rikuperueshme. Aktivët e patrupëzuara përbëhen tërësisht nga softueri kompjuterik dhe licencat, të amortizuara duke përdorur metodën lineare gjatë jetës së tyre të dobishme të vlerësuar deri në pesë vite. Të gjitha shpenzimet e tjera që lidhen me programet kompjuterike, p.sh. mirëmbajtjen e saj, shpenzohen kur ndodhin.

**Zhvlerësimi i aktiveve jo financiare**

Humbja nga zhvlerësimi njihet sa herë që vlera bartëse e një aktivi tejkalon shumën e rikuperueshme. Shuma e rikuperueshme e një aktivi është shumta më e lartë në mes të vlerës së drejtë minus kostot e shitjes dhe vlerës në përdorim. Vlera në përdorim e një aktivi është vlera aktuale e flukseve monetare të parashikuara që priten nga përdorimi i vazhdueshëm i një aktivi dhe nga nxjerrja e tij jashtë përdorimit.

*(Të gjitha shumat janë shprehur në mijë euro, përveç kur specifikohet ndryshe)*

## **2. Politikat e rëndësishme kontabël (vazhdim)**

### **Detyrimet ndaj bankave të tjera dhe llogarive të klientëve**

**Detyrimet ndaj bankave të tjera.** Detyrimet ndaj bankave të tjera regjistrohen kur paratë ose aktivet e tjera nga bankat e treta i janë dhënë Bankës. Detyrimi jo-derivativ mbartet me koston e amortizuar. Nëse Banka blen borxhin e vet, atëherë detyrimi hiqet nga pasqyrat e pozicionit financiar, diferenca midis vlerës së bartur të detyrimit dhe shumës së paguar përfshihet në fitimet ose humbjet që rrjedhin nga shlyerja e borxhit.

**Llogaritë e klientëve.** Llogaritë e klientëve janë detyrime jo-derivative ndaj individëve, shtetit ose korporatave dhe mbahen me kosto të amortizuar.

**Fondet e tjera të huazuara.** Fondet e tjera të huazuara përfshijnë kreditë e marra nga Banka Europianë për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH). Fondet e huazuara mbahen me kosto të amortizuar.

**Borxhi i varur.** Borxhi i varur mund të paguhet vetëm në rast të likuidimit pasi të jenë plotësuar kërkesat e kreditorëve të tjerë me prioritet më të lartë. Borxhi i varur mbahet me kosto të amortizuar.

**Instrumentet financiare derivative.** Instrumentet financiare derivative, duke përfshirë instrumentet në valutë të huaj dhe këmbimet, mbarten me vlerën e tyre të drejtë. Të gjithë instrumentet derivative mbahen si aktive kur vlera e drejtë është pozitive dhe si detyrime kur vlera e drejtë është negative. Ndryshimet në vlerën e drejtë të instrumentave derivative përfshihen në fitimin ose humbjen për vitin (fitimet minus humbjet mbi derivativët). Banka nuk zbaton kontabilitetin mbrojtës. Disa instrumente derivative të përfshira në detyrimet financiare dhe kontratat e tjera jofinanciare trajtohen si instrumente të veçanta derivative kur rreziqet dhe karakteristikat e tyre nuk janë të lidhura ngushtë me ato të kontratës bazë.

### **Tatimet**

Shpenzimet e tatimit mbi të ardhurat e korporatave përfshijnë tatimin aktual dhe të shtyrë. Tatimi mbi të ardhurat e korporatave njihet në fitim ose humbje, përveç nëse ka të bëjë me zërat e njohur drejtpërdrejtë në kapital ose në të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse.

#### **(i) Tatimi aktual**

Tatimi aktual përbëhet nga tatimi i pritshëm i pagueshëm ose i arkëtueshëm mbi të ardhurat ose humbjen e tatueshme për vitin dhe çdo rregullim në tatimin e pagueshëm ose të arkëtueshëm në lidhje me vitet e mëparshme. Ai matet duke përdorur normat e miratuara të taksave ose të miratuara në mënyrë thelbesore në datën e raportimit.

#### **(ii) Tatimi i shtyrë**

Tatimi i shtyrë njihet në përputhje me diferencat e përkohshme ndërmjet vlerës së bartur të aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe vlerave për qëllime tatimore.

Tatimi i shtyrë nuk njihet në rastet kur diferencat e përkohshme vijnë si rezultat i njohjes fillestare të një aktivi apo detyrimi që nuk ka të bëjë me një kombinim biznesi, dhe kur kryhet transaksioni ai nuk ndikon as fitimin kontabël dhe as fitimin apo humbjen tatimore. Aktivet tatimore të shtyra njihen për humbjet tatimore të papërdorura, kreditimet tatimore të papërdorura dhe diferencat e përkohshme të zbritshme deri në masën që fitimet e tatueshme të ardhshme mund të përdoren kundrejt tyre.

### **Tatimet (vazhdim)**

Aktivtë tatimore të shtyra rishikohen në çdo datë të raportimit dhe reduktohen në masën që nuk është më e mundur që përfitimi tatimor përkatës të realizohet. Tatimi i shtyrë matet me normat tatimore që pritet të zbatohen ndaj diferencave të përkohshme kur ato kthehen, duke përdorur normat tatimore të miratuara ose të nxjerra në mënyrë thelbesore në datën e raportimit.

Aktivtë dhe detyrimet tatimore të shtyra kompensohen nëse ekziston e drejta ligjore e zbatueshme për kompensimin të detyrimeve dhe aktiveve tatimore aktuale, dhe ato lidhen me tatimet e vendosura nga i njëjti autoritet tatimor ndaj të njëjtës njësi ekonomike të tatueshme, që ka për qëllim pagesën e detyrimeve dhe aktiveve tatimore aktuale në baza neto ose kur aktivtë dhe detyrimet tatimore do të realizohen në të njëjtën kohë.

#### **(iii) Ekspozimet tatimore**

Në përcaktimin e shumës së tatimit aktual dhe të shtyrë, Banka konsideron ndikimin e ekspozimeve tatimore, duke përfshirë nëse tatimet dhe interesat shtesë mund të jenë të detyrueshme. Ky vlerësim mbështetet në përafrim dhe supozim, gjithashtu mund të përfshijë një seri gjykimesh mbi ngjarjet e ardhshme. Në dispozicion mund të jetë informacion i ri i cili mund të ndikoj që Banka të ndryshoj vendimin e saj në lidhje me përshtatshmërinë e detyrimeve tatimore ekzistuese; ndryshime të tilla në detyrimet tatimore do të ndikojnë në shpenzimet tatimore në periudhën në të cilën bëhet një përcaktim i tillë.

### **Provizionet për detyrimet dhe ngarkesat**

Provizionet për detyrimet dhe ngarkesat janë detyrime jofinanciare me kohë ose shuma të pasigurta. Një provizion njihet nëse, si rezultat i ngjarjes së kaluar, Banka ka një detyrim aktual ose konstruktiv që mund të vlerësohet me

*(Të gjitha shumat janë shprehur në mijë euro, përveç kur specifikohet ndryshe)*

## **2. Politikat e rëndësishme kontabël (vazhdim)**

besueshmëri dhe është e mundur që një dalje e përfitimeve ekonomike të kërkohej për të shlyer detyrimin. Provizionet maten sipas vlerësimit më të mirë të menaxhmentit lidhur me shpenzimet e kërkuara për të shlyer detyrimin dhe zbriten në vlerën aktuale kur një efekt i tillë është material.

Tarifat, të tilla si tatimet përveç tatimit mbi të ardhurat e korporatave ose tarifat rregullatore të bazuara në informacionet që kanë të bëjnë me një periudhë para lindjes së detyrimit për të paguar, njihen si detyrime kur ndodh ngjarja obliguese që shkakton pagesën e detyrimit, siç përcaktohet nga legjislacioni në të cilin përcaktohet obligimi për të paguar detyrimin. Nëse një pagesë kryhet para ngjarjes detyruese, ajo njihet si parapagim.

### **Përfitimet e punonjësve**

Banka paguan kontributet e detyrueshme për planin e pensioneve të administruar në mënyrë publike. Banka nuk ka detyrime të mëtejshme të pagesës pasi të jenë paguar kontributet. Kontributet njihen si shpenzime për përfitimet e punonjësve kur ato janë për t'u paguar.

### **Qiratë operative**

Pagesat e bëra për qiratë operative njihen si shpenzime në menyrë lineare përgjatë periudhës së qirasë. Kur një qira operative përfundon para skadimit të afatit të qirasë, çdo penalitet që kërkohej t'i paguhet qiradhënësit, njihet si një shpenzim në periudhën në të cilën kryhet ndërprerja.

### **Të pagueshme dhe të tjera të pagueshme**

Të pagueshmet përlllogariten, kur pala tjetër ka kryer obligimet përkatëse sipas kontratës dhe mbahen me koston e amortizuar.

### **Kapitali aksionar**

Aksionet e zakonshme klasifikohen si kapital. Kostot rritëse që i atribuohen drejtpërdrejtë emetimit të aksioneve të reja janë paraqitur në kapital si zbritje, neto nga tatimi. Çdo tejkalim i vlerës së drejtë të shumës së marrë mbi vlerën nominale të aksioneve të emetuara shënohet si prim për aksion në kapital.

### **Dividendi**

Dividendi regjistrohet në kapital në periudhën në të cilën është deklaruar. Çdo dividend i deklaruar pas përfundimit të periudhës raportuese dhe para se pasqyrat financiare të autorizohen për t'u lëshuar, shpalojnë në shënimet e ngjarjeve pasuese. Raportimet financiare të bankës për qëllime statutorë shërbejnë si bazë për shpërndarjen e fitimit dhe ndarjeve të tjera. Legjislacioni i Kosovës identifikon bazën e shpërndarjes si fitimi neto për vitin aktual.

### **Konvertimet në monedhë të huaj**

Monedha funksionale Bankës është Euro. Euro është monedha në të cilën transaksionet janë të shprehura në mjedisin ekonomik në Republikën e Kosovës. Aktivitetet dhe detyrimet monetare përkthehen në monedhën funksionale me kursin zyrtar të këmbimit të Bankës Qendrore të Kosovës në fund të periudhës raportuese përkatëse. Fitimet dhe humbjet valutore që rezultojnë nga shlyerja e transaksioneve dhe nga përkthimi i mjeteve dhe detyrimeve monetare në monedhën funksionale me kurset zyrtare të këmbimit të BQK-së në fund të vitit, njihen në fitim ose humbje për vitin (si fitim nga përkthimi në valutë minus humbje). Përkthimi në fund të vitit nuk aplikohet për artikujt jo-monetarë që maten me kosto historike. Zërat jo-monetarë të matura me vlerën e drejtë në një monedhë të huaj, janë përkthyer duke përdorur kursin e këmbimit në datën kur është përcaktuar vlera e drejtë. Efektet e ndryshimeve të kursit të këmbimit në zërat jo-monetarë të matura me vlerën e drejtë në një monedhë të huaj regjistrohen si pjesë e fitimit ose humbjes në vlerën e drejtë.

## **3. Vlerësimet dhe gjykimet kritike të kontabilitetit në zbatimin e politikave kontabël**

Banka kryen vlerësime dhe gjykime që ndikojnë në shumat e njohura në pasqyrat financiare dhe vlerat kontabël të aktiveve dhe detyrimeve brenda vitit të ardhshëm financiar. Vlerësimet dhe gjykimet vlerësohen vazhdimisht dhe bazohen në përvojën e menaxhmentit dhe në faktorë të tjerë, duke përfshirë pritjet e ngjarjeve të ardhshme që besohet të jenë të arsyeshme bazuar në rrethanat e caktuara. Menaxhmenti gjithashtu kryen gjykime të caktuara, përveç atyre që përfshijnë vlerësime, në procesin e zbatimit të politikave kontabël. Gjykimet që kanë efektin më të rëndësishëm në shumat e njohura në pasqyrat financiare dhe vlerësimet që mund të shkaktojnë një rregullim domethënës në vlerën kontabël të aktiveve dhe detyrimeve brenda vitit të ardhshëm financiar përfshijnë:

*(Të gjitha shumat janë shprehur në mijë euro, përveç kur specifikohet ndryshe)*

### **3. Vlerësimet dhe gjykimet kritike të kontabilitetit në zbatimin e politikave kontabël (vazhdim)**

**Matja e humbjeve të pritshme kreditore (ECL)** Matja e ECL është një vlerësim i rëndësishëm që përfshin përcaktimin e metodologjisë, modeleve dhe inputeve të të dhënave. Detajet e metodologjisë së matjes së ECL janë paraqitur në Shënimin 29. Komponentet e mëposhtëm kanë ndikim kryesor në llogaritjen e provizionit për humbjet kreditore: përkufizimi i dështimit, kriteret për "Rritjen e Konsiderueshme të Rrezikut të Kredisë (SICR)", probabiliteti i dështimit ("PD"), ekspozimi në dështim ("EAD") dhe humbja e dhënë nga dështimi ("LGD"), si dhe modelet e skenarëve makroekonomikë. Banka rregullisht rishikon dhe validon modelet dhe inputet e modeleve për të zvogëluar çdo dallim midis vlerësimeve të pritshme të humbjeve kreditore dhe përvojës aktuale të ketyre humbjeve.

Deri tani, Banka nuk ka integruar ndonjë informacion të ardhshëm për matjen e ECL, kryesisht për shkak të korrelacionit të dobët midis normave të dështimit dhe treguesve makroekonomikë. Duke pasur parasysh mungesën e dukshme të korrelacionit kuptimplotë ndërmjet normave të dështimit dhe treguesve makroekonomikë në dispozicion për Kosovën, Menaxhmenti nuk beson se ka ndonjë ndikim të rëndësishëm dhe të dukshëm të informacionit të ardhshëm në shumën e Humbjeve të Pritshme të Kreditore më 31 Dhjetor 2018. Megjithatë, banka do të analizojë informacionet e ardhshme, në baza vjetore, dhe në rast se ka ndonjë korrelacion të fortë të treguesve kryesorë makroekonomikë me nivelin e ECL ajo do të integrojë ato variabla në modelin e saj në përputhje me rrethanat përkatëse.

**Ekspozimi i kredisë në ekspozimet kreditore kthyesë (p.sh. kreditkartela, paradhëniet).** Për aktive të tilla, Banka aplikon maturim dymbëdhjetë mujor dhe me pas zbaton ECL. Bazuar në procedurat e brendshme të bankës, produkte të tilla vlerësohen në baza vjetore pas një vlerësimi të hollesishëm të rrezikut të kredisë. Një rritje ose ulje prej 10% në vlerësimet e PD më 31 Dhjetor 2018 do të rezultojë në një rritje ose ulje në totalin e humbjeve të pritura kreditore 753 mijë Euro. Një rritje ose ulje prej 10% në vlerësimet e LGD më 31 dhjetor 2018 do të rezultojë në një rritje ose ulje në totalin e humbjeve të pritura kreditore 933 mijë Euro. Rritja ose zvogëlimi me 10% i humbjeve kreditore të kaluara, në bazë të të cilave humbjet e ndodhura kreditore janë llogaritur me 31 dhjetor 2017 do të rezultojë në një rritje ose ulje të provizionit për humbje kreditore 210 mijë euro në atë datë.

**Rritja e konsiderueshme e rrezikut të kredisë ("SICR").** Për të përcaktuar nëse ka pasur një rritje të konsiderueshme të rrezikut të kredisë, përveç kriterëve të përcaktimit të fazave në bazë të ditë vonesave, Banka do të përdorë kriterë të tjera cilësore, të përkufizuara nga banka për të përcaktuar se çfarë duhet të konsiderohet si një rritje e konsiderueshme e rrezikut të kredisë dhe kështu krahason jetëgjatësinë relative midis rrezikut të dështimit në çdo datë të vëzhgimit me dështimin përgjatë jetëgjatësisë nga data e fillimit. Nëse që nga njohja fillestare ka një rritje të konsiderueshme të rrezikut kreditore të identifikuar, instrumenti financiar kalon në Fazën 2, por ende nuk konsiderohet të jetë i zhvërlësuar dhe humbjet kreditore bazohen në humbjet e pritshme kreditore përgjatë jetëgjatësisë së instrumentit. Nëse një instrument financiar është i zhvërlësuar, instrumenti financiar zhvendoset në Fazën 3 dhe llogaritja e humbjeve kreditore bazohet në humbjet e pritshme kreditore përgjatë jetëgjatësisë së instrumentit. Nëse ka dëshmi se kriteret 'SICR' nuk plotësohen në vijim, instrumenti kthehet prapa në Fazën 1. Nëse një ekspozim është transferuar në Fazën 2 bazuar në një tregues cilësor, Banka monitoron nëse ky tregues vazhdon të ekzistojë ose ka ndryshuar.

Nëse ECL e 5% të kredive dhe paradhënieve për klientët që aktualisht janë në fazën 1 dhe maten me ECL 12-mujore do të mateshin me ECL përgjatë jetëgjatësisë, shumata e lejuar e humbjeve kreditore do të rritej me rreth 1,198 mijë euro më 31 dhjetor 2018 (1 janar 2018: rritje rreth 1,192 mijë euro).

**Vlerësimi i modelit të biznesit.** Modeli i biznesit e përcakton klasifikimin e aktiveve financiare. Menaxhmenti aplikoi gjykim në përcaktimin e nivelit të agregimit dhe të portofoleve të instrumenteve financiare gjatë kryerjes së vlerësimit të modelit të biznesit. Gjatë vlerësimit të transaksioneve të shitjeve, Banka merr parasysh frekuencën, kohën dhe vlerën e tyre historike, arsyet për shitjet dhe pritjet për aktivitetin e shitjeve të ardhshme. Transaksionet e shitjeve që kanë për qëllim minimizimin e humbjeve të mundshme për shkak të përkeqësimit të kredisë konsiderohen konsistente me modelin e biznesit "të mbajtura për t'u arkëtuar". Shitjet e tjera para maturimit, që nuk lidhen me aktivitetet e administrimit të rrezikut të kredisë, janë gjithashtu në përputhje me modelin e biznesit "të mbajtura për t'u arkëtuar", me kusht që ato të jenë të rralla ose të parëndësishme në vlerë, si individualisht ashtu dhe në tërësi. Banka vlerëson rëndësinë e transaksioneve të shitjes duke krahasuar vlerën e shitjeve me vlerën e portofolit që i nënshtrohet vlerësimit të modelit të biznesit mbi jetëgjatësinë mesatare të portofolit. Përveç kësaj, nëse shitja e aktivitetit financiar që pritet të ndodh vetëm në 'skenarin e rasteve të stresit' ose në përgjigje të një ngjarjeje të izoluar që është jashtë kontrollit të Bankës, nuk është e përsëritur dhe nuk mund të ketë qenë parashikuar nga Banka, konsiderohet si e rastësishme ndaj objektivit të modelit të biznesit dhe nuk ndikon në klasifikimin e aktiveve financiare përkatëse.

Modeli i biznesit për aktivitet "e mbajtura për t'u arkëtuar dhe shitur" nënkupton që aktivitetet mbahen për të mbledhur flukset e mjeteve monetare, por shitja është gjithashtu shumë e rëndësishme për arritjen e objektivit të modelit të biznesit, siç janë menaxhimi i nevojave të likuiditetit, arritja e një rendimenti të caktuar ose përputhja e kohëzgjatjes së aktiveve financiare me kohëzgjatjen e detyrimeve që financojnë ato aktive.

(Të gjitha shumat janë shprehur në mijë euro, përveç kur specifikohet ndryshe)

### **3. Vlerësimet dhe gjykimet kritike të kontabilitetit në zbatimin e politikave kontabël (vazhdim)**

Kategoria e mbetur përfshin ato portofole të aktiveve financiare, të cilat menaxhohen me qëllim të realizimit të flukseve monetare kryesisht nëpërmjet shitjes, si p.sh. kur ekziston një model i tregtimit. Mbledhja e flukseve kontraktuale të parasë shpesh është e rastësishme për këtë model biznesi.

Me kalimin në SNRF 9, Banka ka identifikuar letrat me vlerë të gatshme për shitje (AFS) si një portofol likuiditeti dhe i ka klasifikuar si aktive të mbajtura për tu arkëtuar dhe shitur. Banka vlerësoi se portofoli i saj i kredive hipotekare i plotëson kriteret e modelit të biznesit të mbajtur për tu arkëtuar

**Vlerësimi nëse flukset e mjeteve monetare janë vetëm pagesa të principalit dhe interesit ("SPPI").** Përcaktimi nëse flukset e mjeteve monetare të një aktivi financiar janë vetëm pagesa të principalit dhe interesit kërkon gjykim. Vlera në kohë e parasë mund të modifikohet, për shembull, nëse një normë kontraktuale interesi rikthehet periodikisht, por frekuenca e asaj rivendosjeje nuk përputhet me normën bazë të interesit të instrumentit të borxhit, siç është rasti për shembull kur një kredi paguan normë tre mujore ndërbankare të interesit por norma rivendoset çdo muaj. Efekti i vlerës së modifikuar në kohë të parasë është vlerësuar duke krahasuar flukset monetare të instrumentit përkatës kundrejt instrumentit të borxhit referues me flukset e mjeteve monetare të SPPI, në çdo periudhë dhe në mënyrë kumulative gjatë jetës së instrumentit.

Vlerësimi është bërë për të gjithë skenarët arsyeshmerisht të mundshëm, duke përfshirë skenarët e jashtëzakonshëm por arsyeshmerisht të mundshëm që mund të ndodhin në tregjet financiare. Banka identifikoi dhe konsideroi kushtet kontraktuale që ndryshojnë kohën ose shumën e flukseve monetare kontraktuale. Kriteri i SPPI është plotësuar nëse mundësohet shlyerja e hershme e një kredie dhe shuma e parapagimit përfaqëson në thelb interesin kryesor dhe të përlllogaritur plus një kompensim të arsyeshëm shtesë për përfundimin e hershëm të kontratës. Principali i aktivitetit është vlera e drejtë në njohjen fillestare minus shlyerjet e mëpasshme të principalit, përkatësisht këstet neto të interesit të përcaktuar duke përdorur metodën e interesit efektiv. Si një përjashtim nga ky parim, standardi gjithashtu lejon instrumente me karakteristika të parapagimit që plotësojnë kushtet e mëposhtme për të përmbushur SPPI: (i) aktivi është nisur me një çmim mbi vlerën e tregut ose me zbritje, (ii) shuma e parapagimit përfaqëson shumën kontraktuale të parave dhe interesin e përlllogaritur dhe një kompensim të arsyeshëm shtesë për përfundimin e parakohshëm të kontratës, dhe (iii) vlera e drejtë e tiparit të parapagimit është jomateriale në njohjen fillestare.

Banka shqyrtoi shembuj të standardit dhe konstatoi se tiparet që dalin vetëm nga legjislacioni dhe që nuk janë pjesë e kontratës, tiparet nuk do të zbatoheshin (siç është legjislacioni "bail-in në vende të caktuara), janë jo relevante për të vlerësuar nëse flukset e mjeteve monetare janë SPPI.

**Modifikimi i aktiveve financiare.** Kur aktivet financiare janë modifikuar në mënyrë kontraktuale (p.sh., rinegociuar), Banka vlerëson nëse modifikimi është thelbësor dhe duhet të rezultojë në çregjistrimin e aktivitetit fillestar dhe njohjen e një aktivi të ri me vlerën e drejtë. Ky vlerësim bazohet kryesisht në faktorët cilësorë, të përshkruar në politikën përkatëse të kontabilitetit dhe kërkon gjykime të rëndësishme. Në veçanti, Banka aplikon gjykim për të vendosur nëse kreditë e rinegociuara të zhvlerësuara duhet të çregjistrohen dhe nëse kreditë e reja të njohura duhet të konsiderohen si kredi të zhvlerësuara në njohjen fillestare. Vlerësimi i çregjistrimit varet nëse rreziqet dhe përfitimet, domethënë ndryshueshmëria e flukseve monetare të pritshme (dhe jo kontraktuale) ndryshojnë si rezultat i ndryshimeve të tilla. Menaxhmenti përcaktoi që rreziqet dhe përfitimet nuk ndryshojnë si rezultat i modifikimit të kredive të tilla dhe prandaj në pothuajse të gjitha modifikimet e tilla, kreditë nuk u çregjistruan dhe nuk u rriklasifikuan jashtë kategorizimit të kredive të zhvlerësuara.

**Aktivitet e riposeduara.** Banka klasifikon aktivet e riposeduara si inventarë brenda aktiveve të tjera dhe më pas i mat ato me koston më të ulët dhe me vlerën neto të realizueshme. Matja neto e vlerës së realizueshme përfshin përdorimin e raporteve të vlerësimit të vlerësuesve të pavarur. Vlerat më pas shqyrtohen nga Menaxhmenti i Bankës për inpute të konsiderueshme të pavezhuqeshme dhe për ndonjë ulje në vlerë të nevojshme, nëse duhet. Aktualisht, për shkak të specifikave të tregut të pasurive të paluajtshme në Kosovë dhe çështjeve të legalizimit, frekuenca e transaksioneve është e ulët. Megjithatë, në vlerësimin e menaxhmentit, ka aktivitetet të mjaftueshëm në treg për të ofruar çmime të krahasueshme për transaksionë të rregullta me prona të ngjashme gjatë përcaktimit të vlerës së drejtë për aktivet e riposeduara të Bankës. Menaxhmenti ka shqyrtuar supozimet e vlerësuesve që bazohen në metodat e përdorura në raportet e vlerësimit dhe konfirmon se informacioni i krahasueshëm i përdorur, statusi ligjor i pronave dhe supozimet e bëra përcaktohen në mënyrë të përshtatshme duke marrë parasysh kushtet e tregut në fund të periudhës raportuese. Pavarësisht nga sa më sipër, menaxhmenti konsideron se vlerësimi i aktiveve të riposeduara aktualisht është subjekt i një shkalle në rritje të pasigurisë dhe një mundësie në rritje që të ardhurat aktuale nga shitja e këtyre aktiveve të ndryshojnë nga vlera e bartur. Ulja në vlerë që menaxhmenti përdor për të pasqyruar kostot për shitjen e aktivitetit, mbulojnë pasiguritë që lidhen me statusin ligjor, kohën kur do të shiten aktivet e riposeduara dhe kufizimet e tjera të tregut. Bazuar në të dhënat historike, Banka ka shitur aktivet e saj të riposeduara me shumën prej 46% më të larta



(Të gjitha shumat janë shprehur në mijë euro, përveç kur specifikohet ndryshe)

**3. Vlerësimet dhe gjykimet kritike të kontabilitetit në zbatimin e politikave kontabël (vazhdim)**

krahasuar me vlerat e tyre bartëse bruto në datën e transaksionit dhe 111% më te larta se vlerat e tyre neto në datën e transaksionit.

**4. Zbatimi i standardeve dhe interpretimeve të reja ose rishikuara**

Standardet e mëposhtme të ndryshuara hynë në fuqi për Bankën që nga 1 janari 2018:

**Miratimi i SNRF 9 "Instrumentet Financiare" (i ndryshuar në korrik 2014 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 Janarit 2018).**

Banka zbatoi SNRF 9, Instrumentet Financiare, nga 1 janari 2018. Banka zgjodhi që të mos riparaqesë shifrat krahasuese dhe të njoh cdo rregullim në vlerat kontabël të aktiveve dhe detyrimeve financiare në gjendjen hapëse të fitimeve të mbartura në datën e zbatimit fillestar të standardit, 1 janar 2018. Rrjedhimisht, kërkesat e rishikuara të SNRF 7, "Instrumentet Financiare: Shpalosjet", janë zbatuar vetëm për periudhën aktuale. Dhënia e informacioneve shpjeguese për periudhën krahasuese përsërit ato shpalosje të paraqitura në vitin paraprak. Politikat e reja të rëndësishme kontabël të zbatuara në periudhën aktuale përshkruhen në Shënimin 2. Politikat kontabël të zbatuara para 1 janarit 2018 dhe të zbatueshme për informacionin krahasues janë shpalosur në Shënimin 33.

Tabela në vijim rakordon vlerat kontabël të secilës klasë të aktiveve financiare siç është matur më parë në përputhje me SNK 39 dhe shumat e reja të përcaktuara me miratimin e SNRF 9 më 1 janar 2018.

	Matja		Vlera e Bartur sipas SNK39 më 31 dhjetor 2017	Efekti i zbatimit të SNRF 9				Vlera e Bartur sipas SNK9 me 1 janar 2018
	SNK39	SNRF9		Riklasifikimi		Rimatja		
				I detyrueshem	Vullnetar	ECL	Të tjera	
Paraja dhe ekuivalentët e saj	L&R	AC	37,655	37,655	-	-	-	37,655
Rezerva e detyrueshme e parasë së gatshme me Bankën Qendrore	L&R	AC	49,998	49,998	-	(11)	-	49,987
Bonot e thesarit	AFS	FVOCI	10,583	10,583	-	-	-	10,583
Obligacionet me Qeverinë së Kosovës	AFS	FVOCI	4,824	4,824	-	(6)	-	4,818
Gjendja me banka të tjera me maturim origjinal prej më pak se tre muajsh	L&R	AC	5,975	5,975	-	(35)	-	5,940
Aktivitet e tjera financiare	L&R	AC	3,016	3,016	-	-	-	3,016
<b>Kreditë dhe paradhëniet për entitetet ligjore</b>			<b>182,387</b>	<b>182,387</b>	-	<b>(2,903)</b>	-	<b>179,484</b>
Kreditë	L&R	AC	142,093	142,093	-	(2,296)	-	139,797
Paradhëniet dhe kreditë e tjera								
afatshkurtra	L&R	AC	36,974	36,974	-	(409)	-	36,565
Kredit kartelat	L&R	AC	3,320	3,320	-	(39)	-	3,281
Angazhimet	L&R	AC	-	-	-	(159)	-	(159)
<b>Kredi për individët</b>			<b>185,603</b>	<b>185,603</b>	-	<b>(2,870)</b>	-	<b>182,733</b>
Kreditë	L&R	AC	154,509	154,509	-	(2,198)	-	152,311
Paradhëniet	L&R	AC	2,071	2,071	-	(14)	-	2,057
Kredit Kartelat	L&R	AC	29,023	29,023	-	(477)	-	28,546
Angazhimet	L&R	AC	-	-	-	(181)	-	(181)
<b>Gjithsej aktive financiare</b>			<b>480,041</b>	<b>480,041</b>	-	<b>(5,825)</b>	-	<b>474,216</b>

(Të gjitha shumat janë shprehur në mijë euro, përveç kur specifikohet ndryshe)

#### 4. Zbatimi i standardeve dhe interpretimeve të reja ose rishikuara (vazhdim)

##### (a) Paraja dhe ekuivalentët e parasë dhe gjendjet me BQK-në

Të gjitha kategoritë e parasë dhe ekuivalentëve të saj dhe gjendjet me BQK siç shpalosen në Shënimin 6 janë rriklasifikuar nga kategoria e matjes si kredi dhe të arkëtueshme ("L&R") sipas SNK 39 në kategorinë e matjes me kosto te amortizuar (AC) sipas SNRF 9 në datën e miratimit të standardit. ECL për gjendjet e parasë dhe ekuivalentëve të saj nuk është materiale.

##### (b) Detyrimet nga bankat e tjera

Të gjitha klasat e kredive dhe paradhëniet për bankat janë rriklasifikuar nga kategoria e matjes L&R sipas SNK 39 në kategorinë e matjes AC sipas SNRF 9.

##### (c) Investimet në letrat me vlerë

Instrumentet e mëposhtme të borxhit janë rriklasifikuar në kategori të reja sipas SNRF 9, pasi kategoritë e tyre të mëparshme sipas SNK 39 u shfuqizuan, pa ndryshime në bazën e tyre të matjes: ato të klasifikuara më parë si AFS tani klasifikohen si të matura me FVOCI.

##### (d) Kreditë dhe paradhëniet për klientët

Të gjitha kreditë dhe paradhëniet për klientët maten me kosto te amortizuar (AC) sipas SNRF 9. Nuk kishte ndryshime në matje.

#### Rakordimi i provizionit për zhvlerësim më 31 dhjetor 2017 dhe provizionit për humbje kreditore në 1 janar 2018.

Tabela në vijim rakordon gjendjen mbyllëse të periudhës së mëparshme për provizion te zhvlerësimit te kredive të matur në përputhje me modelin e humbjeve të ndodhura sipas SNK 39 me shumën e re te provizionit për humbje kreditore te matur sipas modelit te humbjeve te pritshme kreditore në përputhje me kërkesat e SNRF 9, më 1 janar 2018:

Kategoria e matjes si kredi dhe te arkëtueshme	Provizioni sipas SNK 39 ose SNK 37 më 31 dhjetor 2017	Efekti		Provizioni për humbje kreditore sipas SNRF 9 me 1 janar 2018
		Riklasifikimi në FVOCI	Rimatje nga humbjet e ndodhura në ato te pritshme	
Paraja dhe ekuivalentët e saj	-	-	-	-
Gjendjet me BQK	-	-	11	11
Kreditë dhe paradhëniet për bankat	-	-	35	35
Investimet në letrat me vlerë	-	6	-	6
Kredi dhe paradhënie për klientët	8,521	-	5,432	13,953
Angazhimet për kreditë	-	-	281	281
Garancionet financiare	4	-	59	63
<b>Gjithsej efekti i zbatimit te SNRF 9</b>	<b>8,525</b>	<b>6</b>	<b>5,818</b>	<b>14,349</b>

Zbatimi për here te pare (FTA) i SNRF 9 ka ndikuar gjithashtu në shumat e tatimit të shtyrë me 1 janar 2018, duke rritur shumën e aktivitetit të tatimit të shtyrë të bankës me 582 mijë euro (shih shënimin 25). Efekti i tatimit të shtyrë është matur duke zbatuar normën tatimore 10% në FTA.

Standardet / ndryshimet në vijim nuk kanë patur ndonjë ndikim material në Bankë kur kanë hyr në fuqi:

**SNRF 15, Të ardhurat nga kontratat me klientët (publikuar më 28 maj 2014 dhe efektive për periudhat që fillojnë më ose pas 1 janarit 2018) dhe ndryshimet në SNRF 15, Të ardhurat nga kontratat me klientët (publikuar më 12 prill 2016 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2018).** Standardi i ri prezanton parimin kryesor që të ardhurat duhet të njihen kur mallrat ose shërbimet i transferohen klientit, me çmimin e transaksionit. Çdo mall ose shërbim i lidhur që është i dallueshëm duhet të njihet veçmas, dhe çdo zbritje ose skonto me çmimin e kontratës në përgjithësi duhet të ndahet për elementët e veçantë. Kur shuma ndryshon për çfarëdo arsye, shuma minimale duhet të njihet nëse nuk ka një rrezik të madh për anulimin. Kostot e shkaktuara për të siguruar kontratat me klientët duhet të kapitalizohen dhe të amortizohen gjatë periudhës kur konsumohen përfitimet nga kontrata. Standardi i ri nuk pati ndonjë ndikim material në pasqyrat financiare te bankës.

(Të gjitha shumat janë shprehur në mijë euro, përveç kur specifikohet ndryshe)

#### 4. Zbatimi i standardeve dhe interpretimeve të reja ose rishikuara (vazhdim)

Standardet e ndryshuara në vijim kanë hyrë në fuqi për Bankën që nga 1 janari 2018, por nuk kanë pasur ndonjë ndikim material në pasqyrat e saj financiare:

- Ndryshimet në SNRF 2 "Pagesa e bazuar në aksione" (publikuar më 20 qershor 2016 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2018).
- Ndryshimet në SNRF 4 - "Zbatimi i SNRF 9 Instrumentet Financiare me SNRF 4 Kontratat e Sigurimeve" (lëshuar më 12 shtator 2016 dhe efektive, varësisht nga qasja, për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2018 për subjektet që zgjedhin të aplikojnë përjashtimin e përkohshëm, ose kur njësitë ekonomike së pari aplikojnë SNRF 9 për njësitë ekonomike që zgjedhin të zbatojnë metodën e mbivendosjes)
- Përmirësimet vjetore të SNRF 2014-2016 - Ndryshimet në SNRF 1 të SNK 28 (publikuar më 8 dhjetor 2016 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2018).
- KIRFN 22 - Transaksionet në valutë të huaj dhe konsiderata paraprake (publikuar më 8 dhjetor 2016 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2018).
- Transferimet e pronës për investim - Ndryshimet në SNK 40 (publikuar më 8 dhjetor 2016 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2018).

#### 5. Standardet e reja kontabël

Janë nxjerrë disa standarde dhe interpretime të reja që janë të detyrueshme për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2019 ose më vonë dhe të cilat Banka nuk i ka miratuar në mënyrë të hershme.

**Karakteristikat e parapagimit me kompensim negativ - Ndryshimet në SNRF 9 (publikuar më 12 tetor 2017 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2019).** Ndryshimet mundësojnë matjen me koston e amortizuar të kredive të caktuara dhe letrave me vlerë që mund të parapagohen me një shumë nën koston e amortizuar, për shembull me vlerën e drejtë ose në një shumë që përfshin një kompensim të arsyeshëm të pagueshëm ndaj kredimarrësit të barabartë me vlerën aktuale të një efekti të rritjes së normës së interesit të tregut gjatë jetës së mbetur të instrumentit. Përveç kësaj, teksti i shtuar në tek baza e standardit për konkluzion, rikonfirmon udhëzimet ekzistuese në SNRF 9 se modifikimet ose shkëmbimet e disa detyrimeve financiare të matura me koston e amortizuar që nuk rezultojnë në çregjistrim do të rezultojnë në një fitim ose humbje. Subjektet raportuese kështu në shumicën e rasteve nuk do të jenë në gjendje të rishikojnë normën efektive të interesit për jetën e mbetur të kredisë në mënyrë që të shmangët një ndikim në fitim ose humbje pas modifikimit të kredisë. Banka aktualisht po vlerëson ndikimin e ndryshimeve në pasqyrat e saj financiare.

**SNRF 16 "Qiratë" (publikuar më 13 janar 2016 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2019).** Standardi i ri përcakton parimet për njohjen, matjen, prezantimin dhe paraqitjen e qirasë. Të gjitha qiratë rezultojnë në faktin që qiramarrësi ka të drejtën e përdorimit të një aktivi në fillim të qirasë dhe, nëse pagesat e qirasë bëhen me kalimin e kohës, gjithashtu merr financime. Prandaj, SNRF 16 eliminon klasifikimin e qirave qoftë kjo si qira operative ose qira financiare siç kërkohet nga SNK 17 dhe, në vend të kësaj, prezanton një model të vetëm të kontabilitetit të qiramarrësit. Qiramarrësit do të kërkohet të njohin: (a) aktivet dhe detyrimet për të gjitha qiratë me një afat më të gjatë se 12 muaj, përveç nëse aktivi nënligjor është me vlerë të vogël; dhe (b) zhvlerësimin e aktiveve të qirasë veç e veç nga interesi për detyrimet e qirasë në pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhura të tjera përmbledhëse. SNRF 16 në thelb përcjell kërkesat e kontabilitetit të qiradhënësit në SNK 17. Prandaj, një qiradhënës vazhdon të klasifikojë qiratë e tij si qira operative ose qira financiare dhe të llogarisë këto dy lloje të qirasë ndryshe. Banka vendosi që do të zbatojë standardin e ri nga data e tij e detyrueshme e zbatimit 1 janar 2019 duke përdorur metodën retrospektive të modifikuar, pa riparaqitur shifrat krahasuese. Banka ka kryer një vlerësim fillestar paraprak të ndikimit të standardit të ri në pasqyrat e tij financiare më 1 janar 2019 si vijon:

E drejta e përdorimit bruto ("ROU")	7,376
Amortizimi i aktivitet ROU	(1,952)
<b>Vlera kontabël neto e aktivitet RoU</b>	<b>5,424</b>
<b>Përgjegjësia e qirasë</b>	<b>5,538</b>
Ndikimi në fitimet e pashpërndara	(114)

*(Të gjitha shumat janë shprehur në mijë euro, përveç kur specifikohet ndryshe)*

## **5. Standardet e reja kontabël (vazhdim)**

*KIRFN 23 "Pasiguria mbi trajtimin e taksave mbi të ardhurat"* (publikuar më 7 qershor 2017 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2019). SNK 12 specifikon mënyrën e llogaritjes së tatimit aktual dhe të shtyrë, por jo si të pasqyrojë efektet e pasigurisë. Interpretimi sqaron se si të zbatohen kërkesat e njohjes dhe të matjes në SNK 12 kur ka pasiguri mbi trajtimet e tatimit mbi të ardhurat. Një njësi ekonomike duhet të përcaktojë nëse duhet të konsiderojë çdo trajtim të pasigurt tatimor veç e veç ose së bashku me një ose më shumë trajtime të tjera të pasigurta tatimore bazuar në atë metodë që parashikon sa më mirë zgjidhjen e pasigurisë. Një njësi ekonomike duhet të supozojë se një autoritet tatimor do të shqyrtojë shumat që ka të drejtë të shqyrtojë dhe të ketë njohuri të plotë për të gjitha informacionet e lidhura me to gjatë kryerjes së këtyre kontrolleve. Nëse një njësi ekonomike arrin në përfundim se nuk është e mundur që autoriteti tatimor të pranojë një trajtim të pasigurt tatimor, efekti i pasigurisë do të pasqyrohet në përcaktimin e fitimit ose humbjes së tatueshme, bazës tatimore, humbjeve tatimore të papërdorura, kredive të papërdorura tatimore ose normave tatimore duke përdorur shumën më të mundshme ose vlerën e pritur, në varësi të metodës që njësi ekonomike pret të parashikojë më mirë zgjidhjen e pasigurisë. Një njësi ekonomike do të pasqyrojë efektin e një ndryshimi në fakte dhe rrethana ose në informacione të reja që ndikojnë në gjykimet ose vlerësimet e kërkuara nga interpretimi si një ndryshim në vlerësimin kontabël. Shembujt e ndryshimeve në fakte dhe rrethana ose informacione të reja që mund të rezultojnë në rivlerësimin e një gjykimi apo vlerësimi përfshijnë, por nuk kufizohen në, ekzaminimet ose veprimet e një autoriteti tatimor, ndryshimet në rregullat e vendosura nga një autoritet tatimor ose skadimi i një e drejta e autoritetit tatimor për të shqyrtuar ose rishqyrtuar një trajtim tatimor. Mungesa e një marrëveshjeje ose mosmarrëveshjeje nga një autoritet tatimor me një trajtim tatimor, të veçuar, nuk ka të ngjarë të përbëjë një ndryshim në fakte dhe rrethana apo informata të reja që ndikojnë në gjykimet dhe vlerësimet e kërkuara nga interpretimi. Banka aktualisht po vlerëson ndikimin e ndryshimeve në pasqyrat e saj financiare.

*Përmirësimet vjetore të SNRF-ve 2015-2017 - Ndryshimet në SNRF 3, SNRF 11, SNK 12 dhe SNK 23* (publikuar më 12 Dhjetor 2017 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 Janarit 2019). Ndryshimet ndikojnë në katër standarde. Në SNRF 3 u sqarua se një blerës duhet të rimendojë interesin e tij të mbajtur më parë në një operacion të përbashkët kur të marrë kontrollin e biznesit. Në anën tjetër, SNRF 11 tani shpjegon në mënyrë eksplicite se investitori nuk duhet të rimarrë peshën e interesit të mbajtur më parë kur të marrë kontrollin e përbashkët të një operacioni të përbashkët, ngjashëm me kërkesat ekzistuese kur një pjesëmarrës bëhet një sipërmarrje e përbashkët dhe anasjelltas. SNK 12 i ndryshuar shpjegon se një njësi ekonomike njih të gjitha pasojat e tatimit mbi të ardhurat e dividendëve në rastet kur ka njohur transaksionet ose ngjarjet që gjenerojnë fitimet e shpërndara, p.sh. në fitim ose humbje ose në të ardhura të tjera përmbledhëse. Tani është e qartë se kjo kërkesë zbatohet në të gjitha rrethanat përderisa pagesat për instrumentet financiare të klasifikuara si kapital janë shpërndarjet e fitimeve dhe jo vetëm në rastet kur pasojat tatimore janë rezultat i normave të ndryshme tatimore për fitimet e shpërndara dhe të pasqyruara. SNK 23 i rishikuar tani përfshin udhëzime të qarta se huamarrjet e fituara posaçërisht për financimin e një aktivi të specifikuar janë përjashtuar nga grupi i kostove të huasë të përgjithshme të pranueshme për kapitalizim vetëm derisa aktivi specifik është në thelb i plotë. Banka aktualisht po vlerëson ndikimin e ndryshimeve në pasqyrat e saj financiare.

Standardet tjera të reja të paraqitura me poshtë nuk priten të kenë ndonjë ndikim të rëndësishëm në pasqyrat financiare të bankës, kur ato të behen të zbatueshme:

*SNRF 17 "Kontratat e Sigurimeve"* (publikuar më 18 maj 2017 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2021). SNRF 17 zëvendëson SNRF 4, i cili i ka dhënë kompanive mundësinë për të mbajtur kontabilitetin për kontratat e sigurimit duke përdorur praktikën ekzistuese. Si pasojë, ishte e vështirë për investitorët të krahasojnë dhe të dallojnë performancën financiare të ndërmarrjeve të ngjashme të sigurimit. SNRF 17 është një standard i vetëm i bazuar në parimin që për të kontabilizuar të gjitha llojet e kontratave të sigurimit, duke përfshirë kontratat e risigurimit që një sigures mban. Standardi kërkon njohjen dhe matjen e grupeve të kontratave të sigurimit në: (i) vlerën e tashme të flukseve të ardhshme monetare, të rregulluar sipas rrezikut, që përfshijnë të gjithë informacionin në dispozicion për përmbushjen e flukseve të mjeteve monetare në një mënyrë që është në përputhje me informacionin e vëzhgueshem të tregut; plus (nëse kjo vlerë është një detyrim) ose minus (nëse kjo vlerë është një aktiv) (ii) një shumë që përfaqëson fitimin e pafituruar në grupin e kontratave (marzhi i shërbimit kontraktual). Siguresit do të njohin fitimin nga një grup i kontratave të sigurimit gjatë periudhës që ata ofrojnë mbulim sigurimi dhe pasi ato lirohen nga rreziku. Nëse një grup i kontratave është ose bëhet humbje, një njësi ekonomike do ta njohë menjëherë humbjen.

*Interesat afatgjata në shoqëritë dhe sipërmarrjet e përbashkëta - Ndryshimet në SNK 28* (publikuar më 12 Tetor 2017 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 Janarit 2019). Ndryshimet sqarojnë që njësitë raportuese duhet të zbatojnë SNRF 9 për kreditë afatgjata, aksionet preferenciale dhe instrumente të ngjashme që janë pjesë e një investimi neto në një metodë të kapitalit neto të investuar para se të mund ta zvogëlojnë këtë vlerë bartëse me një pjesë të humbjes së të investuarit që tejkalon shumën e interesit të investitorit në aksionet e zakonshme.

*Ndryshimet në SNK 19 "Ndryshimet, shkurtimet ose shlyerja e planit"* (publikuar më 7 Shkurt 2018 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 Janarit 2019). Ndryshimet qartësojnë përlllogartjen e shpenzimeve për pensionin në momentin kur ndodhin ndryshime në planin e pensionit me përfitime të përcaktuara. Kur një ndryshim ndodh: përmirësim, shkurtim ose shlyerje; SNK 19 kërkon që të ri-llogaritet përfitimi I përcaktuar neto si detyrim ose

## TEB SH.A.

### Shënimet e pasqyrave financiare për vitin që përfundoi më 31 dhjetor 2018

(Të gjitha shumat janë shprehur në mijë euro, përveç kur specifikohet ndryshe)

#### 5. Standardet e reja kontabël (vazhdim)

si aktiv. Përmirësimet në standart kërkojnë përdorimin e supozimeve të përditësuara nga kjo ri-llogaritje në mënyrë që të përcaktohet kosto aktuale e shërbimit dhe interesi neto për pjesën e mbetur të periudhës raportuese pas ndryshimit të planit. Para se të bëhej ky përmirësim në standart, SNK 19 nuk përcaktonte llogaritjen e këtyre shpenzimeve për periudhën pasi bëhej ndonjë ndryshim në plan. Duke e bërë një domosdoshmëri përdorimin e supozimeve të përditësuara, standardi i ndryshuar pritet që të japi një informacion të dobishëm përdoruesve të pasqyrave financiare.

*Ndryshimet në kuadrin konceptual për raportim financiar (publikuar më 29 Mars 2018 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 Janarit 2020). Kuadri konceptual I rishikuar përfshin një kapitull të ri mbi llogaritjen; udhëzime për performacën e raportimit financiar; përkufizime dhe udhëzime të përmirësuara në veçanti përkufizimin e detyrimeve; dhe sqarimi në lidhje me fusha të rëndësishme si psh: roli i menaxhimit, matja dhe reduktimi I pasigurisë në raportimin financiar.*

Përveç nëse është përshkruar ndryshe, standardet dhe interpretimet e reja nuk priten të ndikojnë ndjeshëm në pasqyrat financiare të Bankës.

#### 6. Paraja dhe gjendja me bankën qendrore

	2018	2017
<b>Paraja e gatshme</b>	<b>24,611</b>	<b>19,304</b>
<b>Paraja në banka</b>	<b>63,883</b>	<b>68,349</b>
- Llogaritë rrjedhëse me banka	26,421	18,351
- Llogari rrjedhëse me BQK-në	119	17,800
- Rezervat e detyrueshme me BQK-në	37,343	32,198
<b>Gjithsej</b>	<b>88,494</b>	<b>87,653</b>
Lejimet për humbjet kreditore	(16)	-
<b>Gjithsej paraaja e gatshme dhe gjendja me bankën qendrore (vlera e bartur)</b>	<b>88,478</b>	<b>87,653</b>

Më 31 dhjetor 2018 Banka ka njohur 16 mijë euro (2017: zero) si lejim për humbjet kreditore që lidhen me paranë dhe gjendjen me Bankën Qendrore, sipas procedurës të miratuar të Bankës për SNRF 9, e cila është e bazuar në 0.05% PD dhe 45% LGD.

Në përputhje me kërkesat e BQK-së në lidhje me rezervën e depozitave për qëllime likuiditeti, Banka duhet të mbajë një minimum prej 10% të depozitave të klientëve me afat maturimi deri në një vit, si rezerva ligjore. Rezervat e detyrueshme mund të mbahen në formën e instrumenteve me likuiditet të lartë, duke përfshirë mjetet monetare në llogari në BQK ose në bankat e tjera në Kosovë, dhe shumat e mbajtura në BQK nuk duhet të jenë më pak se gjysma e rezervave të përgjithshme statutores.

**Paraja dhe ekuivalentët e saj** në pasqyrën e rrjedhës së parasë më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017 përfshijnë:

	2018	2017
Paratë e gatshme dhe në banka	51,032	37,655
Gjendjet e pakufizuara me BQK-në	119	17,800
Kreditë dhe paradhëniet për bankat (shënimi 7)	54,341	5,975
<b>Gjithsej, paraaja e gatshme dhe në banka</b>	<b>105,492</b>	<b>61,430</b>
Lejimet për humbjet kreditore	(110)	-
<b>Gjithsej, paraaja e gatshme dhe ekuivalentet e saj (vlera kontabël)</b>	<b>105,382</b>	<b>61,430</b>

**Cilësia kreditore.** Tabela e mëposhtme paraqet vlerësimin kreditor të caktuar nga agjencitë e vlerësimit kreditor siç janë Moody, Fitch dhe Standard&Poors. Të gjitha gjendjet me bankat nuk janë as në vonëse as të zhvlerësuar.

(Të gjitha shumat janë shprehur në mijë euro, përveç kur specifikohet ndryshe)

**6. Paraja dhe gjendja me bankën qendrore (vazhdim)**

Vlerësimet	2018	2017
AAA	2,861	2,927
A	-	3,369
A-	12,528	11,867
Aa3	75	185
BBB	10,954	1
BB-	4	-
BBB-	-	2
Gjendjet me BQK - jo të vlerësuara	37,461	49,998
<b>Gjithsej, paraja në banka dhe gjendja me Bankën Qendrore (duke mos përfshirë paratë e gatshme)</b>	<b>63,883</b>	<b>68,349</b>
Lejimet për humbjet kreditore	(16)	-
<b>Gjithsej, paraja në banka dhe gjendja me Bankën Qendrore (vlera kontabël)</b>	<b>63,867</b>	<b>68,349</b>

Ndonëse obligacionet e Qeverisë së Republikës së Kosovës nuk vlerësohen, borxhi publik aktualisht është nën 20% të PBB-së dhe rritja e parashikuar në periudhën afatmesme pritet të mbetet nën 30% të PBB-së, tavan i cili konsiderohet i kujdesshëm për Kosovën<sup>1</sup>. Ky tavan dhe stabiliteti i përgjithshëm buxhetor që kërkon që deficitin buxhetor të mbetet brenda 2% të PBB-së, janë faktorët kyç për vlerësimin e instrumenteve të lëshuara nga Qeveria si të qëndrueshme. Për qëllimin e matjes së ECL, paraja dhe ekuivalentet e saj përfshihen në Fazën 1.

Më 31 dhjetor 2018 Banka kishte 9 llogari bankare (2017: 2 llogari bankare) gjendja e parasë së gatshme në të cilat kalonte EUR 5 milion. Shuma totale e këtyre gjendjeve, më 31 dhjetor 2018, ishte 107 milionë Euro (2017: 62 milionë Euro) ose 90% e total gjendjes së parave dhe ekuivalentëve të saj (2017: 83%).

**7. Kreditë dhe paradhëniet për bankat**

	2018	2017
Kredi dhe paradhënie për bankat	54,341	5,975
Lejimet për humbjet kreditore	(102)	-
<b>Gjithsej kreditë dhe paradhëniet për bankat</b>	<b>54,239</b>	<b>5,975</b>

Kreditë dhe paradhëniet për bankat në 31 Dhjetor 2018 dhe 31 Dhjetor 2017 që kanë maturime origjinale më pak se 3 muaj janë përfshirë në ekuivalentët e parasë. Normat mesatare vjetore të interesit të tregut me bankat në depozitat me afat në fund të periudhës raportuese ishin si më poshtë:

- EUR: 2018 – maks I/R 0.90%, min I/R 0.50%
- USD: 2018 – maks I/R 3.85%, min I/R 1.45%
- EUR: 2017 – maks I/R 0.95%, min I/R 0.01%
- USD: 2017 – maks I/R 1.45%, min I/R 0.01%

**Cilësia kreditore.** Vlerësimi kreditor është caktuar nga agjencia e vlerësimit të kredive të Moody's. Për qëllime të matjes së ECL, kreditë dhe paradhëniet për bankat janë përfshirë në Fazën 1. Vlera e bartur e kredive dhe paradhënieve për bankat e tjera më 31 dhjetor 2018 më poshtë paraqet gjithashtu ekspozimin maksimal të Bankës ndaj rrezikut të kredisë për këto aktive:

	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
A1	7,862	-
A2	6,665	-
A3	4,000	-
Ba1	16,008	-
Ba2	-	5,975
B2	19,806	-
<b>Vlera e bartur, bruto</b>	<b>54,341</b>	<b>5,975</b>
Lejimet për humbjet kreditore	(102)	-
<b>Vlera e bartur, neto</b>	<b>54,239</b>	<b>5,975</b>

Tabela në vijim shpjegon ndryshimet në lejimin për humbjet kreditore dhe vlerën e bartur bruto të kredive dhe paradhënieve për bankat në fillim dhe fund të periudhës raportuese.

<sup>1</sup> Raporti i FMN – dhjetor 2018

**TEB SH.A.****Shënimet e pasqyrave financiare për vitin që përfundoi më 31 dhjetor 2018***(Të gjitha shumat janë shprehur në mijë euro, përveç kur specifikohet ndryshe)***7. Kreditë dhe paradhëniet për bankat (vazhdim)**

	Lejimet për humbjet kreditore			Gjithsej	Vlera e bartur bruto			Gjithsej
	Faza 1 (12 muaj ECL)	Faza 2 (jetëgjatësia ECL për SICR)	Faza 3 (jetëgjatësia ECL për dëmtim të kredisë)		Faza 1 (12 muaj ECL)	Faza 2 (jetëgjatësia ECL për SICR)	Faza 3 (jetëgjatësia ECL për dëmtim të kredisë)	
<b>Kredi dhe paradhënie për bankat</b>								
<b>Më 1 janar 2018</b>	-	-	-	-	5,975	-	-	<b>5,975</b>
Lëvizjet që ndikojnë në ngarkesën e lejimit të humbjeve kreditore për periudhën:								
Transferet:								
Te blera ose te gjeneruara si të reja	(102)	-	-	<b>(102)</b>	54,341	-	-	<b>54,341</b>
Cregjistrimet gjatë periudhës	-	-	-	-	(5,975)	-	-	<b>(5,975)</b>
<b>Gjithsej levizjet me ndikim në ngarkesën për lejimin e humbjeve kreditore për periudhën</b>	<b>(102)</b>	-	-	<b>(102)</b>	<b>48,366</b>	-	-	<b>48,366</b>
<b>Më 31 dhjetor 2018</b>	<b>(102)</b>	-	-	<b>(102)</b>	<b>54,341</b>	-	-	<b>54,341</b>

(Të gjitha shumat janë shprehur në mijë euro, përveç kur specifikohet ndryshe)

**8. Investimet në letra me vlerë të matura në vlerën e drejtë përmes të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse dhe aktive financiare të gatshme për shitje (për informacionin krahasues)**

	2018	2017
	FVOCI	AFS
Bonot e Thesarit të Qeverisë së Kosovës	10,305	10,583
Obligacionet e Qeverisë së Kosovës	5,949	4,824
<b>Gjithsej</b>	<b>16,254</b>	<b>15,407</b>

Normat e interesit nga obligacionet qeveritare dhe bonot e thesarit në fund të periudhës raportuese ishin si më poshtë:

- Bonot 2018 – maks 2.00%, min 0.50%                      Bonot: 2017 – maks 1.00%, min 0.40%
- Obligaicionet: 2018 – maks 0.85%, min 0.30%              Obligacionet: 2017 – max 0.40%, min 0.07%

Ndonëse obligacionet e Qeverisë së Republikës së Kosovës nuk vlerësohen, borxhi publik aktualisht është nën 20% të PBB-së dhe rritja e parashikuar në periudhën afatmesme pritet të mbetet nën 30% të PBB-së, tavan i cili konsiderohet i kujdesshëm për Kosovën. Ky tavan dhe stabiliteti i përgjithshëm buxhetor që kërkon që cdo deficit buxhetor të mbetet brenda 2% të BPP-së janë faktorët kyç për vlerësimin e instrumenteve të lëshuara nga Qeveria si të qëndrueshme.

Lëvizja gjatë vitit në investimet në letra me vlerë paraqitet si më poshtë:

	2018	2017
Gjendja fillestare	15,407	14,727
Shtesat	13,731	19,003
Investimet e maturuara	(11,673)	(18,202)
Investimet e shitura	(1,249)	-
Ngarkimi i interesit te perlllogaritur	36	(150)
Ndryshimi në vlerën e drejtë	6	29
Provizioni për zhvlerësim	(4)	-
<b>Gjendja mbyllesë</b>	<b>16,254</b>	<b>15,407</b>

Investimet në letrat me vlerë më 31 dhjetor 2018 maten të gjitha me vlerën e drejtë nëpërmjet të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse (FVOCI).

Tabela më poshtë përmban një analizë të ekspozimit të rrezikut kreditor të letrave me vlerë të matura me FVOCI më 31 dhjetor 2018. Aktivitetet e tilla, me automatizem klasifikohen në Fazën 1 për të cilën njihet një ECL bazuar në PD minimale të Basel-it prej 0.05% dhe LGD minimale të Basel-it prej 45 %.

	Faza 1 (12-muaj ECL)	Faza 2 (ECL përgjatë jetëgjatësisë për SICR)	Faza 3 (ECL përgjatë jetëgjatësisë për aktivet e zhvlerësuar)	Gjithsej
<b>Bonot e Thesarit të Qeverisë së Kosovës</b>				
Te pa vlerësuar	10,301	-	-	<b>10,301</b>
Vlera e bartur bruto	10,301	-	-	<b>10,301</b>
Minus: Lejimet për humbje kreditore	(2)	-	-	<b>(2)</b>
Minus: Rregullimet për vlerën e drejtë	4	-	-	<b>4</b>
<b>Vlera e bartur (vlera e drejtë)</b>	<b>10,303</b>	-	-	<b>10,303</b>
<b>Obligacionet e Qeverisë së Kosovës</b>				
Te pa vlerësuar	5,950	-	-	<b>5,950</b>
Vlera e bartur bruto	5,950	-	-	<b>5,950</b>
Minus: Lejimet për humbje kreditore	(1)	-	-	<b>(1)</b>
Minus: Rregullimet për vlerën e drejtë	2	-	-	<b>2</b>
<b>Vlera e bartur (vlera e drejtë)</b>	<b>5,951</b>	-	-	<b>5,951</b>
<b>Gjithsej vlera e bartur (vlera e drejtë)</b>	<b>16,254</b>	-	-	<b>16,254</b>



**TEB SH.A.****Shënimet e pasqyrave financiare për vitin që përfundoi më 31 dhjetor 2018***(Të gjitha shumat janë shprehur në mijë euro, përvec kur specifikohet ndryshe)***9. Kreditë dhe paradhëniet për klientët**

	<b>31 dhjetor 2018</b>	<b>31 dhjetor 2017</b>
Vlera e bartur bruto e kredive dhe paradhënieve për klientët	<b>395,190</b>	<b>376,511</b>
Minus: Lejimet për humbjet kreditore	(11,883)	(8,521)
<b>Gjithsej vlera e bartur e kredive dhe paradhënieve për klientët</b>	<b>383,307</b>	<b>367,990</b>

Portofoli i kredive dhe paradhënieve për klientët përmbush kërkesat e SPPI për klasifikimin me kosto te amortizuar (AC) sipas SNRF 9. Si rezultat, këto kredi dhe paradhënie janë klasifikuar me kosto te amortizuar nga data e njohjes fillestare. Vlera e bartur bruto e paraqitur në pasqyrën e pozicionit financiar përfaqëson më së miri ekspozimin maksimal të Bankës ndaj rrezikut të kredisë që rrjedh nga kreditë dhe paradhëniet ndaj klientëve.

Vlera e bartur bruto dhe shuma e lejuar e humbjeve kreditore për kreditë dhe paradhëniet ndaj klientëve me kosto te amortizuar, sipas klasave, më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017 janë shpalosur në tabelën e mëposhtme:

	<b>31 dhjetor 2018</b>		<b>31 dhjetor 2017</b>			
	Vlera e bartur bruto	Lejimet për humbjet kreditore	Vlera e bartur neto	Vlera e bartur bruto	Provizioni për zhlvësimin e kredive	Vlera e bartur neto
<i>Kredi për individët</i>	<b>204,978</b>	<b>(4,259)</b>	<b>200,719</b>	<b>187,689</b>	<b>(1,978)</b>	<b>185,711</b>
Kredi standarde	172,013	(3,204)	<b>168,809</b>	156,143	(1,504)	<b>154,639</b>
Paradhënie	2,199	(94)	<b>2,105</b>	2,131	(60)	<b>2,071</b>
Kredit kartelat	30,766	(961)	<b>29,805</b>	29,415	(414)	<b>29,001</b>
<i>Kredi për entitete ligjore</i>	<b>190,212</b>	<b>(7,624)</b>	<b>182,588</b>	<b>188,822</b>	<b>(6,543)</b>	<b>182,279</b>
Kredi standarde	156,032	(6,518)	<b>149,514</b>	147,751	(5,758)	141,993
Paradhënie	30,483	(991)	<b>29,492</b>	37,688	(722)	36,966
Kredit kartelat	3,697	(115)	<b>3,582</b>	3,383	(63)	3,320
<b>Gjithsej kreditë dhe paradhëniet për klientët</b>	<b>395,190</b>	<b>(11,883)</b>	<b>383,307</b>	<b>376,511</b>	<b>(8,521)</b>	<b>367,990</b>

Lëvizja gjatë vitit në lejimin për zhlvësimin e kredive dhe paradhënieve ndaj klientëve, është si me poshtë:

	<b>2018</b>			<b>2017</b>		
	Individët	Entitetet Ligjore	Gjithsej	Individët	Entitetet Ligjore	Gjithsej
Gjendja në 1 janar	1,978	6,543	<b>8,521</b>	7,233	17,007	<b>24,240</b>
Zbatimi për here te pare i SNRF 9 (Lirimi)/ngarkesa gjatë vitit	2,689	2,744	<b>5,433</b>	-	-	-
Kreditë e shlyera	490	391	<b>881</b>	(778)	(2,595)	<b>(3,373)</b>
	(898)	(2,054)	<b>(2,952)</b>	(4,477)	(7,869)	<b>(12,346)</b>
<b>Gjendja më 31 dhjetor</b>	<b>4,259</b>	<b>7,624</b>	<b>11,883</b>	<b>1,978</b>	<b>6,543</b>	<b>8,521</b>

Ngarkesa gjatë vitit, në pasqyrën e fitimit ose humbjes, për lejimin e humbjeve kreditore, është si vijon:

	<b>2018</b>			<b>2017</b>		
	Individët	Entitetet Ligjore	Gjithsej	Individuale	Entitetet Ligjore	Gjithsej
(Lirimi)/ngarkesa gjatë vitit	(490)	(391)	<b>(881)</b>	778	2,595	<b>3,373</b>
Arkëtimet nga kreditë e shlyera	834	815	<b>1,649</b>	385	410	<b>795</b>
<b>Gjithsej për vitin</b>	<b>344</b>	<b>424</b>	<b>768</b>	<b>1,163</b>	<b>3,005</b>	<b>4,168</b>

Më 31 dhjetor 2018, dhjetë kredimarrësit më të mëdhenj përfaqësojnë 4.23% (2017: 4.57%) të totalit të kredive. Kreditë dhe paradhëniet për klientët përfshijnë interesin e përlogaritur prej 1,916 mijë Euro (2017: 1,704 mijë Euro) dhe tarifen e shtyrë të disbursimit prej 1,323 mijë Euro (2017: 1,361 mijë Euro).

**TEB SH.A.****Shënimet e pasqyrave financiare për vitin që përfundoi më 31 dhjetor 2018***(Të gjitha shumat janë shprehur në mijë euro, përvec kur specifikohet ndryshe)***9. Kreditë dhe paradhëniet për klientët (vazhdim)**

Tabela në vijim paraqet ndryshimet në lejimin për humbjet kreditore dhe vlerën e bartur bruto për kreditë dhe paradhëniet për klientët të mbajtur me koston e amortizuar midis fillimit dhe fundit të periudhës raportuese.

	Lejimi për humbjet kreditore			Gjithsej	Vlera e bartur bruto			Gjithsej
	Faza 1 (12-muaj ECL)	Faza 2 (ECL përgjatë jetëgjatësisë për SICR)	Faza 3 (ECL përgjatë jetëgjatësisë për aktivet e zhvluarsuara)		Faza 1 (12-muaj ECL)	Faza 2 (ECL përgjatë jetëgjatësisë për SICR)	Faza 3 (ECL përgjatë jetëgjatësisë për aktivet e zhvluarsuara)	
<b>Kredi standarde</b>								
<b>Më 1 janar 2018</b>	4,814	1,876	5,065	<b>11,755</b>	270,993	24,572	8,329	<b>303,894</b>
<b>Lëvizjet me ndikim në ngarkesën e lejimit të humbjeve kreditore për periudhën:</b>								
<b>Transferimet:</b>								
Transferim nga Faza 1 në Fazën 2	(164)	395	-	<b>231</b>	(6,632)	4,298	-	<b>(2,334)</b>
Transferim nga Faza 1 në Fazën 3	(28)	-	717	<b>689</b>	(873)	-	1,277	<b>404</b>
Transferim nga Faza 2 në Fazën 3	-	(280)	458	<b>178</b>	-	(1,273)	979	<b>(294)</b>
Transferim nga Faza 3 në Fazën 2	-	68	(202)	<b>(134)</b>	-	195	(322)	<b>(127)</b>
Transferim nga Faza 2 në Fazën 1	45	(306)	-	<b>(261)</b>	2,712	(4,259)	-	<b>(1,547)</b>
Transferim nga Faza 3 në Fazën 1 (Lirim-Ripagese)/Rritje nga e njëjta fazë	1 (1,711)	- (453)	(33) 25	<b>(32)</b> <b>(2,139)</b>	31 (53,988)	- (4,236)	(53) (787)	<b>(22)</b> <b>(59,011)</b>
Plotësisht të ripaguara gjatë vitit	(1,100)	(366)	216	<b>(1,250)</b>	(65,230)	(7,989)	(1,214)	<b>(74,433)</b>
Aktive të reja	1,983	931	-	<b>2,914</b>	151,370	12,374	-	<b>163,744</b>
<b>Gjithsej lëvizjet me ndikim në ngarkesën e lejimit të humbjeve kreditore për periudhën</b>	<b>3,840</b>	<b>1,865</b>	<b>6,246</b>	<b>11,951</b>	<b>298,383</b>	<b>23,682</b>	<b>8,209</b>	<b>330,274</b>
Lëvizjet pa ndikim në ngarkesën e lejimit për humbjet kreditore për periudhën:								
Kreditë e shlyera	-	-	(2,229)	<b>(2,229)</b>	-	-	(2,229)	<b>(2,229)</b>
<b>Më 31 dhjetor 2018</b>	<b>3,840</b>	<b>1,865</b>	<b>4,017</b>	<b>9,722</b>	<b>298,383</b>	<b>23,682</b>	<b>5,980</b>	<b>328,045</b>

Lirimet dhe/ose ripagesat nga e njëjta fazë, në tabelën e mësipërme, paraqesin shumën e ripagesave gjatë vitit për kreditë që kanë qenë aktive me 1 janar 2018 dhe janë akoma kredi aktive deri më 31 dhjetor 2018 dhe Faza e të cilave ka mbetur e pandryshuar gjatë vitit 2018.

Kreditë plotësisht të ripaguara gjatë vitit, përfaqësojnë kreditë që ishin aktive nga 1 janari 2018, por që janë ripaguar plotësisht gjatë vitit dhe nuk janë më aktive më 31 dhjetor 2018.

**TEB SH.A.****Shënimet e pasqyrave financiare për vitin që përfundoi më 31 dhjetor 2018***(Të gjitha shumat janë shprehur në mijë euro, përveç kur specifikohet ndryshe)***9. Kreditë dhe paradhëniet për klientët (vazhdim)**

	Lejimi për humbjet kreditore			Gjithsej	Vlera e bartur bruto			Gjithsej
	Faza 1 (12-muaj ECL)	Faza 2 (ECL përgjatë jetëgjatësisë për SICR)	Faza 3 (ECL përgjatë jetëgjatësisë për aktivet e zhvlerësuar)		Faza 1 (12-muaj ECL)	Faza 2 (ECL përgjatë jetëgjatësisë për SICR)	Faza 3 (ECL përgjatë jetëgjatësisë për aktivet e zhvlerësuar)	
<b>Paradhëniet</b>								
<b>Më 1 janar 2018</b>	672	89	443	<b>1,204</b>	36,537	2,606	676	<b>39,819</b>
<i>Lëvizjet me ndikim në ngarkesën e lejimit të humbjeve kreditore për periudhën:</i>								
<b>Transferimet:</b>								
Transferim nga Faza 1 në Fazën 2	(22)	62	-	<b>40</b>	(1,088)	761	-	<b>(327)</b>
Transferim nga Faza 1 në Fazën 3	(3)	-	137	<b>134</b>	(135)	-	187	<b>52</b>
Transferim nga Faza 2 në Fazën 3	-	(16)	34	<b>18</b>	-	(89)	70	<b>(19)</b>
Transferim nga Faza 3 në Fazën 2	-	-	(1)	<b>(1)</b>	2	-	(2)	<b>-</b>
Transferim nga Faza 2 në Fazën 1	22	(23)	-	<b>(1)</b>	1,015	(880)	-	<b>135</b>
Transferim nga Faza 3 në Fazën 1 (Lirim-Ripagese)/Rritje nga e njëjta fazë	-	-	(1)	<b>(1)</b>	-	-	(1)	<b>(1)</b>
Fazë	(169)	2	22	<b>(145)</b>	(3,901)	(15)	(18)	<b>(3,934)</b>
Plotësisht të ripaguara gjatë vitit	(116)	(34)	19	<b>(131)</b>	(6,301)	(1,046)	(42)	<b>(7,389)</b>
Aktive të reja	69	16	-	<b>85</b>	3,946	517	-	<b>4,463</b>
<b>Gjithsej lëvizjet me ndikim në ngarkesën e lejimit të humbjeve kreditore për periudhën</b>	<b>453</b>	<b>96</b>	<b>653</b>	<b>1,202</b>	<b>30,075</b>	<b>1,854</b>	<b>870</b>	<b>32,799</b>
<i>Lëvizjet pa ndikim në ngarkesën e lejimit për humbjet kreditore për periudhën:</i>								
Kreditë e shlyera	-	-	(117)	<b>(117)</b>	-	-	(117)	<b>(117)</b>
<b>Më 31 dhjetor 2018</b>	<b>453</b>	<b>96</b>	<b>536</b>	<b>1,085</b>	<b>30,075</b>	<b>1,854</b>	<b>753</b>	<b>32,682</b>

Lirimet dhe/ose ripagesat nga e njëjta fazë, në tabelën e mësipërme, paraqesin shumën e ripagesave gjatë vitit, për paradhëniet që kanë qenë aktive më 1 janar 2018 dhe janë akoma aktive deri më 31 dhjetor 2018 dhe Faza e të cilave ka mbetur e pandryshuar gjatë vitit 2018.

Paradhëniet plotësisht të ripaguara gjatë vitit, përfaqësojnë paradhëniet që ishin aktive nga 1 janari 2018, por që janë ripaguar plotësisht gjatë vitit dhe nuk janë më aktive më 31 dhjetor 2018.

**TEB SH.A.****Shënimet e pasqyrave financiare për vitin që përfundoi më 31 dhjetor 2018***(Të gjitha shumat janë shprehur në mijë euro, përvec kur specifikohet ndryshe)***9. Kreditë dhe paradhëniet për klientët (vazhdim)**

	Lejimi për humbjet kreditore			Gjithsej	Vlera e bartur bruto			Gjithsej
	Faza 1 (12-muaj ECL)	Faza 2 (ECL përgjatë jetëgjatësisë për SICR)	Faza 3 (ECL përgjatë jetëgjatësisë për aktivet e zhvlerësuara)		Faza 1 (12-muaj ECL)	Faza 2 (ECL përgjatë jetëgjatësisë për SICR)	Faza 3 (ECL përgjatë jetëgjatësisë për aktivet e zhvlerësuara)	
<b>Kredit kartelat</b>								
<b>Më 1 janar 2018</b>	573	109	313	<b>995</b>	30,042	1,931	825	<b>32,798</b>
<b>Lëvizjet me ndikim në ngarkesën e lejimit të humbjeve kreditore për periudhën:</b>								
<b>Transferimet:</b>								
Transferim nga Faza 1 në Fazën 2	(26)	79	-	<b>53</b>	(1,328)	1,373	-	<b>45</b>
Transferim nga Faza 1 në Fazën 3	(8)	-	184	<b>176</b>	(419)	-	523	<b>104</b>
Transferim nga Faza 2 në Fazën 3	-	(33)	59	<b>26</b>	-	(194)	173	<b>(21)</b>
Transferim nga Faza 3 në Fazën 2	-	2	(21)	<b>(19)</b>	-	18	(61)	<b>(43)</b>
Transferim nga Faza 2 në Fazën 1	7	(21)	-	<b>(14)</b>	260	(269)	-	<b>(9)</b>
Transferim nga Faza 3 në Fazën 1	-	-	(13)	<b>(13)</b>	14	-	38	<b>52</b>
(Lirim-Ripagese)/Rritje nga e njëjta Fazë	60	(3)	20	<b>77</b>	1,118	2	(88)	<b>1,032</b>
Plotësisht të ripaguara gjatë vitit	(29)	(14)	376	<b>333</b>	(1,498)	(175)	(35)	<b>(1,708)</b>
Aktive të reja	46	23	-	<b>69</b>	2,346	474	-	<b>2,820</b>
<b>Gjithsej lëvizjet me ndikim në ngarkesën e lejimit të humbjeve kreditore për periudhën</b>	<b>623</b>	<b>142</b>	<b>918</b>	<b>1,683</b>	<b>30,535</b>	<b>3,160</b>	<b>1,375</b>	<b>35,070</b>
Lëvizjet pa ndikim në ngarkesën e lejimit për humbjet kreditore për periudhën:								
Kreditë e shlyera	-	-	(607)	<b>(607)</b>	-	-	(607)	<b>(607)</b>
<b>Më 31 dhjetor 2018</b>	<b>623</b>	<b>142</b>	<b>311</b>	<b>1,076</b>	<b>30,535</b>	<b>3,160</b>	<b>768</b>	<b>34,463</b>

Lirimet dhe/ose ripagesat nga e njëjta fazë, në tabelën e mësipërme, paraqesin shumën e ripagesave gjatë vitit për kredit kartelat që kanë qenë aktive me 1 janar 2018 dhe janë akoma aktive më 31 dhjetor 2018 dhe Faza e të cilave ka mbetur e pandryshuar gjatë vitit 2018. Kredit kartelat plotësisht të ripaguara gjatë vitit, përfaqësojnë kredit kartelat që ishin aktive nga 1 janari 2018, por që janë ripaguar plotësisht gjatë vitit dhe nuk janë më aktive më 31 dhjetor 2018.

(Të gjitha shumat janë shprehur në mijë euro, përvec kur specifikohet ndryshe)

**9. Kreditë dhe paradhëniet për klientët (vazhdim)**

Tabela në vijim përmban një analizë të ekspozimit të rrezikut kreditor të kredive dhe paradhënieve ndaj klientëve të matur me kosto të amortizuar dhe për të cilat njihen ECL. Vlera e bartur e kredive dhe paradhënieve për klientët më poshtë paraqet gjithashtu ekspozimin maksimal të Bankës ndaj rrezikut kreditor për këto kredi.

Cilësia kreditore e kredive ndaj klientëve të mbajtura me koston e amortizuar, me 31 Dhjetor 2018, është si më poshtë:

	Faza 1 (12-muaj ECL)	Faza 2 (ECL përgjatë jetëgjatësisë për SICR)	Faza 3 (ECL përgjatë jetëgjatësisë për aktivet e zhvlerësuar)	POCI	Gjithsej
<b>Entitetet Ligjore</b>					
E shkëlqyer	161,661	21,321	238	-	<b>183,220</b>
E mirë	346	877	135	-	<b>1,358</b>
E kënaqshme	-	1,145	295	-	<b>1,440</b>
Monitorim i veçantë	-	-	2,324	-	<b>2,324</b>
Te deshtuara	-	-	1,871	-	<b>1,871</b>
<b>Vlera e bartur bruto</b>	<b>162,007</b>	<b>23,343</b>	<b>4,863</b>	-	<b>190,213</b>
Humbjet e pritshme kreditore	(2,721)	(1,636)	(3,267)	-	(7,624)
<b>Vlera e bartur</b>	<b>159,286</b>	<b>21,707</b>	<b>1,596</b>	-	<b>182,589</b>
<b>Individët</b>					
E shkëlqyer	196,060	4,011	150	-	<b>200,221</b>
E mirë	935	658	10	-	<b>1,603</b>
E kënaqshme	-	676	16	-	<b>692</b>
Monitorimi i veçantë	-	-	66	-	<b>66</b>
Te deshtuara	-	-	2,395	-	<b>2,395</b>
<b>Vlera e bartur bruto</b>	<b>196,995</b>	<b>5,345</b>	<b>2,637</b>	-	<b>204,977</b>
Humbjet e pritshme kreditore	(2,196)	(457)	(1,606)	-	(4,259)
<b>Vlera e bartur</b>	<b>194,799</b>	<b>4,888</b>	<b>1,031</b>	-	<b>200,718</b>

Kreditë e vlerësura me cilësi kreditore të shkëlqyeshme në tabelën e mësipërme, përfaqësojnë kreditë të cilat me 31 dhjetor 2018 janë në zero ditë vonesë. Ngjashëm, kreditë e vlerësuar me cilësi kreditore të mirë ose të kënaqshme paraqesin përkatësisht kreditë në 1-30 ditë vonesë dhe kreditë në 31-90 ditë vonesë.

Kreditë në monitorim të veçantë përfaqësojnë kreditë që vlerësohen individualisht për zhvlerësim ndërkaq kreditë e deshtuara paraqesin kreditë me më shumë se 90 ditë vonesë.

(Të gjitha shumat janë shprehur në mijë euro, përvec kur specifikohet ndryshe)

**9. Kreditë dhe paradhëniet për klientët (vazhdim)**

Analiza sipas cilësisë kreditore të kredive dhe paradhënieve për kliente si më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017 është si vijon:

	2018			2017		
	Individ	Entitete ligjore	Gjithsej	Individ	Entitete ligjore	Gjithsej
<b>Faza 1 dhe Faza 2</b>						
0 ditë vonesë	200,113	182,940	<b>383,053</b>	182,411	178,292	<b>360,703</b>
1 deri në 30 ditë vonesë	1,593	1,233	<b>2,826</b>	1,526	2,414	<b>3,940</b>
31 deri në 90 ditë vonesë	676	1,145	<b>1,821</b>	737	1,237	<b>1,974</b>
<b>Gjithsej kreditë e zhvlersuara në fazën 1 dhe 2</b>	<b>202,382</b>	<b>185,318</b>	<b>387,700</b>	<b>184,674</b>	<b>181,943</b>	<b>366,617</b>
<b>Faza 3 kreditë e zhvlersuara në menyre kolektive</b>						
0 ditë vonesë	150	238	<b>388</b>	238	610	<b>848</b>
1 deri në 30 ditë vonesë	10	135	<b>145</b>	18	288	<b>306</b>
31 deri në 90 ditë vonesë	16	295	<b>311</b>	18	162	<b>180</b>
mbi 90 ditë vonesë	2,395	1,871	<b>4,266</b>	2,559	2,579	<b>5,138</b>
<b>Gjithsej kreditë në fazën 3 te zhvlersuara në menyre kolektive</b>	<b>2,571</b>	<b>2,539</b>	<b>5,110</b>	<b>2,833</b>	<b>3,639</b>	<b>6,472</b>
<b>Faza 3 kreditë e zhvlersuara individualisht</b>						
0 ditë vonesë	-	294	<b>294</b>	-	136	<b>136</b>
1 deri në 30 ditë vonesë	-	73	<b>73</b>	-	90	<b>90</b>
31 deri në 90 ditë vonesë	-	397	<b>397</b>	-	315	<b>315</b>
mbi 90 ditë vonesë	64	1,561	<b>1,625</b>	71	2,810	<b>2,881</b>
<b>Gjithsej kreditë në fazën 3 te zhvlersuara individualisht</b>	<b>64</b>	<b>2,325</b>	<b>2,389</b>	<b>71</b>	<b>3,351</b>	<b>3,422</b>
<b>Gjithsej kreditë</b>	<b>205,017</b>	<b>190,182</b>	<b>395,199</b>	<b>187,578</b>	<b>188,933</b>	<b>376,511</b>
Humbjet e pritshme kreditore	(4,259)	(7,633)	<b>(11,892)</b>	(1,979)	(6,542)	<b>(8,521)</b>
<b>Kreditë neto</b>	<b>200,758</b>	<b>182,549</b>	<b>383,307</b>	<b>185,599</b>	<b>182,391</b>	<b>367,990</b>

**Kreditë me terma të rinegociuara**

Kreditë me terma të rinegociuara janë kredi që janë ristrukturuar për shkak të përkeqësimit të pozicionit financiar të kredimarrësit dhe ku Banka ka bërë lëshime që nuk do të merrte në konsideratë. Një vendim për ristrukturim/rinegocim është subjekt i pikave të mëposhtme:

- ristrukturimi rrit mundësinë që kredimarrësi do të jetë në gjendje të paguajë ekspozimin;
- plani i ri i pagesave është në përputhje me kapacitetin aktual dhe të pritshëm të pagesave të kredimarrësit;
- kredimarrësi ofron kolateral shtesë, nëse është e mundur dhe e përshtatshme.

<b>Kreditë me terma të rinegociuara</b>	<b>2018</b>	<b>2017</b>
Faza 1	-	384
Faza 2	2,093	2,266
Faza 3	2,818	4,211
<b>Gjithsej vlera bruto</b>	<b>4,911</b>	<b>6,861</b>
Zhvlrësimi individual	(802)	(1,182)
Zhvlrësimi kolektiv	(1,773)	(2,043)
<b>Kreditë neto</b>	<b>2,336</b>	<b>3,636</b>

(Të gjitha shumat janë shprehur në mijë euro, përvec kur specifikohet ndryshe)

**9. Kreditë dhe paradhëniet për klientët (vazhdim)**

Përqendrimet e rrezikut sipas sektorit të ekonomisë brenda portofolit të kredive të klientëve janë si më poshtë:

	31 dhjetor 2018		31 dhjetor 2017	
	Kreditë neto	%	Kreditë neto	%
Individët	200,723	52%	185,710	50%
Energji elektrike, ngrohje, uje	507	1%	29	0%
Industri	25,224	7%	25,794	7%
Bujqësi	5,945	2%	5,033	1%
Shërbimet dhe të tjera	16,251	4%	15,941	6%
Hotele dhe restorante	9,523	2%	8,122	2%
Transport dhe komunikacion	5,039	1%	4,943	1%
Ndërtim	22,619	6%	18,903	5%
Tregti	97,476	25%	103,515	28%
<b>Kreditë neto ndaj bankave dhe klientëve</b>	<b>383,307</b>	<b>100%</b>	<b>367,990</b>	<b>100%</b>

Politikat e Bankës lidhur me marrjen e kolateralit nuk kanë ndryshuar dukshëm gjatë periudhës raportuese dhe nuk ka pasur ndryshime të rëndësishme në cilësinë e përgjithshme të kolateralit të mbajtur nga Banka që nga periodha e mëparshme.

Informacioni rreth kolateralit më 31 dhjetor 2018 është si vijon:

**Llojet e kolateralit**

	2018			2017		
	Individët	Entitetet ligjore	Gjithsej	Individët	Entitetet ligjore	Gjithsej
Hipoteka	47,407	297,269	344,676	35,004	308,693	343,697
Garanci në para	4,156	7,022	11,178	2,724	7,795	10,519
Mallrat dhe pajisjet e lena peng	180,325	386,053	566,378	119,112	348,044	467,156
Makina peng	10,192	37,561	47,753	6,250	35,510	41,760
<b>Gjithsej</b>	<b>242,080</b>	<b>727,905</b>	<b>969,985</b>	<b>163,090</b>	<b>700,042</b>	<b>863,132</b>

Efekti financiar i kolateralit paraqitet duke zbuluar vlerat e kolateralit veçmas për (i) ato aktive ku kolaterali dhe përmirësimet e tjera të kredisë janë të barabarta ose tejkalojnë vlerën bartëse të aktivitetit ("aktive të mbikolateralizuara") dhe (ii) ato aktive ku kolaterali dhe përmirësimet e tjera të kredisë janë më pak se vlera e bartur e aktivitetit ("aktivitetet e nënkolateralizuara").

Efekti i kolateralit më 31 dhjetor 2018:

	Aktivet e mbikolateralizuara		Aktivet e nen-kolateralizuara	
	Vlera e bartur e aktiveve	Vlera e drejtë e kolateralit	Vlera e bartur e aktiveve	Vlera e drejtë e kolateralit
Kredi për individët	130,037	241,732	74,707	258
Kredi ndaj entiteteve ligjore	171,530	721,358	18,915	6,637

Efekti i kolateralit më 31 dhjetor 2017:

	Aktivet e mbikolateralizuara		Aktivet e nen-kolateralizuara	
	Vlera e bartur e aktiveve	Vlera e drejtë e kolateralit	Vlera e bartur e aktiveve	Vlera e drejtë e kolateralit
Kredi për individët	96,480	162,648	77,180	442
Kredi ndaj entiteteve ligjore	191,939	697,296	10,912	2,746

(Të gjitha shumat janë shprehur në mijë euro, përveç kur specifikohet ndryshe)

**9. Kreditë dhe paradhëniet për klientët (vazhdim)**

Banka kryen vlerësimin e kolateralit në kohën e dhënies së kredive dhe përgjithësisht e përditëson atë çdo vit në varësi të ekspozimit të kredisë dhe/ose të ndryshimeve në treg të ndikuara nga faktorë të jashtëm. Vlera e drejtë e kolateralit të shpalosur më lart përcaktohet nga vlerësuesit e brendshëm dhe të jashtëm të certifikuar vendor dhe synon të përfaqësojë vlerën e tregut të realizueshme nga pronarët ligjorë të aktiveve. Për shkak të rrethanave në Kosovë, ku tregu nuk është aktiv, Banka zbaton një qasje të kujdesshme në përcaktimin e vlerës së këtyre kolateraleve; për këte arsye vlera e kolateraleve të konsideruara në këte shpalosje është vlera pasi është aplikuar një ulje në vlerë (haircut) prej 15-20% ndaj vlerësimit fillestar, në varënjer pesi të likuiditetit dhe cilësisë së aktivitetit të lenë peng. Banka synon të përdorë kolaterale që mund të konvertohen në aktive likuide brenda një periudhe relativisht të shkurtër kohore.

Shumat e papaguara kontraktuale të kredive dhe paradhënieve për klientët që janë shlyer që janë ende subjekt i veprimtarisë së përmbartimit, ishin si vijon më 31 dhjetor 2018:

	<b>31 dhjetor 18</b>
<b><i>Kredi për entitete ligjore</i></b>	<b>6,525</b>
Kredi	5,504
Paradhënie	1,021
Kredit Kartela	-
<b><i>Kredi për individët</i></b>	<b>204</b>
Kredi	204
Paradhënie	-
Kredit Kartela	-
<b>Gjithsej</b>	<b>6,729</b>

**10. Aktive të tjera financiare**

	<b>2018</b>	<b>2017</b>
<i>Jo- derivative:</i>		
Tarifa të arkëtueshme	1,596	1,419
Të arkëtueshme nga institucionet financiare	1,876	1,383
Aktive tjera financiare	164	214
<i>Derivative:</i>		
Kembime të huaja derivative	27	-
<b>Gjithsej</b>	<b>3,663</b>	<b>3,016</b>

Të arkëtueshmet nga institucionet financiare lidhen me tërheqjet ose pagesat e kryera nga kartela të huaja nëpërmjet POS ose ATM të TEB. Banka, sipas procedurave të saj, ka rezervuar provizionë për aktivet e tjera financiare që janë më të vjetra se 3 muaj (shih shënimin 17). Deri më 26 shkurt 2019, janë mbledhur 2,006 mijë euro të totalit të aktiveve të tjera financiare të regjistruara më 31 dhjetor 2018. Këmbimet valutore të derivativëve maten me vlerën e drejtë në fund të datës së raportimit. Këmbimet e huaja derivative dhe instrumentet financiare të tjera derivative në të cilat Banka është pale, në përgjithësi tregtohen në një treg të decentralizuar ku pjesëmarrësit tregtojnë direkt me njer tjetrin (over-the-counter-market) dhe ku pala tjetër pjesëmarrëse në tregtim është profesionale dhe ku termat dhe kushtet e marrëveshjeve janë të standardizuara. Instrumentet derivative kanë kushte potencialisht të favorshme (aktive) ose të pafavorshme (detyrime) si rezultat i luhatjeve në normat e interesit të tregut, normat e këmbimit valutore ose variablave të tjerë në lidhje me kushtet e tyre. Humbjet e pritshme kreditore për gjendjet e këmbimeve të huaja derivative janë jo materiale.

**11. Aktive të tjera**

	<b>2018</b>	<b>2017</b>
Akivet e riposeduara	1,367	1,412
Shpenzimet e parapaguara	178	151
Të tjera	254	86
<b>Gjithsej aktive të tjera</b>	<b>1,799</b>	<b>1,649</b>



**TEB SH.A.****Shënimet e pasqyrave financiare për vitin që përfundoi më 31 dhjetor 2018***(Të gjitha shumat janë shprehur në mijë euro, përvec kur specifikohet ndryshe)***11. Aktive të tjera (vazhdim)**

Në vitin 2018 Banka ka tatim në të ardhurat e korporatave të parapaguar në vlerë prej 174 mijë euro (2017: 735 mijë euro detyrim).

Lëvizjet në aktivet e riposeduara gjatë vitit janë paraqitur më poshtë:

	<b>2018</b>	<b>2017</b>
Gjendja në fillim të vitit	1,412	1,618
Shtesat	809	521
Shitjet	(175)	(312)
Aktivitet e zhvlersuara në vlerën neto të realizueshme	(679)	(375)
Aktivitet e shlyera	-	(40)
<b>Gjendja në fund të periudhës</b>	<b>1,367</b>	<b>1,412</b>

**12. Pasuri dhe pajisje**

	Toka	Përmirësime rë objektet me qira	Mobilje dhe pajisje	Kompjuter dhe pajisje të ngjajshme	Makina dhe pajisje motorike	Gjithsej
<b>Kosto</b>						
<b>Më 1 janar 2017</b>	<b>1,200</b>	<b>3,887</b>	<b>301</b>	<b>8,443</b>	<b>1,053</b>	<b>14,884</b>
Shtesat	-	412	494	1,085	-	1,991
Shitjet	-	(345)	-	-	(220)	(565)
<b>Më 31 dhjetor 2017</b>	<b>1,200</b>	<b>3,954</b>	<b>795</b>	<b>9,528</b>	<b>833</b>	<b>16,310</b>
Shtesat	-	839	338	821	57	2,055
Shitjet	-	(94)	(312)	(79)	-	(485)
<b>Më 31 dhjetor 2018</b>	<b>1,200</b>	<b>4,699</b>	<b>821</b>	<b>10,270</b>	<b>890</b>	<b>17,880</b>
<b>Zhvlersimi i akumuluar</b>						
<b>Më 1 janar 2018</b>	<b>-</b>	<b>3,513</b>	<b>274</b>	<b>6,106</b>	<b>838</b>	<b>10,731</b>
Ngarkimi për vitin	-	236	37	1,031	84	1,388
Shitjet	-	(345)	-	-	(220)	(565)
<b>Më 31 dhjetor 2018</b>	<b>-</b>	<b>3,404</b>	<b>311</b>	<b>7,137</b>	<b>702</b>	<b>11,554</b>
Ngarkimi për vitin	-	277	308	737	72	1,394
Shitjet	-	(94)	(312)	(77)	-	(483)
<b>Më 31 dhjetor 2018</b>	<b>-</b>	<b>3,587</b>	<b>307</b>	<b>7,797</b>	<b>774</b>	<b>12,465</b>
<b>Vlera e bartur</b>						
<b>Më 31 dhjetor 2017</b>	<b>1,200</b>	<b>550</b>	<b>484</b>	<b>2,391</b>	<b>131</b>	<b>4,756</b>
<b>Më 31 dhjetor 2018</b>	<b>1,200</b>	<b>1,112</b>	<b>514</b>	<b>2,473</b>	<b>116</b>	<b>5,415</b>

Ndërtimet në vazhdim përbëhen nga ndërtimi dhe renovimi i degëve të bankës në qytete të ndryshme të Kosovës. Ndërtimet në vazhdim janë përfshirë në kategorinë e përmirësimeve në objektet me qira dhe kostoja totale e tyre më 31 Dhjetor 2018 është 33 mijë Euro (2017: 10 mijë Euro).

Toka u ble në vitin 2013, me qëllim të përdorimit të saj për ndërtimin e një zyreje të re qendrore të Bankës. Qëllimi ka mbetur i pandryshuar që atëherë.

(Të gjitha shumat janë shprehur në mijë euro, përveç kur specifikohet ndryshe)

**13. Aktivet e patrupëzuara**

<i>Kosto</i>	<b>Programe</b>
Më 1 janar 2017	<b>6,500</b>
Shtesat	2,155
Shitje	(273)
<b>Më 31 dhjetor 2017</b>	<b>8,382</b>
Shtesat	1,983
Shitje	-
<b>Më 31 dhjetor 2018</b>	<b>10,365</b>
<b>Amortizimi i akumuluar</b>	
<b>Më 1 janar 2017</b>	<b>4,803</b>
Ngarkesa për vitin	1,738
Shitje	(232)
<b>Më 31 dhjetor 2017</b>	<b>6,309</b>
Ngarkesa për vitin	1,965
Shitje	-
<b>Më 31 dhjetor 2018</b>	<b>8,274</b>
<b>Vlera e mbartur</b>	
<b>Më 31 dhjetor 2017</b>	<b>2,073</b>
<b>Më 31 dhjetor 2018</b>	<b>2,091</b>

Të gjitha aktivet e patrupëzuara janë aktive te blera dhe amortizohen gjatë jetës së tyre të dobishme.

**14. Detyrimet ndaj klientëve**

	<b>2018</b>	<b>2017</b>
<b>Depozitat rrjedhëse</b>		
Individ	225,662	186,732
Entitete ligjore	121,518	105,778
	<b>347,180</b>	<b>292,510</b>
<b>Depozitat me afat</b>		
Individ	89,457	68,425
Entitete ligjore	18,842	20,156
	<b>108,299</b>	<b>88,581</b>
<b>Gjithsej detyrime ndaj klientëve</b>	<b>455,479</b>	<b>381,091</b>

Më 31 dhjetor 2018, llogaritë e klientëve përfshijnë interesa të përlllogaritur prej 800 mijë euro (2017: 1,038 mijë euro).

Depozitat me afat dhe llogaritë rrjedhëse sipas statusit ligjor si proporcion ndaj gjithsej detyrimeve ndaj klientëve janë si më poshtë:

	<b>2018</b>	<b>2017</b>
Individ	69%	67%
Entitete ligjore	31%	33%
	<b>100%</b>	<b>100%</b>

(Të gjitha shumat janë shprehur në mijë euro, përvec kur specifikohet ndryshe)

**15. Huamarrjet dhe borxhi i varur**

	<b>2018</b>	<b>2017</b>
<b>Huamarrjet</b>		
Hua	9,286	7,857
Tarifat e shtyra	(87)	(65)
Interesi i akumuluar	43	26
<b>Gjithsej huamarrje</b>	<b>9,242</b>	<b>7,818</b>
<b>Borxhi i varur</b>		
Hua	-	4,500
Tarifat e shtyra	-	(55)
Interesi i akumuluar	-	10
<b>Gjithsej borxhi i varur</b>	<b>-</b>	<b>4,455</b>
<b>Gjithsej huamarrjet dhe borxhi i varur</b>	<b>9,242</b>	<b>12,273</b>
	<b>2018</b>	<b>2017</b>
Vlera e bartur në 1 janar	12,273	17,522
Të ardhurat nga huazimet	3,000	-
Ripagimi i huazimeve	(6,071)	(5,286)
Ndryshimi në tarifat e shtyra	32	33
Ndryshimi në interesin e përlogaritur	8	4
<b>Gjithsej huamarrjet dhe borxhi i varur</b>	<b>9,242</b>	<b>12,273</b>

Gjatë vitit 2013, Banka hyri në një marrëveshje huaje të varur me Korporatën Financiare Ndërkombëtare ("IFC") në shumën 4,500 mijë euro. Qëllimi i kësaj huaje është që të sigurojë Bankën me Kapital të klasit 2, dhe t'i mundësojë Bankës të përdorë të ardhurat për financimin e aktiviteteve të saj të kreditimit. Kredia ishte plotësisht e parapaguar në maj 2018.

Në vitin 2015 dhe 2016, Banka ka lidhur tre marrëveshje huazimi me Bankën Europianë për Rindertim dhe Zhvillim (BERZH) për një shumë totale prej 8,000 mijë Euro.

Qëllimi i këtyre huave është financimi i kredive për të promovuar Gratë Sipërmarrëse.

Në vitin 2018, Banka nënshkroi marrëveshje me BERZH për një shumë të përgjithshme prej 5,000 mijë eurosh të ndara në dy këste, kesti A prej 3,000 mijë EUR dhe kesti B në shumë prej 2,000 mijë Euro. Kesti i dytë prej 2,000 mijë Euro është i pakushtezuar. Qëllimi i këtyre huave është financimi i kredive për efikasitet energjetik.

**16. Detyrime të tjera financiare**

	<b>2018</b>	<b>2017</b>
Transferet e fondeve të klientëve në transit	1,274	2,339
Detyrime ndaj furnitorëve	800	914
Bonuset e kredit kartelave të pagueshme	676	751
Bonuse për stafin	560	554
Parapagimet për kredit kartelat	95	729
SMS banking	109	98
<b>Gjithsej detyrime të tjera financiare</b>	<b>3,514</b>	<b>5,385</b>

- Dështimi për të paguar shumën e interesit ose të principalit në institucionet e tjera financiare, subjekt i pragjeve të caktuara;
- Vështirësitë e likuiditetit të kredimarrësit
- Shkelja e kushteve dhe kushtezimeve kontraktuale;
- Kredimarrësi konsideron falimentimin ose riorganizimin financiar;
- Përkeqësimi i kushteve ekonomike dhe të tregut.
- Përkeqësimi i vlerësimit të brendshëm kreditor
- Masa të riskstrukturimit janë marre për kredimarrësin.

Vlerësimi kolektiv përcaktohet duke u bazuar në një model të rrezikut të kredisë që merr parasysh normën historike prej 5 vitesh për çdo segment ("PD") dhe faktorin e humbjes së dhenë kreditorë ("LGD"). Faktori i PD rezulton nga ngjarjet të mundshme të dështimit brenda 12 muajve të ardhshëm dhe llogaritet ndaras për katër kategori të ndryshme të dështimit. LGD (norma e ripagesave) është vëzhguar për një periudhë prej 24 dhe 36 muajsh varësisht nga faza e kredisë. Të dhënat e futura në model përditësohen çdo 6 muaj për pesë segmente të veçanta (kreditë për individ, kreditë për ndermarrje të vogla dhe të mesme (SME), kreditë e dhëna tek entitetet ligjora/korporatat, kreditë bujqesore dhe kredit kartelat). Në fund, vlerat skontohen me normën efektive të interesit (NEI) për secilin kredi/ekspozim, ndërsa për paradhëniet dhe kredit kartelat llogaritet një faktor i posaçëm i normës së skontimit. Normat përfundimtare të llogaritjes së humbjes së kredisë që rrjedhin nga modeli janë, në instance të fundit, subjekt i aprovimit nga Komiteti i Menaxhimit të Riskut ("RMC") dhe Bordit të Drejtorëve ("BoD"). Në fund, duke përdorur ekuacionin e (EAD x PD x LGD x DF) shumat përfundimtare të ECL llogariten.

Normat e rimarrjeve (recovery rates) llogariten bazuar në vëzhgimin 36 mujor për kreditë në Fazat 1 dhe 2, ndërsa për ekspozimet kreditorë të Fazës 3 me ekspozim <50,000 EUR në datën e dështimit, zbatohen normat 24 muajshe të ripagesave. Për më tepër, për ekspozimet kreditorë me maturim të mbetur më pak se 1 vit ose për ato pa afat maturimi, llogariten norma e 12-mujore të dështimit dhe humbja e pritshme e kredisë (ECL) llogaritet.

Për ekspozimet në fazën 3, > 50,000 EUR, Departamenti i Arkëtimit do të vlerësojë arkëtimet e parasë së gatshme për secilin rast individualisht dhe për secilin ekspozim kreditor bazuar në pritjet e likuidimit të kolateralit ose ndonjë burimi tjetër të fluksit të mjeteve monetare. Parashikimi i arkëtimit bazohet në vlerësimet e kujdesshme dhe reale dhe duhet të bazohet në faktorët e mëposhtëm të kredisë: vlera e tregut të kolateralit dhe likuiditeti i tij, rrjedha historike e mjeteve monetare, kapaciteti pagues i garantuesit/bashkë kredimarrësit, kohëzgjatja për likuidimin/riposedimin e pronave dhe ambienti ligjor i shtetit si faktor i jashtëm. Vlerësimi i arkëtimit në para të gatshme mund të mbulojë një periudhë prej pesë vjetësh që do të skontohet me një NEI ose një parafrim të saj.

*Kreditë e ristrukturuara* do të klasifikohen në fazën 2 nëse ekspozimi konsiderohet të jete performues në datën kur janë marre masat, përndryshe kredia do të mbetet në Fazën 3.

Për ekspozimet jo-performuese në fazën 3, kriteret 24 muajshe të daljes për tu transferuar në fazën 2 plus 12 muaj shtesë si periudhë provuese, për transferimin në fazën 1 do të respektohen. Në total monitorimi prej 36 muaj do të zbatohet për transferimin në Fazën 1 të një kredie jo performuese në fazën 3. Për kreditë performuese në Fazën 2 do të respektohen kriteret 24 muajshe të transferimit në Fazën 1. Në të dyja rastet, dite vonesat për një kësht të vetëm duhet të jetë më pak se 30 ditë vonesë për të gjithë periudhën e monitorimit dhe pagesa të rregullta duhet të jenë bërë të paktën gjatë gjysmës së periudhës së provës, përndryshe periudha e provës do të rifillojë nga zero dhe faza e mëparshme do të mbahet.

Nëse, në një periudhë pasuese, shuma e humbjes nga zhvlerësimi zvogëlohet dhe rënia mund të lidhet objektivisht me një ngjarje që ndodh pas njohjes së zhvlerësimit (si një përmirësim në vlerësimin kreditor të kredimarrësit), humbja e zhvlerësimit e njohur më parë kthehet mrapst duke rregulluar llogarinë e zhvlerësimit të kredive. Shuma e kthimit njihet në pasqyren e fitimit ose humbjes.

### ***Zhvlerësimi i aktiveve financiare të klasifikuara si të mbajtura për të arkëtuar dhe shitur (të klasifikuar më parë si aktive financiare të gatshme për shitje)***

Për mjetet financiare të matura në FVOCI, PD rregullatore dhe PD përkatëse bazuar në vlersimet e Grupit përdoren për raportimin e grupit, ndërsa për raportimin e pavarur të SNRF për këto aktive banka do të përdorë min PD prej 0.05% që është qasja Basel IRB. Nga ana tjetër, për aktivet financiare që mbahen për tu arkëtuar dhe shitur dhe për ekspozimin e kredive ndaj bankave, duke përfshirë obligacionet qeveritare dhe gjendjet me Bankën Qendrore, banka do të aplikojë 45% të LGD siç është përcaktuar në qasjen Basel IRB ndërsa për raportimin financiar grupor banka do të aplikojë normen e ripageses (recovery rate) të përcaktuar nga grupi, prej 60% ose 40% të LGD-së për valutat vendase.

**TEB SH.A.****Shënimet e pasqyrave financiare për vitin që përfundoi më 31 dhjetor 2018***(Të gjitha shumat janë shprehur në mijë euro, përveç kur specifikohet ndryshe)***29. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)****Rreziku i kredisë (vazhdim)****Ekspozimi maksimal ndaj rrezikut të kredisë:**

<b>Më 31 dhjetor 2018</b>	<b>Ekspozimi maksimal bruto</b>	<b>Humbjet e pritshme kreditore</b>	<b>Ekspozimi maksimal neto</b>
Paraja dhe llogaritë rrjedhëse me bankat	63,898	(15)	63,883
Kredi dhe paradhënie për bankat	54,341	(102)	54,239
<b>Kredi për individët</b>	<b>204,978</b>	<b>(4,259)</b>	<b>200,719</b>
Kredi për klientët	172,013	(3,204)	168,809
Paradhëniet	2,199	(94)	2,105
Kredit kartelat	30,766	(961)	29,805
<b>Kredi për entitete ligjore</b>	<b>190,212</b>	<b>(7,624)</b>	<b>182,588</b>
Kredi për entitete ligjore	156,032	(6,518)	149,514
Paradhëniet	30,483	(991)	29,492
Kredit kartelat	3,697	(115)	3,582
<b>Gjithsej kredi dhe paradhënie për klientët</b>	<b>395,190</b>	<b>(11,883)</b>	<b>383,307</b>
<b>Investimet në letra me vlerë</b>	<b>16,257</b>	<b>(3)</b>	<b>16,254</b>
Leter kreditë	1,385	(6)	1,379
Letrat e garancioneve	6,407	(26)	6,381
Garanci dhe dëmshpërblime të tjera	89	-	89
Angazhimet kreditore	78,790	(285)	78,505
<b>Detyrimet kontigjente (te mundshme)</b>	<b>86,671</b>	<b>(317)</b>	<b>86,354</b>

<b>Më 31 dhjetor 2017</b>	<b>Ekspozimi maksimal bruto</b>	<b>Humbjet e pritshme të kredisë</b>	<b>Ekspozimi maksimal neto</b>
Paraja dhe llogaritë rrjedhëse me bankat	68,439	-	68,439
Kredi dhe paradhënie për bankat	5,975	-	5,975
<b>Kredi për individët</b>	<b>187,688</b>	<b>(1,978)</b>	<b>185,710</b>
Kredi për klientët	156,142	(1,526)	154,616
Paradhëniet	2,131	(60)	2,071
Kredit kartelat	29,415	(392)	29,023
<b>Kredi për entitete ligjore</b>	<b>188,823</b>	<b>(6,543)</b>	<b>182,280</b>
Kredi për entitete ligjore	147,751	(5,759)	141,992
Paradhëniet	37,689	(722)	36,967
Kredit kartelat	3,383	(62)	3,321
<b>Gjithsej kredi dhe paradhënie për klientët</b>	<b>376,511</b>	<b>(8,521)</b>	<b>367,990</b>
<b>Aktive financiare të gatshme për shitje</b>	<b>15,407</b>	<b>-</b>	<b>15,407</b>
Leter kreditë	813	(4)	809
Letrat e garancioneve	7,378	-	7,378
Garanci dhe dëmshpërblime të tjera	1	-	1
Angazhimet kreditore	70,921	-	70,921
<b>Detyrimet kontigjente (te mundshme)</b>	<b>79,113</b>	<b>(4)</b>	<b>79,109</b>

(Të gjitha shumat janë shprehur në mijë euro, përveç kur specifikohet ndryshe)

**29. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)****Rreziku i kredisë (vazhdim)****Përqendrimi sipas gjeografisë**

Më poshtë paraqiten ekspozimet kryesore të Bankës për regjionin gjeografik më 31 dhjetor 2018 dhe 2017. Banka ka ndarë ekspozimet në regjione, bazuar në vendin e banimit të palëve të treta.

Gjithsej aktivet financiare	Vendet e			Gjithsej 2018	Vendet e		Gjithsej 2017
	OECD	Kosova	Të tjera		OECD	Kosova	
Paratë e gatshme dhe gjendjet me BQK-në	26,415	62,079	-	88,494	18,351	69,302	87,653
Kreditë dhe paradhënie për bankat	29,294	15,956	8,989	54,239	2,973	3,002	5,975
Kreditë dhe paradhënie për klientët	-	383,307	-	383,307	-	367,990	367,990
Investime në letra me vlerë	-	16,254	-	16,254	-	15,407	15,407
Aktive të tjera financiare	-	3,663	-	3,663	-	3,016	3,016
<b>Gjithsej</b>	<b>55,709</b>	<b>481,259</b>	<b>8,989</b>	<b>545,957</b>	<b>21,324</b>	<b>458,717</b>	<b>480,041</b>

**Detyrimet financiare**

Detyrime ndaj klientëve	-	455,479	-	455,479	-	381,091	381,091
Huamarrjet	-	9,241	-	9,241	-	7,818	7,818
Borxhi i varur	-	-	-	-	4,455	-	4,455
Detyrime të tjera financiare	-	3,514	-	3,514	-	5,385	5,385
<b>Gjithsej detyrimet</b>	<b>-</b>	<b>468,234</b>	<b>-</b>	<b>468,234</b>	<b>4,455</b>	<b>394,294</b>	<b>398,749</b>

**Shlyerjet**

Shlyerjet përcaktohen si zvogëlimi kontabël i një borxhi, që nuk nënkupton heqjen dorë nga kërkesa ligjore kundër debitorëve dhe, kështu, borxhi mund të rikuperohet. Propozimet për heqjen (e plotë ose të pjesshme) të borxheve mund të dorëzohen në komisionin kompetent me kusht që të kryhen procedura të caktuara.

Banka Qendrore e Kosovës ka publikuar një rregullore të re për Menaxhimin e Rrezikut të Kredisë që është në fuqi nga data 30 qershor 2017. Rregullorja e BQK-së përcakton kriteret për shlyerjet e kredive të klasifikuara si humbje dhe e cila merr në konsideratë edhe llojin e kolateralit. Banka ka ndryshuar politikën e saj të brendshme për të siguruar përputhjen me kërkesat e reja.

**Rreziku i likuiditetit**

Rreziku i likuiditetit lind në financimin e përgjithshëm të aktiviteve të Bankës dhe në menaxhimin e pozicioneve. Ai përfshin si rrezikun e të qenurit i paaftë për të financuar aktivet në afatet dhe normat e duhura dhe rrezikun për të mos qenë në gjendje të likuidojë një aktiv me një çmim të arsyeshëm dhe në një afat kohor të përshtatshëm për të përmbushur detyrimet. Banka monitoron likuiditetin e saj në baza ditore, mujore dhe tremujore, në mënyrë që të menaxhojë detyrimet e saj si dhe kur ato bien.

Banka përdor këto raporte për qëllime të menaxhimit të likuiditetit:

- Raporti i rrjedhës së parasë dhe raportet e likuiditetit të parashikuara nga rregullorja e BQK-së (> 25% dhe > 20%): në baza ditore
- Raporti i Mbulimit të Likuiditetit dhe Raportet GAP të likuiditetit: në baza mujore
- ALCo dhe raportimi i nivelit të Bordit: baza tremujore.

Raporti i hendeut të likuiditetit (Raporti GAP) përgatitet nga Departamenti i Riskut duke përdorur sjelljet normave të rrjedhës së parasë dhe limitet e aprovuara nga BoD. Për me teper, Banka gjithashtu përdor raportet e BQK-se për likuiditet. Një ekspozim kreditor me fond total prej 35 milionë eurosh është në dispozicion nga TEB A.S. për të mbuluar nevojat e likuiditetit të Bankës.

Fondet janë ngritur duke përdorur një lloj të gjerë instrumentesh përfshirë depozitat, huamarrjet dhe kapitalin aksionar. Kjo rrit fleksibilitetin e financimit, kufizon varësinë nga çdo burim fondesh dhe në përgjithësi ul koston e fondeve. Banka bën përpjekjet e saj më të mira për të mbajtur një ekuilibër ndërmjet vazhdimësisë së financimit dhe fleksibilitetit nëpërmjet përdorimit të detyrimeve me maturime të ndryshme.

Banka vazhdimisht vlerëson rrezikun e likuiditetit duke identifikuar dhe monitoruar ndryshimet në financimin e kërkuar për përmbushjen e qëllimeve të biznesit dhe objektivave të përcaktuara në aspektin e strategjisë së përgjithshme të Bankës. Përveç kësaj, Banka mban një portofol të aktiveve likuide si pjesë e strategjisë së saj të administrimit të rrezikut të likuiditetit.

Menaxhmenti është duke monitoruar raportet e likuiditetit ndaj kërkesave të brendshme dhe rregullative në baza ditore, javore dhe mujore. Si rezultat, Menaxhmenti beson se Banka nuk ka hendeq afatshkurtër të likuiditetit.

**TEB SH.A.****Shënimet e pasqyrave financiare për vitin që përfundoi më 31 dhjetor 2018***(Të gjitha shumat janë shprehur në mijë euro, përveç kur specifikohet ndryshe)***29. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)****Rreziku i likuiditetit (vazhdim)**

Shuma e shpalosur në tabelat e mëposhtme është flukset monetare të skontuara kontraktuale:

<b>31 dhjetor 2018</b>	<b>Vlera e bartur</b>	<b>Hyrjet/ (daljet) bruto</b>	<b>Më pak se 1 muaj</b>	<b>1-3 muaj</b>	<b>3 -12 muaj</b>	<b>1-5 vite</b>	<b>Më shumë se 5 vite</b>
<b>Aktivët financiarë</b>							
Paraja dhe llogaritë rrjedhëse me bankat	88,478	88,478	88,478	-	-	-	-
Kreditë dhe paradhënie për bankat	54,239	54,239	54,239	-	-	-	-
Kredi për klientët	383,307	423,854	55,852	27,894	111,499	213,459	15,150
Investime në letra me vlerë	16,254	16,756	261	2,782	9,678	3,724	311
Aktive të tjera financiare	3,663	3,663	3,663	-	-	-	-
<b>Gjithsej aktive financiare</b>	<b>545,941</b>	<b>586,990</b>	<b>202,493</b>	<b>30,676</b>	<b>121,177</b>	<b>217,183</b>	<b>15,461</b>
<b>Detyrimet financiare</b>							
Detyrime ndaj klientëve	455,479	457,659	350,123	7,167	54,580	45,784	5
Huazimet dhe borxhi i varur	9,242	9,624	-	-	2,399	7,225	-
Detyrime të tjera financiare	3,514	3,514	3,514	-	-	-	-
<b>Gjithsej detyrimet</b>	<b>468,235</b>	<b>470,797</b>	<b>353,637</b>	<b>7,167</b>	<b>56,979</b>	<b>53,009</b>	<b>5</b>
Zotimet dhe garancitë e papërdorura të kredisë	86,670	86,670	86,670	-	-	-	-
<b>Gjithsej detyrimet dhe angazhimet financiare</b>	<b>554,905</b>	<b>557,467</b>	<b>440,307</b>	<b>7,167</b>	<b>56,979</b>	<b>53,009</b>	<b>5</b>
<b>Hendeku pozitiv/(negativ)</b>	<b>(8,964)</b>	<b>29,523</b>	<b>(237,814)</b>	<b>23,509</b>	<b>64,198</b>	<b>164,174</b>	<b>15,456</b>
<b>31 dhjetor 2017</b>							
<b>Aktivët financiarë</b>							
Paraja dhe llogaritë rrjedhëse me bankat	87,653	87,653	87,653	-	-	-	-
Kreditë dhe paradhënie për bankat	5,975	5,975	5,975	-	-	-	-
Kredi për klientët	367,990	403,263	54,567	26,536	108,257	194,271	19,632
Aktive financiare të gatshme për shitje	15,407	15,511	-	3,994	7,667	3,850	-
Aktive të tjera financiare	3,016	3,016	3,016	-	-	-	-
<b>Gjithsej aktive financiare</b>	<b>480,041</b>	<b>515,418</b>	<b>151,211</b>	<b>30,530</b>	<b>115,924</b>	<b>198,121</b>	<b>19,632</b>
<b>Detyrimet financiare</b>							
Detyrime ndaj klientëve	381,091	382,666	299,198	6,946	45,500	30,687	335
Huazimet dhe borxhi i varur	12,273	14,034	-	-	1,761	12,273	-
Detyrime të tjera financiare	5,385	5,385	5,385	-	-	-	-
<b>Gjithsej detyrimet</b>	<b>398,749</b>	<b>402,085</b>	<b>304,583</b>	<b>6,946</b>	<b>47,261</b>	<b>42,960</b>	<b>335</b>
Zotimet dhe garancitë e papërdorura të kredisë	79,113	79,113	79,113	-	-	-	-
<b>Gjithsej detyrimet dhe angazhimet financiare</b>	<b>477,862</b>	<b>481,198</b>	<b>383,696</b>	<b>6,946</b>	<b>47,261</b>	<b>42,960</b>	<b>335</b>
<b>Hendeku pozitiv/(negativ)</b>	<b>2,179</b>	<b>34,220</b>	<b>(232,485)</b>	<b>23,584</b>	<b>68,663</b>	<b>155,161</b>	<b>19,297</b>

(Të gjitha shumat janë shprehur në mijë euro, përvec kur specifikohet ndryshe)

**29. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)****Rreziku i likuiditetit (vazhdim)**

Për qëllime likuiditeti, Banka klasifikon depozitat rrjedhëse dhe të kursimeve si detyrime aftatshkurtër dhe të maturuara brenda një muaji. Si rezultat, hendeku kontraktual i likuiditetit deri në dymbëdhjetë muaj është rritur. Megjithatë, mundësia që sasi të mëdha të depozitave të klientëve të largohen nga Banka është e vogël. Prandaj, Banka nuk konsideron të ketë ndonjë hendek të likuiditetit në afat të shkurtër.

**30. Vlera e drejtë e instrumenteve financiare**

Matjet e vlerës së drejtë analizohen sipas nivelit në hierarkinë e vlerës së drejtë si vijon: (i) niveli i parë janë matjet me çmime të kuotuarra (të parregulluara) në tregjet aktive për aktivet ose detyrimet identike, (ii) matjet e nivelit të dytë janë teknikat e vlerësimit me të gjitha inputet materiale të vezhgueshme për aktivin ose detyrimin, ose drejtëpërdrejt (si psh çmimet) ose terthorazi (që buron nga çmimet) dhe (iii) matjet e nivelit të tretë janë vlerësime që nuk janë të bazuara në të dhënat e vëzhgueshme të tregut (ato që nuk vërehen në treg). Menaxhmenti aplikon gjykimin për kategorizimin e instrumenteve financiare duke përdorur hierarkinë e vlerës së drejtë. Nëse një matje e vlerës së drejtë përdor inpute të vezhgueshme që kërkojnë rregullim të rëndësishëm, kjo matje është një matje e Nivelit 3. Rëndësia e një inputi të vlerësimit vlerësohet në matjen e vlerës së drejtë në tërësinë e saj.

**Instrumentet financiare që nuk maten me vlerën e drejtë por për të cilën është shpalosur vlera e drejtë**

Tabela e mëposhtme përcakton vlerat e drejta të instrumenteve financiare që nuk maten me vlerën e drejtë dhe i analizon ato sipas nivelit në hierarkinë e vlerës së drejtë në të cilën kategorizohet çdo matje e vlerës së drejtë.

	Vlera e bartur	2018			2017		
		Niveli 1	Niveli 2	Niveli 3	Niveli 1	Niveli 2	Niveli 3
<b>Aktivët Financiare</b>							
Paraja dhe llogaritë rrjedhëse me bankat	<b>88,478</b>	88,478	-	-	<b>87,653</b>	87,653	-
Kredi dhe paradhënie për bankat	<b>54,239</b>	-	54,239	-	<b>5,975</b>	-	5,975
Kredi dhe paradhënie për klientët	<b>383,307</b>	-	-	381,525	<b>367,990</b>	-	-
<i>Kredi dhe paradhënie për klientët</i>	<i>200,719</i>	-	-	<i>199,602</i>	<i>185,710</i>	-	-
<i>Kredi dhe paradhënie për individët</i>	<i>182,588</i>	-	-	<i>181,923</i>	<i>182,280</i>	-	-
Aktive të tjera financiare	<b>3,663</b>	-	-	3,663	<b>3,016</b>	-	-
<b>Detyrimet financiare</b>							
Detyrime ndaj klientëve	<b>455,479</b>	-	-	455,788	<b>381,091</b>	-	-
Borxhi i varur	-	-	-	-	<b>4,455</b>	-	-
Huamarrjet	<b>9,242</b>	-	-	9,242	<b>7,818</b>	-	-
Detyrime të tjera financiare	<b>3,514</b>	-	-	2,954	<b>5,385</b>	-	-

Kur është e mundur, vlera e drejtë e kredive dhe paradhënieve bazohet në transaksionet e vezhgueshme të tregut. Kur transaksionet e vezhgueshme të tregut nuk janë të disponueshme, vlera e drejtë llogaritet duke përdorur modele vlerësimi, siç janë teknikat e flukseve monetare të skontuara. Informacioni i përdorur në metodat e vlerësimit përfshin humbjet e pritura kreditore gjatë jetës, normat e interesit dhe normat e parapagimit. Për të përmirësuar saktësinë e metodës së vlerësimit për kreditë tregtare me pakicë dhe të vogla, kreditë homogjenë janë grupuar në portofole me karakteristika të ngjashme.

Kreditë dhe paradhëniet për bankat, si dhe aktivet dhe detyrimet e tjera financiare, përfshijnë plasmanet ndërbankare dhe zërat që janë në arkëtim e sipër. Pasi që gjendet e tilla janë afatshkurtra, vlera e drejtë e tyre konsiderohet të përafrojtë vlerën e tyre kontabël.

*(Të gjitha shumat janë shprehur në mijë euro, përveç kur specifikohet ndryshe)***30. Vlera e drejtë e instrumenteve financiare (vazhdim)**

Vlera e drejtë e depozitave dhe kredive nga bankat dhe klientët vlerësohet duke përdorur teknika të flukseve monetare të zbitura, duke zbatuar normat që ofrohen për depozita me maturime dhe afate të ngjashme. Vlera e drejtë e depozitave të pagueshme sipas kërkesës është shuma e pagueshme në datën e raportimit.

Nuk ka blerje ose shitje në aktivet financiare të nivelit 3, dhe ndryshimi në vlerën e bartur është rezultat i ndryshimit në vlerën e drejtë

***Instrumentet financiare të matura në vlerë të drejtë në baza të përsëritura***

Matjet e përsëritura të vlerës së drejtë janë ato që standardet e kontabilitetit kërkojnë ose lejojnë në pasqyrën e pozicionit financiar në fund të çdo periudhe raportuese.

Tabela në vijim analizon instrumentet financiare të matura me vlerën e drejtë në datën e raportimit, sipas nivelit në hierarkinë e vlerës së drejtë në të cilën kategorizohet matja e vlerës së drejtë. Shumat bazohen në vlerat e njohura në pasqyrën e pozicionit financiar.

Aktive financiare të gatshme për shitje janë aktive që sjellin interes. Për shkak se nuk ekziston një treg aktiv për bonot dhe obligacionet e thesarit, vlera e drejtë është vlerësuar duke përdorur një model të flukseve të mjeteve monetare të zbitura bazuar në një kurbë aktuale të fitimit të përshtatshme për periudhën e mbetur deri në maturim dhe ato klasifikohen në Nivelin 2.

	<b>2018 Vlera e drejtë</b>	<b>Niveli 2</b>	<b>2017 Vlera e drejtë</b>	<b>Niveli 2</b>
<b>Aktivitet financiare jo-derivative</b>				
Aktive financiare të gatshme për shitje	16,254	16,254	15,407	15,407
<b>Aktive financiare derivative</b>				
Këmbimet e huaja derivative	27	27	-	-
<b>Gjithsej</b>	<b>16,281</b>	<b>16,281</b>	<b>15,407</b>	<b>15,407</b>



(Të gjitha shumat janë shprehur në mijë euro, përveç kur specifikohet ndryshe)

**31. Paraqitja e instrumenteve financiare sipas kategorisë së matjes**

Për qëllime të matjes, SNRF 9 "Instrumentet Financiare" klasifikon aktivet financiare në kategoritë e mëposhtme: (a) aktivet financiare në FVTPL; (b) instrumente borxhi në FVOCI, (c) instrumente kapitali në FVOCI dhe (d) aktive financiare të matura me kosto të amortizuara (AC). Aktivet financiare në FVTPL kanë dy nënkategori: (i) aktivet e matura në mënyrë të detyrueshme në FVTPL dhe (ii) aktivet e përcaktuara si të tilla pas njohjes fillestare ose më vonë.

Për qëllimet e matjes më 31 dhjetor 2017, sipas kërkesave të SNK 39 "Instrumentet Financiare: Njohja dhe Matja", aktivet financiare janë klasifikuar në kategoritë e mëposhtme: (a) kreditë dhe të arketueshmet (L&R); (b) aktivet financiare të gatshme për shitje (AFS); (c) aktivet financiare të mbajtura deri në maturim (HTM) dhe (d) aktivet financiare në FVTPL ("FVTPL"). Aktivet financiare në FVTPL kishin dy nën-kategori: (i) aktivet e përcaktuara si të tilla me njohjen fillestare, dhe (ii) ato të klasifikuara si të mbajtura për tregtim.

31 dhjetor 2018	FVTPL (e detyruesh me)	FVTPL	Instrume ntet e borxhit në FVOCI	Instrume ntet e kapitalit në FVOCI	AC	Gjithsej
Paraja dhe llogaritë rrjedhëse me bankat	-	-	-	-	63,883	63,883
Kredi dhe paradhënie për bankat	-	-	-	-	54,239	54,239
Aktive të tjera financiare	-	-	-	-	3,663	3,663
<b>Kredi për individët</b>	-	-	-	-	<b>200,719</b>	<b>200,719</b>
Kredi për klientët	-	-	-	-	168,809	168,809
Paradhënie	-	-	-	-	2,105	2,105
Kredit kartelat	-	-	-	-	29,805	29,805
<b>Kredi për entitete ligjore</b>	-	-	-	-	<b>182,588</b>	<b>182,588</b>
Kredi për entitete ligjore	-	-	-	-	149,514	149,514
Paradhënie	-	-	-	-	29,492	29,492
Kredit kartelat	-	-	-	-	3,582	3,582
<b>Gjithsej kredi dhe paradhënie për klientët</b>	-	-	-	-	<b>383,307</b>	<b>383,307</b>
<b>Investime në letra me vlerë</b>	-	-	<b>16,254</b>	-	-	<b>16,254</b>
Bonot e Thesarit të Qeverisë së Kosovës	-	-	10,303	-	-	10,303
Obligacionet e Qeverisë së Kosovës	-	-	5,951	-	-	5,951
<b>Gjithsej aktivet financiare</b>	-	-	<b>16,254</b>	-	<b>505,092</b>	<b>521,346</b>

**32. Ngjarjet pas përfundimit të periudhës raportuese**

Bordi drejtues së bashku me aksionerët e bankës kanë vendosur të shpërndajnë dividend gjatë vitit 2019 në vlerë prej 30 milionë eurosh.

Nuk ka ngjarje të tjera pas periudhës së raportimit që do të kërkonin rregullime ose dhënie shtesë të informacioneve shpjeguese në këto pasqyra financiare.

*(Të gjitha shumat janë shprehur në mijë euro, përveç kur specifikohet ndryshe)*

### **33. Politikat e kontabilitetit të zbatuara deri me 1 janar 2018**

#### **Instrumentet financiare - Termat kyçe të matjes**

Në varësi të klasifikimit, instrumentet financiare mbahen në vlerën e drejtë ose në koston e amortizuar siç përshkruhet më poshtë.

**Matja e vlerës së drejtë** Vlera e drejtë është çmimi me të cilin aktivi mund të shitet ose të transferohet në një transaksion të zakonshëm mes pjesëmarrësve në treg në datën e matjes. Dëshmia më e mirë e vlerës së drejtë është çmimi në një treg aktiv. Treg aktiv është ai ku transaksionet për aktivin ose detyrimin ndodhin me frekuencë dhe volum të mjaftueshëm për të siguruar informata të çmimeve në mënyrë të vazhdueshme.

Banka mat vlerën e drejtë të një instrumenti duke përdorur çmimin e kuotuar në një treg aktiv për atë instrument. Tregu konsiderohet si aktiv nëse transaksionet për aktivin ose detyrimin zhvillohen me frekuencë dhe vëllim të mjaftueshëm për të siguruar informacionin rreth çmimeve në baza të vazhdueshme. Nëse nuk ka çmim të kuotuar në një treg aktiv, atëherë Banka përdor teknikat e vlerësimit që maksimizojnë përdorimin e inputeve përkatëse të vëzhgueshme dhe minimizojnë përdorimin e inputeve që nuk vëzhgohen. Teknika e zgjedhur e vlerësimit përfshin të gjithë faktorët që pjesëmarrësit e tregut do të merrnin parasysh në vendosjen e çmimit të një transaksioni.

Dëshmia më e mirë e vlerës së drejtë të një instrumenti financiar në njohjen fillestare është zakonisht çmimi i transaksionit - dmth. vlera e drejtë e shumës së dhënë ose të marrë. Nëse Banka përcakton që vlera e drejtë në njohjen fillestare ndryshon nga çmimi i transaksionit dhe vlera e drejtë nuk evidentohet as nga një çmim i kuotuar në një treg aktiv për një aktiv apo detyrim identik, ose të bazuar në një teknikë vlerësimi që përdor vetëm të dhënat nga vrotimi tregjeve, atëherë instrumenti financiar fillimisht matet me vlerën e drejtë, të rregulluar për të shtyrë diferencën midis vlerës së drejtë në njohjen fillestare dhe çmimin e transaksionit.

Më pas, ky ndryshim njihet në fitim ose humbje në një bazë të përshtatshme gjatë jetës së instrumentit, por jo më vonë se kur vlerësimi mbështetet tërësisht nga të dhënat e tregut të vëzhgueshëm ose kur transaksioni mbyllet. Banka nuk ka instrumente ku vlera e drejtë në njohjen fillestare ndryshon nga çmimi i transaksionit.

Nëse një aktiv apo detyrim i matur me vlerën e drejtë ka një çmim të ofertës dhe një çmim të kërkesës, atëherë Banka mat aktivet dhe pozicionet e gjata me çmimin e ofertes, dhe detyrimet dhe pozicionet e shkurtra në një çmim të kërkesës.

Vlera e drejtë e depozitës së kërkuar e cila nuk është më e vogël se shuma e pagueshme sipas kërkesës, e zbritur nga data e parë në të cilën shuma kërkohet të paguhet.

Banka njeh transfertat midis niveleve të hierarkisë së vlerës së drejtë deri në fund të periudhës raportuese gjatë së cilës ka ndodhur ndryshimi.

**Kostoja e amortizuar** është vlera me të cilën instrumenti financiar matet në njohjen fillestare, minus pagesat e principalit, plus interesi i akumuluar, dhe për aktivet financiare, minus zhvlerësimi për humbjet nga rënia e vlerës. Interesi i akumuluar përfshin amortizimin e koston të shtyrë të transaksionit në njohjen fillestare dhe çdo premi ose zbritje për shumën e maturimit, duke përdorur metodën e interesit efektiv. Të ardhurat e interesit të akumuluar dhe shpenzimet e interesit të akumuluar, duke përfshirë edhe kuponët e akumuluar dhe zbritjen e amortizuar ose primet (duke përfshirë tarifën e shtyra fillestare, nëse ka) nuk paraqiten të ndara dhe përfshihen në vlerat e bartura të zërave përkatës në pasqyrën e pozicionit financiar.

**Metoda e interesit efektiv** është një metodë e alokimit të të ardhurave nga interesi ose shpenzimeve të interesit gjatë periudhës përkatëse, në mënyrë që të arrihet një normë periodike konstante e interesit (norma efektive e interesit) në vlerën kontabël. Norma efektive e interesit është norma që saktësisht skonton pagesat e ardhshme ose faturat (duke përfshirë humbjet e ardhshme të kredisë) nëpërmjet jetës së pritshme të instrumentit financiar ose një periudhe më të shkurtër, nëse është e përshtatshme, në vlerën kontabël neto të instrumentit financiar.

Portfolio e derivativëve financiarë ose aktiveve dhe detyrimeve të tjera financiare që nuk janë tregtuar në një treg aktiv maten me vlerën e drejtë të një grupi të aktiveve financiare dhe detyrimeve financiare mbi bazën e çmimit që do të pranohej për të shitur një pozicion të gjatë neto (p.sh. një aktiv) për një ekspozim të veçantë të rrezikut ose paguhej për të transferuar një pozicion të shkurtër neto (p.sh. një detyrim) për një ekspozim të veçantë të rrezikut në një transaksion të zakonshëm midis pjesëmarrësve në treg në datën e matjes.

Kjo është e zbatueshme për aktivet e bartura me vlerën e drejtë mbi bazën e përsëritjes nëse banka: (a) menaxhon grupin e aktiveve financiare dhe detyrimeve financiare mbi bazën e ekspozimit neto të njësisë ndaj një rreziku të caktuar (ose rreziqeve) të tregut ose ndaj rrezikut kreditor të një pale tjetër të veçantë në përputhje me menaxhimin e dokumentuar të rrezikut nga ana e subjektit ose me strategjinë e investimeve; (b) jep informata mbi atë bazë për grupin e aktiveve dhe detyrimeve të personelit menaxhues kryesor të subjektit; dhe (c) rreziqet e tregut, duke përfshirë edhe kohëzgjatjen e ekspozimit të subjektit ndaj një rreziku (rreziqeve) të veçantë të tregut që dalin nga aktivet dhe detyrimet financiare janë në thelb të njëjta.

Kostot e transaksionit janë kosto shtesë që i atribuohen drejtpërsëdrejti blerjes, lëshimit ose nxjerrjes jashtë përdorimit të një instrumenti financiar. Një kosto shtesë është ajo kosto e cila nuk do të kishte ndodhur nëse as transaksioni nuk do

(Të gjitha shumat janë shprehur në mijë euro, përvec kur specifikohet ndryshe)

### **33. Politikat e kontabilitetit të zbatuara deri me 1 janar 2018 (vazhdim)**

të kishte ndodhur. Kostot e transaksionit përfshijnë tarifatat dhe komisionet që u paguhen agjentëve (duke përfshirë punonjësit që veprojnë si agjentë shitës), këshilltarët, agjentët dhe tregtarët, taksat nga agjencitë rregullatore dhe shkëmbimet e letrave me vlerë si dhe transferimin e taksave dhe detyrimeve. Kostot e transaksionit nuk përfshijnë primet e detyrimeve/zbritjeve, kostot e financimit ose shpenzimet e brendshme administrative ose të mbajtjes.

**Njohja fillestare e instrumenteve financiare.** Derivatet dhe instrumentet e tjera financiare me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes fillimisht regjistrohen me vlerën e drejtë. Të gjitha instrumentet e tjera financiare fillimisht regjistrohen me vlerën e drejtë plus kostot e transaksionit. Vlera e drejtë në njohjen fillestare dëshmohej më së miri nga çmimi i transaksionit. Një fitim ose humbje në njohjen fillestare regjistrohet vetëm nëse ka një diferencë midis vlerës së drejtë dhe çmimit të transaksionit që mund të evidentohen nga transaksionet e tjera të tregut të tanishëm të vrojtueshëm në të njëjtin instrument ose me një teknikë vlerësimi, inputet e të cilave përfshijnë vetëm të dhënat nga tregjet e vëzhgueshme.

Të gjitha blerjet dhe shitjet e aktiveve financiare që kërkojnë shpërndarjen brenda afatit kohor të përcaktuar me rregullore ose konventë të tregut (blerjet dhe shitjet në mënyrë të rregullt) regjistrohen në datën e tregtimit, që është data në të cilën Banka angazhohet për të dhënë një aktiv financiar. Të gjitha blerjet e tjera njihen kur njësia ekonomike bëhet palë në dispozitat kontraktuale të instrumentit.

**Çregjistrimi i aktiveve financiare.** Banka çregjistron aktivet financiare kur (a) të mbarojnë të drejtat e flukseve monetare nga aktivi financiar, apo kur mbarojnë ose kur (b) banka transferon të drejtat për të marrë flukset monetare nga aktivet financiare apo ka hyrë në një marrëveshje kalimi kualifikuese duke (i) transferuar të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë së aktiveve ose (ii) duke mos transferuar dhe as mbajtur në thelb të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë, por gjithashtu duke mos mbajtur kontroll. Kontrolli mbahet në qoftë se pala tjetër nuk ka aftësinë praktike për të shitur aktivin në tërësi tek një palë e tretë pa pasur nevojë të vendosë kufizime për shitjen.

Banka çregjistron një detyrim financiar kur detyrimet kontraktuale janë përmbytur, janë ndërprerë apo kanë përfunduar.

**Paraja dhe ekuivalentët e saj.** Paraja dhe ekuivalentët e saj janë artikujt që janë lehtësisht të konvertueshëm në valuta të njohura të parasë dhe të cilat janë subjekt i një rreziku të parëndësishëm të ndryshimeve në vlerë. Paraja dhe ekuivalentët e saj përfshijnë të gjitha plasmanet ndërbankare me maturim origjinal më pak se tre muaj. Fondet e kufizuara për një periudhë origjinale të maturimit më të gjatë se tre muaj janë të përjashtuara nga paraja dhe ekuivalentët e saj. Paraja dhe ekuivalentët e saj mbarten me koston e amortizuar.

Pagesat ose faturat e paraqitura në pasqyrën e flukseve të mjeteve monetare përfaqësojnë transferet e parave dhe ekuivalentëve të mjeteve monetare nga Banka, duke përfshirë shumat e ngarkuara ose të kredituara në llogaritë rrjedhëse të palëve të Bankës që mbahen në Bankë, të tilla si të ardhurat nga interesi i kredisë ose principali i mbledhur duke e ngarkuar llogaria rrjedhëse e klientit ose pagesat e interesit ose disbursimi i kredive të kredituara në llogarinë rrjedhëse të klientit, që përfaqëson paratë ose ekuivalentin e parasë së gatshme nga perspektiva e klientit.

**Gjendjet e parasë së detyrueshme me BQK-në.** Gjendjet e detyrueshme të parasë me BQK-në mbahen me koston e amortizuar dhe përfaqësojnë depozitat të detyrueshme të rezervave që nuk janë në dispozicion për të financuar operacionet e përditshme të Bankës dhe kështu nuk konsiderohen si pjesë e parave dhe ekuivalentëve të saj për qëllim të pasqyrës së rrjedhës së parasë.

**Aktivitetet financiare të gatshme për shitje.** Ky klasifikim përfshin letrat me vlerë që banka ka ndërmend t'i mbajë për një periudhë të pacaktuar kohore dhe që mund të shiten si përgjigje ndaj nevojave për likuiditet apo ndryshimeve në normat e interesit, kurset e këmbimit apo çmimet e kapitalit. Investimet e gatshme për shitje fillimisht maten me vlerën e drejtë. Të ardhurat nga interesi i letrave me vlerë llogariten duke përdorur metodën e interesit efektiv dhe njihen në fitim ose në humbje të vitit.

**Kreditë dhe paradhëniet për bankat.** Shumat e detyrimeve nga bankat e tjera nënkuptojnë shumat kur Banka jep paradhënie për bankat e palës tjetër, pa pasur qëllime tregtare që rezultojnë në arkëtimin e jo-derivativit të pakuotuar, bazuar në data fikse ose të përcaktueshme. Detyrimet nga bankat e tjera mbarten me koston e amortizuar.

**Kreditë dhe paradhënie për klientët.** Kreditë dhe paradhëniet ndaj klientëve regjistrohen kur Banka jep paradhënie për të blerë ose origjinuar një arkëtim jo-derivativ nga një klient i caktuar në datat fikse ose të përcaktueshme, dhe nuk ka qëllim të tregtojë llogarinë e arkëtueshme. Kreditë dhe paradhëniet për klientët mbahen me koston të amortizuar.

**Thjeshtimi.** Aktivitetet dhe detyrimet financiare zbriten (thjeshtohen) në mes vete dhe shumat neto paraqiten në pasqyrën e pozicionit financiar atëherë dhe vetëm atëherë kur banka ka të drejtën ligjore për t'i zbritur shumat dhe ajo synon ose t'i shlyejë ato në një bazë neto, ose ta realizojë aktivin dhe ta shlyejë detyrimin njëkohësisht. E drejta e zbritjes (a) nuk duhet të jetë e kushtëzuar nga një ngjarje e ardhshme dhe (b) duhet të jetë ligjrisht e zbatueshme në të gjitha rrethanat e mëposhtme: (i) në rrjedhën normale të biznesit, (ii) rastet e mospagimit dhe (iii) rastet e josolvencës ose falimentimit.

(Të gjitha shumat janë shprehur në mijë euro, përveç kur specifikohet ndryshe)

### 33. Politikat e kontabilitetit të zbatuara deri më 1 janar 2018 (vazhdim)

**Zhvlrësimi.** Banka vlerëson në çdo datë raportimi nëse ka dëshmi objektive që një aktiv financiar ose grup i aktiveve financiare të jetë zhvlrësuar.

Një aktiv financiar ose një grup i aktiveve financiare zhvlrësohet vetëm nëse ka dëshmi objektive të zhvlrësimit si rezultat i një ose më shumë ngjarjeve që kanë ndodhur pas njohjes fillestare të aktivitetit (një 'seri ngjarjesh humbjeje') dhe se ngjarja e humbjes ka një ndikim në flukset monetare të ardhshme të vlerësuara të aktivitetit financiar ose grupit të aktiveve financiare që mund të vlerësohen me besueshmëri.

**Zhvlrësimi i kredive dhe paradhënieve ndaj klientëve** bazohet në rishikimin e disa faktorëve që ndjekin kredinë, përmbajnë dobësitë që janë të natyrshme në një kredi, ose nëse ekziston një probabilitet që një pjesë e shumës së kredisë nuk do të paguhet. Kriteret kryesore që Banka vëren për të përcaktuar se ekzistojnë dëshmi objektive të një humbje nga zhvlrësimi përfshijnë:

- Mospagesa ose shkelja në pagesat e interesit ose të principalit;
- Mospagimi për shlyerjen e interesit ose të principalit në institucionë të tjera financiare, subjekt i kufijve të caktuar;
- Vështirësitë e likuiditetit të kredimarrësit (për shembull, treguesi i likuiditetit, treguesi i kapitalit, përqindja neto e të ardhurave për shitje);
- Shkelja e kontratave ose kushteve të kontratës;
- Kredimarrësi konsideron falimentimin ose riorganizimin financiar;
- Përkeqësimi i kushteve ekonomike dhe të tregut.

Banka fillimisht vlerëson nëse evidenca objektive e zhvlrësimit ekziston individualisht për aktivet financiare që janë individualisht të rëndësishme, dhe individualisht ose kolektivisht për aktivet financiare që nuk janë individualisht të rëndësishme. Nëse Banka përcakton që nuk ekziston ndonjë evidencë objektive e zhvlrësimit për një aktiv financiar të vlerësuar individualisht, qoftë i rëndësishëm apo jo, ai përfshin aktivin në një grup aktiveve financiare me karakteristika të ngjashme të rrezikut të kredisë dhe vlerëson kolektivisht ato për zhvlrësim.

Vlera kontabël neto e aktivitetit është zvogëluar nëpërmjet përdorimit të një llogarie zbritëse dhe shuma e humbjes është njohur në fitimin dhe humbjen për vitin.

Për qëllime të vlerësimit kolektiv të zhvlrësimit, aktivet financiare grupohen në bazë të karakteristikave të ngjashme të rrezikut të kredisë. Këto karakteristika janë relevante për vlerësimin e flukseve monetare të ardhshme për grupet e aktiveve të tilla duke treguar treguesin e aftësisë së debitorit për të paguar të gjitha shumat e duhura sipas kushteve kontraktuale të aktiveve që vlerësohen.

Vlerësimi kolektiv përcaktohet duke u bazuar në një model të rrezikut të kredisë që merr parasysh faktorin e probabilitetit të zhvlrësimit ("PD") dhe Faktorin e humbjes së dhënë ("LGD") përshtatur sipas rrethanave lokale. Faktori i PD-së është vërejtur gjatë një periudhe dymbëdhjetëmujore, ndërsa shkalla e rikuperimit e cila llogaritet për një periudhë 24 mujore. Të dhënat hyrëse në model janë përditësuar në baza vjetore për tre segmente të veçanta (ekspozimet me pakicë, biznesi dhe kredit kartelat) dhe normat e provizioneve përfundimtare të humbjes së kredisë që rrjedhin nga modeli janë përfundimisht subjekt i miratimit të Komitetit të Menaxhimit të Riskut (KMR) dhe i Bordit të Drejtorët ("BD").

Për qëllime të vlerësimit kolektiv të zhvlrësimit, Banka klasifikon portofolin në kategoritë e mëposhtme:

- Standard: borxhet 1-30 ditë
- Vrojtuese: vonesat 31-60 ditë
- Nënstandard: vonesa 61-90 ditë
- Të dyshimta: borxhet 91-180 ditë
- Humbje: borxhet > 180 ditë

Banka përdor një model të bazuar në probabilitetin e mospagimit për 12 muaj (PD) dhe humbjeve nga mospagimi për 24 muaj (LGD). Normat kolektive janë miratuar nga Bordi i Drejtorëve dhe janë validuar nga Banka Qendrore e Kosovës më 22 qershor 2016. Nivelet e lejimit për kreditë standard dhe vrojtuese janë llogaritur duke përdorur normat e mëposhtme:

	<i>Standarde – pa ditë vonëse</i>	<i>Standarde (1-30 ditë vonëse)</i>	<i>Vrojtuese (31-60 ditë vonëse)</i>
<i>Kredit kartela</i>	0%	10.54%	19.76%
<i>Individual</i>	0%	7.7%	25.55%
<i>Entitete ligjore</i>	0%	19.56%	36.76%

Faktorët PD dhe LGD të përdorura për të përcaktuar nivelet provizionimit të paraqitura më sipër, rrjedhin nga informacionet historike të Bankës. Banka aplikon një shtesë prej 10% tek normat e rrjedhura nga modeli, si faktor i

*(Të gjitha shumat janë shprehur në mijë euro, përveç kur specifikohet ndryshe)*

### **33. Politikat e kontabilitetit të zbatuara deri më 1 janar 2018 (vazhdim)**

matur për provizionimin kolektiv (standard 1-30 dhe vrojtuese) për të llogaritur humbjet e mëtejshme që mund të rezultojnë nga ndonjë zhvillim i jashtëm negativ ose ndryshim i inputeve. Për zhvlerësimet specifike që zhvlerësohen individualisht, banka përdor metodën e mëposhtme.

Kreditë jo-performuese ("NPL") që janë në vonëse më shumë se 90 ditë dhe ku vërehet përkeqësimi financiar, janë subjekt i një dispozite specifike.

Për rastet e NPL me vlerë më pak se 50 mijë Euro, ekspozimi i papaguar ("EAD") në datën e raportimit shumëzohet me 24 muaj të Normës së Rimarrjes për secilin segment dhe ekspozimi i mbetur provizionohet me 100%. Për rastet e NPL mbi 50 mijë Euro, banka kryen vlerësimin individual të zhvlerësimit duke vlerësuar një fluks hyrjeje të mjeteve monetare deri në 10 vjet, e cila skontohej me normën efektive të interesit të çdo objekti. Parashikimi i mbledhjes së mjeteve bazohet në vlerësime të kujdesshme dhe realiste, të cilat konsiderojnë faktorët e mëposhtëm të përmirësimit të kredisë si: vlera e tregut të kolateralit dhe likuiditeti i tij, rrjedha historike e parave, garantuesi i palës së tretë / bashkë-kredimarrësi, kohëzgjatja për likuidimin / riposedimin e aktiveve dhe vendin ligjor për mjedisin si faktor i jashtëm. Banka shqyrton vlerësimin e mbledhjes së mjeteve në baza mujore.

Ekspozimet e ristrukturuara kreditore që janë me vonesë më pak se 90 ditë dhe ku nuk janë vërejtur përkeqësime financiare, janë të klasifikuara si ekspozime performuese, ndryshe ekspozimet janë të klasifikuara si ekspozime të ristrukturuara kreditore jo-performuese. Një ekspozim i ristrukturuar i kredisë klasifikohet në kategorinë nën-standard ose më poshtë derisa të observohet ecuria e qëndrueshme. Ekspozimet e ristrukturuara monitorohen dhe klasifikimi i tyre përmirësohet vetëm pas katër pagesave të rregullta të njëpasnjëshme. Kur një kredi nuk është e arkëtueshme, ajo shlyhet kundrejt provizionit përkatës për zhvlerësimin e kredisë. Sipas procedurave të brendshme të bankës, kredia shlyhet bazuar në dy kritere: vonesa dhe lloji të kolateralit.

Nëse, në një periudhë pasuese, shuma e humbjes nga zhvlerësimi zvogëlohet dhe rënia mund të lidhet objektivisht me një ngjarje që ndodh pas njohjes së zhvlerësimit (si një përmirësim në vlerësimin e kredisë së kredi-marrësit), zhvlerësimi i njohur më parë kthehet mbrapsht duke rregulluar llogarinë e provizionimit. Shuma e anulimit njihet në fitimin ose humbjen nga zhvlerësimi për humbjet e kredisë.

#### ***Zhvlerësimi i aktiveve financiare të gatshme për shitje***

Banka përcakton se vlera e investimeve të gatshme për shitje është zhvlerësuar kur ka një rënie të konsiderueshme ose të zgjatur të vlerës së drejtë nën koston e saj. Në mungesë të tregut të brendshëm për të caktuar çmimet dhe përqindjen e kthimeve (prodhimin) për aktive financiare të gatshme për shitje, llogaritja e vlerës së drejtë të tregut bëhet në baza ditore bazuar në kurbën gjenerike të obligacioneve gjermane. Regjistrimi i rivlerësimit në libra bëhet nga departamenti i financave në çdo datë raportimi. Në baza mujore, departamenti i financave kalkulon përqindjen e kthimit bazuar në të dhënat e Bloomberg të cilat ofrohen nga departamenti i thesarit.

#### **Instrumentet financiare derivative**

Instrumentet financiare derivative, të cilat përfshijnë kontratat e këmbimit valutor mbarten me vlerën e tyre të drejtë. Instrumentet derivative mbarten si aktive kur vlera e drejtë është pozitive, dhe si detyrim kur vlera e drejtë është negative. Ndryshimet në vlerën e drejtë të instrumenteve derivative përfshihen në fitimin ose humbjen për vitin (fitimet minus humbjet mbi derivativët). Banka nuk zbaton kontabilitetin mbrojtës.

**Angazhimet e lidhura me kredinë.** Banka lëshon garanci dhe angazhime financiare për të ofruar kredi. Garancitë financiare paraqesin siguri të përvokueshme për të bërë pagesa në rast se një klient nuk mund të përmbushë detyrimet e tij ndaj palëve të treta dhe të mbajë të njëjtin rrezik kredie si kreditë. Garancitë financiare dhe angazhimet për të ofruar një kredi fillimisht njihen me vlerën e tyre të drejtë, e cila normalisht evidentohet nga shuma e tarifave të marra. Kjo shumë amortizohet në bazë të drejtpërdrejtë gjatë jetës së angazhimit, me përjashtim të angazhimeve ndaj kredive origjinale, nëse është e mundur që banka do të hyjë në një marrëveshje specifike kreditimi dhe nuk pret të shesë kredinë që rezulton menjëherë pas fillimit; tarifat për angazhimet e tilla janë të shtyera dhe të përfshira në vlerën kontabël të kredisë në njohjen fillestare. Në fund të çdo periudhe raportuese, angazhimet maten në nivelin më të lartë të (i) bilancit të mbetur të paamortizuar të shumës në njohjen fillestare dhe (ii) vlerësimit më të mirë të shpenzimeve të kërkuara për të shlyer angazhimin në fund të çdo periudhe raportuese.

**Grancitë e performancës.** Grancitë e performancës janë kontrata që ofrojnë kompensim nëse një palë tjetër nuk arrin të kryejë një detyrim kontraktual. Kontrata të tilla transferojnë rrezikun jo-financiar të performancës përveç rrezikut të kredisë. Grancitë e performancës fillimisht njihen me vlerën e tyre të drejtë, e cila normalisht evidentohet nga shuma e tarifave të marra. Kjo shumë amortizohet në bazë të linjës së drejtë gjatë jetës së kontratës. Në fund të secilës periudhë raportuese, kontratat e garancisë së performancës maten në nivelin më të lartë të (i) bilancit të paamortizuar të shumës në njohjen fillestare dhe (ii) vlerësimin më të mirë të shpenzimeve të nevojshme për të zgjidhur kontratën në fund të çdo periudhe raportimi, të zbritur në vlerën aktuale. Kur Banka ka të drejtën kontraktuale për t'u kthyer te klienti i saj për mbulimin e shumave të paguara për të shlyer kontratat e garancisë së ekzekutimit, shuma të tilla do të njihen si kredi dhe të arkëtueshme pas transferimit të kompensimit të humbjes tek përfituesi i garancisë.